



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I M B L E D H J E S S Ë J A S H T Ë Z A K O N S H M E T Ë K U V E N D I T T Ë
R E P U B L I K Ë S S Ë K O S O V Ë S, E M B A J T U R 1 0 S H T A T O R
D H E 2 T E T O R 2 0 1 7

S A V A N R E D N E S E D N I C E S K U P Š T I N E R E P U B L I K E K O S O V A,
O D R Ž A N E 1 0. S E P T E M R A I. 0 2. O K T O B R A 2 0 1 7. G O D I N E

S H T A T O R / T E T O R - S E P T E M A R / O K T O B A R
2 0 1 7

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava u vezi Programskih načela Vlade Republike Kosova, 2017-2021

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 31 deputetë, andaj i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit me kërkesë të 53 deputetëve, me këtë rend dite:

1. Debat parlamentar lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017/2021

Të nderuar deputetë,

Grupi prej 53 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017/2021.

Ftoj përfaqësuesin e grupit të deputetëve, zotin Albin Kurti, që ta marrë fjalën e t'u drejtohet deputetëve.

ALBIN KURTI: Të dashur qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Kjo e mbrëmshmja është qeveria më e dobët në Kosovën e pasluftës, si për nga formimi e orientimi, po ashtu edhe për nga përmbajtja e pesha. Shumica dërmuese e ministrave janë asistentë të shefave, por edhe me shumë se kaq, nuk kanë lidhje me dikasteret që do t'i drejtojnë. Në këtë qeveri ka tepër ministra, sepse ka shumë kryeministra, tre a katër në Prishtinë dhe njëri vendimtar në Beograd.

Po pra, nuk ka mundur të jetë ndryshe. Kjo qeveri u formua, sepse jo vetëm Vuçiqi, por as PAN-i nuk mund ta paramendojnë Lëvizjen “Vetëvendosje” në udhëheqje të Qeverisë. I janë afruar shumë njëri-tjetrit, sepse janë larguar shumë prej Kosovës, popullit e halleve të qytetarëve të saj! Janë bashkuar kundër nesh, sepse shkelin të drejtat që janë të Kosovës, mbrojnë interesa që nuk janë të Kosovës, shpërfillin nevoja që janë të popullit të Kosovës. ‘Gulshimi’ i tyre për pushtet po e sjell në pikën më të ulët shtetin e Kosovës.

Deputetë të nderuar,

Në vitin 1937 Vaso Çubriloviqi mbante ligjëratë në Serbi mbi spastrimin e shqiptarëve dhe mbi popullimin e Kosovës me serbë nga veriu i Serbisë. Ata, thoshte ai, janë bujq të mirë dhe do të dinë se si t'i punojnë tokat e Kosovës, pasi të largohen shqiptarët!

Në vitin 1944 Çubriloviqi u bë këshilltar i Titos dhe e shkroi Memorandumin famëkeq mbi problemin e minoriteteve në Jugosllavinë e re, ku thoshte se “nëse nuk i largojmë

tani, nuk kemi për t'i larguar kurrë". E në vitin 1945 a e dini se çfarë ndodhi me Çubriloviçin? Ai u bë ministër i Bujqësisë në Jugosllavi. Po, pra, Çubriloviçi qe bërë ministër i Bujqësisë, sepse shqiptarët ishin në masë të madhe bujq, se Kosova ishte vend bujqësor, siç është ende. Nuk kishte mënyrë më të mirë për t'i realizuar idetë e tij se sa si ministër i Bujqësisë!

Në gjysmën e parë të shekullit XX shqiptarët janë përzënë prej Kosovës me dhjetëra e mijëra, e janë zëvendësuar me kolonë serbë, por edhe në gjysmën e dytë, pas Luftës së Dytë Botërore, fillimisht nëpërmjet represionit brutal të Rankoviçit, por edhe diskriminimit ekonomik e të varfërisë, e pastaj edhe nëpërmjet aparteidit të Milosheviçit, shqiptarët vazhdimisht janë detyruar të largohen prej Kosovës. Spastrim në formën e dëbimit të dhunshëm, ose mërgimit të detyruar, gjithnjë i shoqëruar nga politika në favor të ardhjes së kolonëve serbë.

Historikisht e botërisht ka një lidhje thelbësore mes politikave kolonizuese dhe atyre bujqësore. Kolonizimi, kudo që ka ndodhur, ka qenë kolonizim së pari agrar, e vetëm në plan të dytë ushtarak, tregtar, industrial, e të tjera. Afrika, Amerika, India, të gjitha këto raste klasike të kolonializmit, për shekuj me radhë janë kolonizuar nga ndërmarrje agrare nëpërmjet sistemit të plantacioneve, por edhe Hitleri në planin e tij për ta pushtuar Evropën Lindore kishte menduar të sillte prej Amerikës së Jugut banorët e atjeshëm me prejardhje gjermane, sepse ata, sipas tij, kishin përvojë për menaxhimin agrar të tokave të gjera të Lindjes.

Nuk ka plan kolonial pa një dimension të fort të politikave bujqësore, madje edhe neokolonializmi që shfaqet si kolonializëm tregtar, këtu te ne shfaqet kryesisht nëpërmjet sundimit të tregjeve me produkte ushqimore, kryesisht produkte bujqësore të përpunuara.

Duke i ditur të gjitha këto, prapëseprapë këta vendosën që ta bëjnë ministër të Bujqësisë jo një serb, por një përfaqësues direkt të Beogradit, një ministër nga Lista serbe. Këta kanë vendosur që Beogradit, pasi që t'ia falin tregun e ushqimeve të Kosovës, t'ia japin edhe çelësat e hambarit, që është bujqësia. Atij Beogradi, që kurrë nuk ka kërkuar falje për projektet e veta spastruese e kolonizuese gjatë gjithë shekullit të kaluar, atij Beogradi që kurrë nuk ka kërkuar falje as për krimet e luftës së fundit.

Hipokrizia më e madhe është se e gjithë kjo qeveri, që u bë qeveri e sekserëve, në fushatë patën thënë se do t'i marrin votat e fermerëve e të bujqve, të gjithë këta kanë premtuar fonde pa fund për bujqësinë. E tani, bujqësinë ia kanë dorëzuar Listës serbe. Turp duhet t'u vijë.

A e dinë këta se në Kosovën tonë, që e kanë lënë të prapambetur e që ia kanë mbyllur fabrikat, shumica e popullit jeton nga bujqësia? Me cilin moral ia kanë dorëzuar Ministrinë e Bujqësisë Listës serbe? Çfarë do t'u thonë fshatarëve e fermerëve të Drenicës e Dukagjinit, të Anamoravës e të Anadrinit? Me cilën fytyrë do të shkojnë në fshatra që t'ua shpjegojnë atyre se subvencionet për bujqësinë e blegtorinë do të jenë të varura nga Serbia?

Me këtë plan që kanë bërë, i kanë dhënë mundësi të mirë Serbisë që t'i realizojë planet e saj, që t'i fuqizojë projektet për kolonizim e ndarje të brendshme të Kosovës, projektet për bosnjëzimin e Kosovës. Në këtë derexhe ku e kanë sjellë Kosovën nëpërmjet kushtëzimeve që i kanë vendosur në Kushtetutë e në ligje të tjera, Kosova gjithnjë e më shumë tash me këtë qeveri po e humb pavarësinë, e po shkon drejt autonomisë. Shtetin e pavarur të Kosovës po e bëjnë shtet vasal të Serbisë.

Dhënia e Ministrisë së Bujqësisë është esenca e pazarit me Serbinë për Qeverinë e Kosovës. Paralelisht me këtë ka një fjali në faqen 10, që tregon se cili është shtegu i kësaj qeverie. Aty thonë: “Me Serbinë e kemi një histori tragjike të marrëdhënieve”. Ky barazim është i pafalshëm edhe për ndonjë ndërmjetës ndërkombëtar. Edhe ndonjë ndërmjetës ndërkombëtar po të thoshte se kanë një histori tragjike shqiptarët dhe Serbia, do të duhej të pasohej me kritikën tonë. E nëse këtë ia bën vetvetes, atëherë mund të themi se pikërisht ky barazim mes shqiptarëve dhe Serbisë është tragjik. Për shkak të kësaj qasjeje, të barazimit mes shqiptarëve dhe Serbisë, në Kosovë i kemi planet e rrezikshme prej decentralizimit mbi baza etnike, e deri te Gjykata Speciale.

Ndonëse Kushtetuta e Kosovës është aq e kufizuar, këta nuk e kanë shfrytëzuar as atë. Pse nuk kanë bërë qeveri me më pak se 13 ministri? Madje, unë besoj se secila qeveri në Kosovë duhet të synojë të ketë më së shumti 12 ministri, së paku deri në momentin që Serbia ta njohë Kosovën, ose deri në momentin që në Kosovë nuk do të veprojnë leva direkte të Serbisë, siç është Liste serbe e krijuar në Beograd.

Qeveria me më pak se 13 ministri, pra me maksimalisht 12 ministri, i ka dy të mira. Ajo edhe kursen, por edhe lë më pak hapësirë për instrumentet e Serbisë që kanë për synim sabotimin e Kosovës.

Kërkesa që kam për Qeverinë është kjo: Mos na i sillni në këtë Kuvend të ashtuquajturat “tema të mëdha”. Ju e keni një qeveri të dobët, partia e kryeministrit i ka vetëm 10 deputetë, kështu që mos shkoni me këmbët tuaja te gracka e Vuçiqit. Mos provoni ta sillni në këtë Kuvend “Zajednicën” e Serbisë, demarkacionin me Malin e Zi, Kosovën C me 23% profit për privatën, sepse ne do t'ju ndalim!

Ne jemi një opozitë dy herë më e fuqishme dhe ju do të jeni në pozitë shumë më të vështirë se në vitet e kaluara. Ju ftoj të përqendrohemi te zhvillimi ekonomik, te rregullimi e reformimi i arsimit dhe i universitetit, tek investimi në QKUK dhe në shëndetësi, te punësimi, rrogat, pensionet e te politikat sociale. Nëse përqendrohemi në këtë drejtim, ne do të debatojmë, e kushedi, edhe të bashkëpunojmë me ju për ndonjë ligj. E nëse jo, atëherë 11 qershori do të përsëritet shumë shpejt, por me efekt dy herë më katastrofik për partitë tuaja.

Nga ato pak faqe që i keni quajtur ‘Parime programore’ nuk jam fare optimist. Janë tejet të përgjithshme, prandaj përgjithësisht bosh, si listë dëshirash. Përjashtim bën vetëm shpallja se bartës i zhvillimit ekonomik do të jetë kapitali privat, që e bën të duket program i djathtë, por nuk tregon se si do të vijë ky kapital privat kaq befasisht, kur dihet se vendet e rajonit nuk kanë bërë ndonjë mrekulli në kohët e fundit në investimet e huaja direkte.

Mbase ju flisni në përgjithësi, pikërisht që të mos ketë rëndësi ajo çfarë thoni, sepse porsa përmendni diçka konkrete, ju e degradoni Qeverinë në departament analitik. Për shembull, thoni se do të analizohen variantet për të ardhmen e termocentralit Kosova A. Kur thoni diçka konkrete, atëherë bëheni analistë. Ka shumë fjalë në erë këtu. Thoni se do të çoni shumë para në bujqësi, shumë para në arsim, shumë në shëndetësi, shumë për rininë, shumë për policinë, shumë për ushtrinë, si dhe shumë para për politika sociale që ofrojnë një jetë dinjitoze për të gjithë ata që nuk kanë mundësi objektive të punojnë. Pra, shumë para për gjithçka, gjë që apriori dihet se është gënjeshtër. Nga njëra anë, kjo tregon paaftësi për të ofruar prioritete, si dhe paaftësi për të ndërtuar një program konkret.

Nga ana tjetër, thoni se nuk do t’i rrisni taksat, por do ta rritni buxhetin nëpërmjet rritjes ekonomike. Kjo do të thotë se premtimet për shumë para janë tërësisht të pambuluara nga buxheti, ndërkohë që nuk parashihet asnjë instrument i ri financiar që ndihmon ekonominë. Shtrohet pyetja, pse kjo Qeveri nuk ka program, pse kjo Qeveri nuk ka as parime, pse këto pak faqe që na i kanë sjellë nuk mund të jenë parime programore? Për mua është e qartë. Kjo Qeveri nuk ka program, sepse kjo Qeveri nuk ka marrëveshje. Këta nuk kanë marrëveshje për qeverisje, këta kanë vetëm marrëveshje për ta ndarë qeverinë, për t’i ndarë ministrinë, por jo për të qeverisur vendin.

Një dëm i posaçëm është Lista serbe, e cila i ka vjedhur votat e komunitetit serb. Pyesni Nenad Rashiqin, pyeteni Slobodan Petroviqin dhe do ta merrni vesh se vjedhja industriale që ka ndodhur te ne në vitin 2010, është edhe më e madhe që ka ndodhur te komuniteti serb për zgjedhjet e 11 qershorit të vitit 2017.

Ne e dimë se nga kjo Qeveri nuk ka dobi, por unë ju lus, mos na bëni dëme, para se të vijë qeveria jonë. Mbajeni përherë ndërmend qeverinë tonë që vjen më pas dhe bëhuni të dobishëm, duke mos bërë dëme. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nisma” nuk është. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” e ka radhën. Atëherë, Lidhja Demokratike e Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova sot po hyn në një fazë të errët dhe të paqartë të rrugëtimit për konsolidimin e shtetësisë.

Pas tre muaj vonese janë themeluar tanimë institucionet e vendit nëpërmjet tri metodave, secila më e dëmshme dhe më e turpshme se tjetra për popullin lirishtesë të Kosovës.

Metoda e parë për formimin e shumicës parlamentare u siguroi nëpërmjet kontrabandimit të votave të deputetëve. Metoda e dytë nëpërmjet arritjes së pazareve të ulëta politike për ndarje të posteve, pa asnjë interes shtetëror apo orientim qeverisës dhe, më tragjikja nga të gjitha, qeveria u votua pas dakordimit me Beogradin.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga sot vendi po hyn në krizë të përgjithshme. E tejkaluam krizën e themelimit të institucioneve me koston e një krize të përgjithshme të degradimit institucional të Kosovës. Kjo është fatkeqësi për vendin, kjo është fatkeqësi për këtë koalicion qeverisës. Para së gjithash, është fatkeqësi për qytetarët lirishtesë të Kosovës.

Është e pafalshme që 18 vjet pas lufte, pas arritjes së shumë njohjeve të shtetit të Kosovës, pas nënshkrimit të MSA-së, thellimit të partneritetit me NATO-n të kthehet ndikimi i plotë i Beogradit në vendimmarrjen e institucioneve të Kosovës.

Është e pafalshme që të kthehet ndikimi i plotë i Beogradit në Qeverinë e Kosovës, kur ende kemi 1 600 të pagjetur nga lufta e vitit ‘98/’99. Qytetarët e Kosovës nuk do të falin këta njerëz që thirren si “çlirimtarë” e thirren në heroizma, ndërkohë që arrijnë pazare të tilla me Beogradin! Kjo është ditë fatkeqe për vendin tonë të shtrenjtë. Në krye të Qeverisë është personi, partia e të cilit ia ka futur flakën Kuvendit të Kosovës me gaz lotsjellës dhe dhunë.

Po ju siguroj një gjë, që ky është episodi i fundit i qeverisjes të një klase politike që është fatale për të ardhmen e gjeneratave të reja të Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Disa nga këta që sot janë bërë pjesë e koalicionit qeverisës, kanë qenë pjesë e përpjekjeve për çlirim nga okupimi dhe dhuna serbe, por të gjithë sot pa përjashtim janë bërë pjesë e historisë së turpshme dhe fatkeqe të Kosovës në ndërtimin e Kosovës nëpërmjet dakordimit me Beogradin. Vrasjet e pasluftës, uzurpimet e pronave publike, aferat korruptive dhe shumë veprime të tjera joligjore rëndojnë si barrë mbi shtetin e Kosovës në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian.

Aktorët e kësaj qeverie dhe të këtij koalicioni duhet të japin përgjigje për këto çështje. Qeveria Mustafa është qeveria e vetme që ka mbyllur mundësitë për korrupsion dhe kjo, në fakt, i ka bërë të gjithë bashkë për rrëzimin e Qeverisë Mustafa. Puna në luftimin e korrupsionit nuk është kryer plotësisht për shkak të organeve të drejtësisë që janë të kapura ende. Megjithatë, Bashkimi Evropian i ka njohur përpjekjet e Qeverisë Mustafa në këtë drejtim, duke konsideruar si kriter të përmbushur për liberalizimin e vizave.

Të nderuar qytetarë,

Lidhja Demokratike, bashkë me qytetarët e Kosovës, nuk do të lejojë këtë qeveri ta kthejë vendin prapa. Nga sot ne Lidhja Demokratike e Kosovës, bashkë me qytetarët liridashës të Kosovës, nisim luftën tonë demokratike për rrëzimin e kësaj qeverie dhe organizimin e zgjedhjeve të reja. Ne ftojmë të gjitha forcat progresive të Kosovës të ndalin sa më parë këtë fatkeqësi që po i ndodh vendit.

Shumica shqiptare në Kuvendin e Kosovës prej 58 deputetëve nuk do të lejojë që progresi i Kosovës drejt konsolidimit të shtetësisë të varet nga një forcë politike, që në fundament është kundër shtetit të Kosovës. Do të përballeni me një opozitë që nuk e keni parë më përpara.

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Marrëveshja e partive të këtij koalicioni bie ndesh me Kushtetutën e vendit. Kushtetuta përcakton se ministrat e Qeverisë së Kosovës emërohen dhe shkarkohen vetëm nga kryeministri, e jo nga shefat e partive të këtij koalicioni, siç parashihet në marrëveshje. Bazuar në këtë marrëveshje, kjo qeveri, në fakt do të ketë pesë kryeministra. Marrëveshja e koalicionit nuk është mbi baza të programit qeverisës, por mbi baza të ndarjes dhe balancimit të interesave të grupimeve politike të këtij koalicioni. Prandaj, koalicioni nuk mund të quhet koalicion qeverisës, por koalicion biznesor.

Zoti Haradinaj duhet të përgjigjet se çfarë përfaqëson Dardan Gashi në këtë koalicion, duke e ditur historinë e tij? Tash këtij personi i caktohet Ministria e Drejtësisë dhe i është shtuar edhe resori i investimeve strategjike. Ministria e Diasporës, ku iu shtua tash edhe një portofolio tjetër e investimeve strategjike, ndoshta kjo është e kuptueshme për ta, pasi që ky person ka qenë dhe mbetet në shërbim të interesave strategjike të protagonistëve të këtij grupimi biznesor qeverisës.

Në anën tjetër, duke pasur Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Arsimit, çfarë do të bëjë Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me Besim Beqajn? Duke ditur në veçanti historinë e këtij personi në privatizimin e Distribucionit, rastin e AXOS-it lidhur me privatizimin e PTK-së, aferat “Pronto” të tij me kryeprogonistin e “Pronto”-s, Adem Grabovcin.

Në këtë qeveri është themeluar edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ta kenë të qartë qytetarët e Kosovës, se ky është hapi i parë që po tenton të bëjë kjo qeveri drejt rajonalizimit të Kosovës, ashtu siç është kërkuar tash e dhjetë vjet nga Beogradi.

Zoti Haradinaj duhet të përgjigjet para qytetarëve të Kosovës se çfarë i ka premtuar Listës serbe dhe Vuçiqit në këmbim të votave të tyre? Si janë dakorduar lidhur me Asociacionin e komunave me shumicë serbe? Sipas informatave del që asociacioni do të themelohet sipas marrëveshjes që këta kanë bërë në Beograd, e jo sipas opinionit që ka lëshuar Gjykata Kushtetuese.

Çfarë premtimi u ka dhënë atyre lidhur me Komunën e Prilluzhës dhe atë të Gorës? Cili ka qenë roli i Radojiqit në arritjen e këtij koalicioni? Këto janë çështje që ai duhet të përgjigjet para Kuvendit dhe para qytetarëve të vendit.

Prandaj, ky koalicion i mbulon me turp aktorët që janë përfshirë në të. Ky veprim i turpëron mijëra veteranë të luftës, invalidë të luftës, dëshmorë dhe qytetarë liridashës të vendit. Kjo marrëveshje biznese për të qeverisur është arritur edhe me ndërhyrjen jokushtetuese të presidentit të vendit. Ai i ka arritur këto marrëveshje në Bruksel me Vuçiqin. Ky është dialogu që ai ka bërë në Bruksel javëve të fundit.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Zoti Haradinaj mbrëmë kërkoi të votohet mbi bazën e një dokumenti dhjetë faqesh pa asnjë përmbajtje, pa asnjë veprim konkret që qeveria duhet të ndërmarrë. Ai nuk e ka idenë se çfarë do të punojë në muajt e ardhshëm. Dhe, kjo është në fakt e natyrshme, pasi që ai i prin një koalicioni që është konglomerat i grupeve të interesit të etur tmerrësisht për pushtet për një kohë të gjatë dhe, së dyti dhe, më tragjikja, i Listës serbe që është zgjatim i partisë së Vuçiqit në Kosovë me qëllim kryesor pengimin e konsolidimit të

shtetësisë së Kosovës. Kjo ndoshta është e natyrshme, sepse ky person mision të jetës së tij e ka pasur vetëm se si të bëhet kryeministër. Vetëm kaq, përtej saj për të nuk është asgjë e rëndësishme.

Në këtë dokument dhjetë faqesh nuk jepen shpjegime se si do të mbahet zhvillimi ekonomik mbi 4%, që është arritur gjatë këtij mandati. Çfarë do t'u ofrojnë investitorëve të huaj për t'i nxitur ata të investojnë më shumë në Kosovë? Si do të rritet buxheti i Kosovës përtej dy miliardë eurosh? Çfarë do të bëjë me veteranët dhe invalidët e luftës, duke ditur se tash Prokuroria e Shtetit po hetojnë raste të mashtrimeve me certifikata të veteranëve? Si do mbajë relacionet me Brukselin dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar? Si do ta luftojë korrupsionin në radhët e veta dhe cilat janë reformat fundamentale që ai do të sigurojë se Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit që e ka nënshkruar kjo qeveri do të zbatohet plotësisht.

Para së gjithash, ai nuk ka dhënë përgjigje se si do ta themelojë ushtrinë e Kosovës, duke qenë se tash Beogradi ka rol kyç në çdo vendimmarrje të kësaj qeverie. Si do ta udhëheqë dialogun me Serbinë dhe si do ta përmbyllë këtë dialog? Si do ta adresojë demarkacionin me Malin e Zi, të cilin e ka bërë kauzë gjatë kohës sa ka qenë në opozitë?

Të nderuar qytetarë,

Ne Lidhja Demokratike e Kosovës do të jemi gardianë të ruajtjes së Republikës së Kosovës dhe të progresit që kemi bërë deri më tani, nga degradimi që mund të nisë nga dita e sotme. Ne para 27 vjetëve e kemi nisur rrugëtimin e Kosovës për liri e pavarësi, për shtet demokratik dhe të integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Ne do ta përmbylim këtë proces, jo kjo qeveri fatkeqe që u themelua me dakordimin e Beogradit. Para nesh në muajt në vijim detyrë parësore është të sigurohemi se këta njerëz të etur për pushtet nuk mund t'i jetësojnë pazaret e arritur me Beogradin. Detyrë parësore jona është që sa më parë ta përmbysim këtë qeveri fatkeqe dhe të turpshme për qytetarët liridashës të vendit.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në mbledhjen e Kryesisë ishit ju të pranishëm, ishim unanim që Rregullorja të respektohet dhe kështu do të vazhdojmë. Edhe ju ishit i pranishëm, unanim ishim që Rregullorja të respektohet. Fatmirësisht, edhe ju ishit prezent. Më vjen keq, dhjetë minuta janë. Rregullorja është kjo. Do të jem bukur strikt. I nderuar ministër, kam respekt, por nuk është mirë as mua... Qytetarët të na shohin, të na vësh në pozitë, të cilën unë personalisht do ta bëja, por s'do ta bëj për shkak të Rregullores. Do të jem bukur strikt, për arsye se njëjtë si të lejohen 50 minuta, si 5 minuta, njëjtë. E respektojmë Rregulloren. Nuk është mirë të më vësh në pozitë, s'e kam ndërmend të lëshoj pe. Do të

shkojmë në bazë të Rregullores. Me qejf, me dëshirën time, më së pari e kisha bërë për ty dhe për secilin, por do të shkojmë në bazë të Rregullores. Të lutem, ministër, mos më nxirr në pozicion të vështirë. Unë mund ta them edhe këtë, nuk do ta vazhdosh asnjë sekondë, sikurse ti, asnjëri tjetër më shumë minuta se që i përcakton Rregullorja. Kjo është!

Kalojmë te përfaqësuesi i Qeverisë. Nuk është këtu. Kalojmë te deputetët. Kisha pasur dëshirë për hir të mirëvajtjes së debatit. Më vjen keq, hyjmë në pjesë me Rregullore. Po e kuptoj, ministër, hyjmë me Rregullore, pastaj të shkojmë me Rregullore, vetëm zëre vendin, pastaj shkojmë me deputetë, diskutimet. E kreve për grupin parlamentar. Ministër, në qoftë se është të krijoni skena dhe ta testoni reagimin tim, unë fare do të qëndroj kështu, ti e uzurpon atë, unë nuk ta prish, ti rri aty, por nuk është mirë! Ja ku i ke edhe kolegët që kanë qenë deputetë, të lutem mos më vër në pozitë të vështirë! Unë po flas në mënyrën humane, si kryetar, si deputet, do të shkojmë në këtë formë. Po, të shkojmë në bazë të Rregullores dhe pastaj ta jap fjalën.

Interpretuesi i Rregullores jam unë, por në të njëjtën kohë ju mund të adresoni në Gjykatën Kushtetuese dhe shumë mirë bëni, në qoftë se ka shkelje. Ju kisha kërkuar të shkojmë në bazë të mirëvajtjes.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është. Deputetët sipas radhës së paraqitjes. Është paraqitur Milaim Zeka i pari. Ja me emër, ju luta Glauk dhe Avdullah, në qoftë se ka mundësi... Po e përfunduar në emër grupin, se kur e more fjalën, shiko protokollin, bile, e ke parasysh, e bërë edhe një gabim, për arsye se the po flasim në emër të grupit, e kaluat Lëvizjen “Vetëvendosje”. A është kjo e vërtetë? Po mos më keqkuptoni, se s’po dua... Ministër, gradualisht respekto veç Rregulloren. Glauku e toleroi, edhe unë e tolerova heshtazi.

Milaim Zeka, e ke fjalën si deputet. Ju kisha lutur, Glauk e ke kërkuar fjalën...

MILAIM ZEKA: ...‘Vllaçitni’ deri në mëngjes nesër, s’është kurrfarë problemi.

Unë, zoti kryetar i Parlamentit, dola këtu në foltore, jo të flas me deputetët e “Vetëvendosjes”, as të Lidhjes Demokratike të Kosovës, as të “Nismës”, as të PAN-it. Dola t’u drejtohem qytetarëve të Kosovës për abuzimin e turpshëm që po e bëjnë në foltoren e Parlamentit disa deputetë, duke u thirrur në emër të patriotizmit, në emrin e shqiptarizmit dhe duke u treguar maskarenj e rrugaçë, që gjoja këta janë kundër Vuçiqit dhe kundër Serbisë.

Unë... ta përfundoj fjalën, tani ti dil fol këtu... Nuk jam duke ta cekur emrin, mos shkelmo prej vendit! Po flas unë njëherë, tani shkelmoni ju. Unë do të ha njëherë, tani hani ju. Unë...

KRYETARI: Vetëm pak, kolegë deputetë! Ju kisha lutur, kolegë deputetë, kualifikimet personale edhe te përfaqësuesi i LDK-së, edhe tash, s'do të në bëjnë nder asnjërit. Sido që të jetë, ata minuta që i keni, shfrytëzoni si të doni, por nuk është mirë gjërat që s'kanë të bëjnë me këtë debat t'i vëni në këtë seancë.

MILAIM ZEKA: Zoti kryetar, deri nesër flasim...

KRYETARI: Vetëm pak, Milaim Zeka, janë duke të ikur minutat. I ke 8 minuta e 26 sekonda, fol.

MILAIM ZEKA: Jo, nuk më numërohen minutat që erdhi Kujtimi e m'i hëngër sekondat. Kujtimi më ka diskriminuar.

KRYETARI: Ju lutem, regjia, një minutë e ka humbur. Vazhdo debatin. Glauk bëhu gati, Avdullah Hoti si deputet pastaj menjëherë.

MILAIM ZEKA: Ju lutem, zoti kryetar, unë vij nga një fshat që quhet Obri dhe fshati im i ka 100 njerëz të vrarë. Në mesin e të vrarëve e të zhdukurve, që foli këtu dikush, s'po dua të flas me emra, është edhe nëna ime. Më datë 12 prill m'i kanë kidnapuar prindërit e mi në Sofali dhe abuzimi që po na bëhet neve se gjoja ne kemi rënë në prehrin e Vuçiqit është abuzim i turpshëm, është abuzim fyes për neve dhe degradues si njerëz, që këto edhe në mesin e "Vetëvendosjes", edhe në mesin e LDK-së, edhe në mesin e PAN-it ka të burgosur politikë, ka luftëtarë të lirisë, ka njerëz që tërë jetën e vet ia kanë kushtuar veprimtarisë anti-Beograd. Mos u thirrni në patriotizëm, mos u thirrni në kartat e idiotizmit dhe të logjikës së Milosheviqit, i cili e ka fundosur Serbinë me kartat tuaja, që është thirrur dhe ka abuzuar me nacionalizmin serb që ka thënë se popullit serb po i rrezikohet ekzistenca. Dhe, ju në vend se ta kundërshtoni programin qeveritar të Ramush Haradinajt... po, do të vijë Ramushi nesër, hiç mos ta ndien, se ti e ke bërë kulaçin me këta, 4 vjet ju keni 'vllaçitë' bashkë. Ti bile s'ke të drejtë morale të flasësh! Hiç, hiç, të lutem... ti dil në foltore këtu deri në sabah do të debatojmë bashkë. Ju jeni shkaktarët kryesorë, PDK-ja dhe LDK-ja, që e keni shkatërruar këtë vend.

Prandaj, më avash. Këta kanë pak të drejtë ta kritikojnë Qeverinë se s'kanë qenë në pushtet. Ju hiç mos flisni! 'Sallamadi' ju e keni bërë këtë vend! Por, unë dola diçka të them, dhe po e përfundoj shkurt. Ata që mendojnë se ne, disa deputetë, e kemi kthyer

kryet nga Beogradi, në qoftë se unë e kam kthyer kryet nga Beogradi, ju e keni kthyer bythën nga Beogradi. Dhe...

KRYETARI: Ndale fjalën, të lutem...!

MILAIM ZEKA: Jo, jo,...

KRYETARI: Jo, jo, këtë fjalor s'e lejoj dhe s'do ta lejoj për asnjë sekondë. Milaim Zeka, jo! Dëgjoni, unë dy vjet e gjysmë kam qenë kryetar, jam munduar të toleroj. Dëgjo, dilni jashtë, te mediat dhe flisni me fjalor të tillë. Mos e abuzoni Kuvendin. S'keni të drejtë asnjëri. Vetëm pak, ju kisha lutur, Glauk Konjufca, Avdullah Hoti. Të lutem, dëgjo, nuk lejoj fyerje, të cilat janë familjare, njerëzore dhe ligjore. Kush ka guxim, le të shkojë aty ku duhet! Vetëm për pushtet u bëmë turp para krejt qytetarëve. Veç kur është qeveria, ne shpohemi në mes vete dhe e "mbrojmë" atdheun, veç kur është hyrja në pushtet!

Urdhëro! Të lutem, Milaim, është turp, të lutem!

Glauk Konjufca, e ke fjalën si deputet. Dhjetë minuta i ke, shfrytëzoji!

GLAUK KONJUFCA: Zonja dhe zotërinj,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Një prej detyrave më të vështira, siç po shihet, në këtë legjislaturë të Kuvendit të Republikës së Kosovës do të jetë, dhe këtë duhet ta bëjë secili prej nesh, të përpiqemi t'ia kthejmë dinjitetin diskutimit pas fjalimeve të Milaim Zekës. Domethënë, kjo duhet të jetë detyra e secilit prej nesh në këtë foltore. Do të jetë e vështirë, për shkak të fjalëve, të cilat ai i ka, le të themi, në formimin e vet që t'i përdorë. Mirëpo, secili prej nesh, në këtë foltore duhet ta japim kontributin tonë që ta sjellim diskutimin aty ku duhet dhe jashtë banalizimeve e vulgarizimeve që i bën Milaim Zeka.

Prej vitit 2007, pra dhjetë vjet po bëhen, në Republikën e Kosovës që pushteti është përbërë vazhdimisht nga një konstantë dhe nga disa variabla. Konstanta e pushtetit ka qenë vazhdimisht Partia Demokratike e Kosovës, e cila vazhdimisht ka qenë në pushtet prej vitit 2007, kurse variablat, ato që kanë ndryshuar vazhdimisht, dy herë ka qenë LDK-ja, dy herë ka qenë AKR-ja dhe tash këtij karvani iu bashkëngjiti edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Pra, iu bashkua në orët e fundit të afatit për lidhjen, siç e mbani në mend, të koalicioneve parazgjedhore. Shprehur me terma mjekësorë, PDK-ja është sikur njëfarë lloj virusi, ndaj së cilës në skenën politike të Kosovës imunitetin e nevojshëm deri tash ka treguar që e ka vetëm Lëvizja "Vetëvendosje".

Siç po e shohim këtu, ne jemi mbledhur në një seancë të jashtëzakonshme që ta debatohet programin dhe platformën qeverisëse të Qeverisë Haradinaj, por ajo që nuk po e shohim këtu është Qeveria Haradinaj. Ky është shembulli që ata po e japin në ditën e parë të punës së tyre! Ata nuk janë të pranishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Kuvend i cili i zgjodhi ata. Kjo tregon se çfarë shembulli po japin ata! Në ditën e parë po na tregojnë se si do ta qeverisin Republikën e Kosovës! Po na tregojnë se qeverisjen e tyre do ta mbështesin mbi shpërfilljen totale të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Republika jonë, siç e dimë, ka karakter parlamentar, Qeveria ka relacion llogaridhënës ndaj Parlamentit të Republikës. 53 deputetë kanë thirrur seancë të jashtëzakonshme, kurse Qeveria Haradinaj nuk shfaqet këtu për të mbrojtur konceptet e tyre dhe për ta mbrojtur programin e tyre qeverisëse. Kjo tregon se ata, në fakt, nuk kanë fare program qeverisëse. Nëse shikoni atë që është quajtur “Platforma e qeverisjes së Kosovës prej vitit 2017 deri në vitin 2021”, tash u bë publike edhe nëpër medie, e keni secili prej jush në dorë, ajo është njëri prej programeve më të dobëta që është prezantuar ndonjëherë në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Nëse po ju kujtohet ai plani “Banjsko” i Hashim Thaçit, që u pati bërë me disa sllajde, duket “punim i doktoraturës” në krahasim me këtë që është prezantuar nga Qeveria Haradinaj, e për vetë planin “Banjsko” të mos flasim, ai ishte një plan të cilin e kemi kritikuar e ka qenë edhe ashtu shumë i dobët. Mirëpo, ky program qeverisëse e kishte vetëm një të mirë. Unë mendoj se megjithatë e ka një të mirë. Mendoj se është i vetmi program që nuk është shkruar prej ekspertëve, por prej dorës së kryeministrit, sepse është shumë i dobët. Domethënë, si tekst, po qe se e lexoni, është njëri prej teksteve më të dobëta që është sjellë në Kuvendin e Kosovës, prandaj unë mendoj që Ramushi me dorë të vet e ka shkruar. Kjo është e mira e vetme që ka, pra sinjeriteti i këtij programi qeverisëse.

Ne do të kërkojmë që kjo seancë e jashtëzakonshme, në të cilën nuk po shfaqet Qeveria e Kosovës, të vazhdojë. Do të ishte mirë që pas dy ditësh të vazhdojë kjo, që Qeveria të shfaqet dhe ta mbrojnë atë me të cilën janë prezantuar përpara popullit të Kosovës. Çka do të bëjnë për arsimin, çka do të bëjnë për shëndetësinë, si do t’i qasen ekonomisë, çfarë reformash parashohin në drejtësi? Të gjitha këto t’i mbrojnë këtu ku është vendi. E vendi është Kuvendi i Kosovës, aty ku Qeveria duhet të jetë e pranishme dhe t’i mbrojnë idetë dhe konceptet e veta.

KRYETARI: Zoti Avdullah Hoti, në emrin tuaj, si deputet e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: I nderuar zoti Veseli, po vazhdoni me avazin tuaj. Dje e bëtë shkeljen e parë të Rregullores së Kuvendit. Po vazhdoni me udhëheqje jodinjitoze të

Kuvendit. Unë kërkoj që të merren të gjitha masat sipas Rregullores ndaj deputetit Zeka për përdorimin e gjuhës joparlamentare në Kuvendin e Kosovës, të cilin ju e lejuat. Ia dhatë fjalën pa asnjë rend dhe jo sipas Rregullores. Ndërkohë, që unë flas në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju i shihni sekondat e fundit se sa kanë mbetur.

Kërkoj që Qeveria e Kosovës, tanimë e votuar në Kuvendin e Kosovës, të paraqitet para deputetëve, para Kuvendit, sepse është obligim kushtetues. Kërkoj nga ju dhe nga Sekretaria e Kuvendit që të shtoni këtu karriget për t'i akomoduar të gjithë ministrat që i keni, 26, 27 a 30, as vetë s'e dini se sa janë dhe kërkoj që kjo seancë të mbahet të martën në orën dhjetë, me diskutimet e deputetëve, sepse ka shumë çështje e pyetje nga të gjithë deputetët.

Edhe unë me fjalimin në emër të LDK-së kisha disa pyetje për kryeministrin, i cili duhet të japë përgjigje para nesh dhe para qytetarëve të vendit. Ju lutem që të ftoni, ta obligoni Qeverinë që të paraqitet në Kuvend të martën në orën 10:00 e të vazhdojmë debatin për këtë platformë qeverisëse, që është prezantuar para deputetëve dhe para qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë, i nderuar koleg deputet. Po ma interpreton që disa herë Rregulloren. T'u kisha lutur, ke kolegë deputetë, ta sqarojmë a ka pasur shkelje, apo si ka qenë situata e vendimmarrjes sime. Mos më vër në pozicion të vështirë për të diskredituar publikisht. Ajo çka the për deputetin, kthehu pak mbrapa, shiko! I kam kërkuar në mënyrë njerëzore ta lëshojë sallën, e ka lëshuar. I kam kërkuar që të kërkojë falje, ta tërheqë fjalën, ose ta lëshojë sallën. Ai e ka lëshuar sallën. Unë me zor nuk mund... ti e sjell këtu, e sjell me zor, në qoftë se ke mekanizëm, për ta tërhequr fjalën. Por, unë ia kam ofruar dy mundësi në bazë të Rregullores. Nuk ka pranuar ta tërheqë fjalën, e kam nxjerrë jashtë. Po, është i përjashtuar. Ja shiko, nuk është. Është i përjashtuar prej seancës. Kthehuni, ju lutem, shikoni!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dy grupet parlamentare keni kërkuar, si deputetë, me aq sa po shoh, shtyrjen. Unë prapë do t'i referohem Rregullores. Për ta shtyrë keni pasur të drejtë të kërkonit, por duhet të ketë vendimmarrje, duhet kuorum për këtë vendimmarrje. Unë nuk mund ta shtyj, as ju vetë nuk mund ta shtyni! Kështu që, ne e përfundojmë sot këtë debat, thjesht, ju keni mundësi të tjera, të cilat i dini, pastaj... Edhe kështu po ma interpretoni Rregulloren. Në bazë të Rregullores veproni. Arben, po fjala për ty. Le ta japë opsionin, edhe kështu e kam pasur mësuesin e parë të Rregullores.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Seancën është mirë ta ndërpresim. Nuk mund ta përfundoni, mund ta ndërprisni. Në mbledhjen e Kryesisë vendoset për një datë tjetër, kur mund të mbahet seancë. Kështu që sot mund të ndërpritet, mblidhet Kryesia, herën tjetër, të hënën a kurdo dhe vendosni për seancën e re. Kemi propozimin e LDK-së dhe të “Vetëvendosjes” dhe me grupet tjera vendosni se kur do të mbahet. Faleminderit!

KRYETARI: Është si opzion, është çështje e vullnetit, por realisht unë s’mund... Urdhëro, zoti Avdullah Hoti! Shkojmë në bazë të Rregullores, këtë çdo herë po ma interpretoni e theksoni dhe unë në bazë të saj do të shkoj.

AVDULLAH HOTI: Atëherë unë kërkoj që sot menjëherë të thirret mbledhja e Kryesisë dhe vazhdimi i kësaj seance të caktohet për të martën, në orën 12:00.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në qoftë se dëshironi ta ndërpritni këtë, pastaj unë e thërras mbledhjen e Kryesisë, por s’mund ta përcaktosh, zoti ministër, të martën, se as unë s’mund ta përcaktoj. Vetëm 40 nënshkrime tuajat më nevojiten për të vepruar siç kam vepruar mbrëmë. Kjo është për interpretim të Rregullores. A dëshironi ta ndërpresim për sot? Po! Atëherë, atëherë... s’ka vendim, por po shoh se ka një pajtueshmëri të të gjithëve, e ndërpresim sot seancën. Faleminderit!

* * *

E hënë, më 2 tetor

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 10 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 59 deputetë. Në mungesë të kartelave elektronike, lus deputetët, të cilët paraqiten për diskutim, këtë ta bëjnë me ngritje dore.

Kërkoj nga grupet parlamentare që emrat e deputetëve për diskutim t'i dorëzojnë me shkrim te kryesuesi i Kuvendit.

Fillimisht ju njoftoj se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, sipas rekomandimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendimit të presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës si në vijim:

1. Zoti Nait Hasani, kandidat i koalicionit PDK/AAK/NISMA/PD/LB/PSHDK/PKK/ADK/RK/PB/PS/BKK”, kështu është, zyrtarisht e lexova, e zëvendëson zotin Ramush Haradinaj, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të emërimit kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.

2. Zoti Bekë Berisha, kandidat i koalicionit të lartpërmendur, e zëvendëson zotin Pal Lekaj, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të emërimit anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.

3. Gani Dreshaj, kandidat i koalicionit të lartpërmendur, e zëvendëson zotin Rustem Berisha, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të emërimit të anëtarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.

4. Njëjtë shkojmë te zoti Enver Hoti, dhe njëjtë te zoti Fadil Beka.

Pastaj, pesë janë nga koalicioni i lartpërmendur, të cilët ndërrohen. Kemi edhe zëvendësimet e tjera.

Zoti Imet Rrahmani, kandidat i Koalicionit LDK-AKR, e zëvendëson zotin Behxhet Pacolli, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të emërimit anëtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.

Edhe zoti Bahri Shabani, kandidat i subjektit politik Koalicija Vakrat, e zëvendëson zotin Rasim Demiri, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të emërimit anëtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017.

Andaj, kërkoj që ju, të nderuar të lartpërmendur, të ngriteni në këmbë për dhënien e betimit, të dëgjoni tekstin e betimit që do ta lexoj unë dhe në fund ju ta shqiptoni fjalën “Beto hem!”.

Kisha kërkuar nga kolegët të ngritën në këmbë, për arsye se po kërkojnë deputetët, zakonisht në Kuvend e kemi bërë praktikë.

Atëherë, në qoftë se kisha pasur mirëkuptimin e seancës, unë po e lexoj këtë pjesën e betimit, e ata dy kolegët deputetë le të nënshkruajnë, po i marrim si të mirëqenë, sikur janë ngritur në këmbë edhe janë betuar.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Beto hem!”

Ju lus, kolegë deputetë, pas betimit që personalisht të nënshkruani tekstin e deklaratës së betimit dhe t’ia dorëzoni Sekretarisë së Kuvendit.

Deputetëve të rinj u dëshiroj mirëseardhje edhe punë të mbarë në Kuvend.

Në vazhdim procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se seanca e jashtëzakonshme, sipas kërkesës së grupit prej 53 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i ka ndërprerë punimet më 10 shtator 2017.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017, ka vendosur që seanca e jashtëzakonshme t’i vazhdojë punimet më 2 tetor 2017 rreth kësaj teme.

Për njoftim: Ju njoftoj se në seancën e jashtëzakonshme të filluar më 10 shtator 2017 kanë diskutuar: deputeti Albin Kurti, në përfaqësim të grupit të deputetëve, deputeti Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe deputetët Milaim Zeka, Glauk Konjufca dhe Arben Gashi.

Pas diskutimeve, seanca e jashtëzakonshme i ka ndërprerë punimet dhe është vendosur që për vazhdimin e kësaj seance të merret vendimi nga Kryesia e Kuvendit dhe sot vazhdojmë me kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare të cilët nuk janë deklaruar.

Po i fusim të gjitha grupet parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosja”, vazhdojmë me rend.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës! Kjo seancë e jashtëzakonshme është dashur të mbahej përpara tri javëve, atëherë kur është thirrur.

Dhe, njeriu argumentin e vetëm pse duhet të bëhet kryeministër i Kosovës e ka shpejtësinë dhe dinamikën, del para opozitës në Kuvend me tri javë vonesë, bile nuk qenka këtu fare!

Merre me mend, çfarë efektiviteti mund të kemi me një qeverisje, ku kryeministri një ditë të tij e konsideron tri javë për demokracinë. Pra, një ditë e kryeministrit tonë është tri javë për demokracinë.

Kryeministri Haradinaj doli atë ditë që duhej të vinte këtu në sallë përpara gazetarëve në hollin e Kuvendit dhe u tha me arrogancë se nuk merr pjesë në një seancë ku janë vetëm 31 deputetë të opozitës në sallë.

Ai harroi që vetëm pak muaj më parë ishte pjesë e një opozite të bashkuar, e cila i kishte vetëm 30 deputetë. Ai ishte pjesë e kësaj opozite.

Kur Qeveria Mustafa, e shpërfillte opozitën me 30 deputetë, Ramushi e kritikonte, e kritikonte Isa Mustafën. Kurse tash vetë, kur është ulur në kolltukun e kryeministrit, e bën pikërisht atë gjë që e kundërshtonte.

Kjo sjellje, zonja dhe zotërinj, është shumë karakteristike për njerëzit joparimorë. Domethënë, ata e ndërrojnë pikëvështrimin politik për gjërat varësisht se ku janë të ulur dhe i gjykojnë proceset sipas pozicionit që e kanë.

Në anën tjetër, vetë shpërfillja e 31 deputetëve të opozitës, të gatshëm për debat, e shpalos mentalitetin politik të kryeministrit Haradinaj që është përcaktuar për ta shkelur Kuvendin, kurse opozitën e konsideron si një institucion të pavlefshëm që nuk ia vlen të merresh me të.

Unë e kam një pyetje për kryeministrin: Zoti kryeministër, a e dini ju që me Kushtetutë jo 31 deputetë, po gjashtë deputetë mjafton të thërrasin në interpelancë dhe ti duhet “të vizatolesh” në Kuvendin e Kosovës dhe të japësh llogari e përgjegjësi? Kjo është elementare për demokracinë, për të gjithë ata që kanë haber në demokraci.

Por kjo tregon më saktësisht që kryeministrit tonë nuk i pëlqen fort llogaridhënia dhe përgjegjësia, por i pëlqen veç një komponent tjetër e kryeministrit, që është kompetenca.

Zoti kryeministër, në demokraci shkojnë tri në një: kompetenca, përgjegjësia, llogaridhënia. Nuk mund t’i ndash, ta duash veç kompetencën e qeverisjen, po të mos japësh përgjegjësi edhe llogari.

Me të vërtetë, për të kuptuar qysh do të qeverisë Qeveria Haradinaj, nuk kemi fort nevojë ta lexojmë programin qeveritar. Bile, më së pakti e kuptojnë qysh do të qeverisin nëse ia lexojmë programin.

Çdo qeveri e deritashme e Kosovës e ka shkruar nga një program si ky, që na e keni sjellë, ku besatohet fuqishëm me sundimin e ligjit, me luftimin e pakompromis të korrupsionit, me zhvillimin e hovshëm ekonomik të vendit, me përmirësimin e arsimit dhe me rregullimin e shëndetësisë.

Çdo program që na e ka sjellë çdo qeveri e Kosovës deri tash i keni pasur këto. Por kur e shohim korrupsionin që lulëzon çdo segment institucional, nepotizmin kronik, ngecjen ekonomike, degradimin e pafund të arsimit si dhe shkatërrimin në themel të shëndetësisë, siç na ka ndodhur neve vazhdimisht, atëherë kuptojmë që këto programe qeverisëse nuk janë asgjë më shumë se sa përmbledhje frazash formale, të cilat e kanë për detyrë të përmbushin veç një perceptim: perceptimin që qeveria paska program, që qeveria paska koncept, e kështu me radhë.

Prandaj, unë them që më mirë është Qeverinë Haradinaj ta analizojmë prej kur u themelua deri sot. Si qeverisi, çfarë shembulli dha për tri javë ditë, sepse 100 ditë bëhen shumë shpejt dhe thonë: “Dita e mirë shihet në mëngjes”.

E sa i përket Qeverisë Haradinaj, ne do të analizojmë si qeverisi ajo në këto tri javë të para të mandatit dhe çfarë shembulli dha.

Së pari, vetë qysh u krijua, na e dha shembullin më të keq të një qeverie të ndërtuar mbi pazare të ulëta.

Kjo na kujtohet më së pari kur e sjellim ndërmend mënyrën se si u krijua Qeveria Haradinaj.

Të mos harrojmë, për t'i bërë 61 vota, kjo qeveri ka bërë zgjidhje të çuditshme dhe absurde. Këtu kemi parti politike që i kanë tre deputetë e katër ministri, merreni me mend, më shumë ministri se deputetë! Kjo nuk ndodh askund në botë.

Këtu e kemi Listën serbe, e cila kësaj radhe i mori tri ministri dhe mbi të cilën plotësisht për nga votat dhe numri i deputetëve të kësaj qeverie, për ta mbajtur shumicën e nevojshme parlamentare, është plotësisht e varur nga numrat e Listës serbe.

Të mos harrojmë, këtu kemi ministri që janë shpikur për t'i akomoduar dostat, ju po e dini për cilat ministri e kam fjalën.

Kurse e keni vërejtur edhe një absurd tjetër.

Nga frika se kur të hiqen deputetët, të cilët bëhen ministra, atëherë vijnë në radhë deputetët nga partitë e tjera, PDK-ja është detyruar që asnjë deputet që e ka këtu të mos bëhet ministër.

Nga frika të vijnë deri aty ku është e sigurt që vjen deputeti i vet, por jo më shumë, sepse vinë të "Nismës" dhe të AAK-së.

Tjetra, një ministri veç për ata që janë të gatshëm të hidhërohen dhe ta vënë në rrezik këtë qeveri.

Për shembull, një ministri veç për Arsim Demirin. Ai e kërkon një. A po i doni 61 vota, duhet të më jepni një ministri!

Tjetra, këtu ngritja e një dore kushton një ministri, në këtë qeveri që e kemi mbrapa. Është ajo 'vota e siguresës' që e quaj unë, Teuta Rugova. Dardan. Domethënë një ministër për një ngritje dore, eventualisht, kur të vijë këtu mocioni i mosbesimit një ditë, edhe nëse është qar në krah të majtë Zafir Berisha, megjithatë e kemi Teuta Rugovën. Po, për këtë kushton një ministri.

Domethënë, definitivisht Qeveri e ndërtuar mbi pazare të nivelit më të ulët.

Tjetra? Shumë pikëlluese kjo të varet prej Listës serbe në këso mënyre. Ju po e mbani mend ditën kur është krijuar Qeveria qysh është shtyrë seanca për katër orë, edhe arsyeja ishte e qartë: e prisnin Listën serbe që të kthehej nga takimi me Gjuriqin, i cili shef e ka Vuçiqin dhe në bazë të tyre instruksioneve të vinin e të vepronin në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Dhe, unë mund të them që vizita e parë e kësaj Qeverie logjikisht nuk ka qenë në Shqipëri. Vizita e parë e kësaj qeverie ka qenë në Moskë. Një pjesë e qeverisë, nëse Lista serbe është pjesë e qeverisë zyrtarisht, institucionalisht, këta ditën e dytë pas zgjedhjeve kanë shkuar në Moskë, kanë bërë vizitën zyrtare, e kanë falënderuar Putinin që s'po e njeh pavarësinë e Kosovës dhe janë besatuar me të që të vazhdojnë këtë rrugë. E Kadri Veseli e akuzonte "Vetëvendosjen" që po e sjell Serbinë brenda! Atë ditë na akuzonte, kurse pjesa e qeverisë së tij shkon në Moskë, e këta bëjnë marrëveshje me Listën serbe, e marrëveshjen nuk e dimë të plotë ne ende, do të dalë ajo marrëveshje ende, ne nuk e dimë!

Atëherë, kur është bërë në mandatin e kaluar ajo marrëveshja me Listën serbe, pas tetë muajve ndodhi "Zajednica", s'po e di a po ju kujtohet, në dhjetor të vitit 2014 u krijua qeveria e kaluar, në gusht të vitit 2015...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Po, kisha pasur dëshirë të orientohemi në temë. Realisht, nganjëherë po më duket sikur kolegë të caktuar si të mos kishin qenë në Kuvend dhe po na injorojnë, duke menduar veç qysh 'të shiten' më mirë në opinionin publik. Në fushatë elektorale jemi, e di çdokush kush është te Moska, nga një traditë e kemi secili, po s'është mirë të dalim aty fare se nuk dihet ku dalim.

O, Glauk Konjufca, nuk je Zoti, ulu, pusho, mbaje rregullin, për arsye se nuk je Zoti që çdokujt t'ia bësh me dorë. Avdullah, e dëshiron fjalën, se e ngrite dorën? Fjala për ju.

AVDULLAH HOTI: Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Unë do të filloj fjalën time me një, prapë edhe një herë po e përsëris, me një sugjerim për kryetarin e Kuvendit që t'i përmbahet Rregullores së Punës, sepse ky debat është dashur të mbahet para tri jave.

Ne i kemi përfillur të gjitha procedurat ligjore për të kërkuar mbledhje shtesë të Kryesisë së Kuvendit për caktimin e vazhdimin të seancës, nuk është thirrur mbledhja, arsyeja

është e thjeshtë: kryetari i Kuvendit është në fushatë zgjedhore, siç jemi të gjithë, por kemi obligime shtetërore, të cilave duhet t'u dalim zot, sepse kemi pranuar t'i marrim këto obligime në Kuvend dhe në institucione. Askush nuk është Zot, por të gjithë u nënshtrohemi Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Më lejoni të theksoj, kjo është qeveria e parë në 17 vjet që është votuar në Kuvendin e Kosovës pa debat parlamentar dhe është vetë shumica parlamentare që e ka votuar anulimin e debatit me rastin e votimit të qeverisë.

Kryeministri ka injoruar 59 deputetë të opozitës, që është e papranueshme. Tani ai është prezent dhe unë e ftoj që ai të jetë prezentë në seanca të Kuvendit e të mos e quajë debatin e kërkuar nga opozita, si "cirk", siç e ka quajtur në hollin e Kuvendit, sepse në seancën e ardhshme kryeministri dhe shumica do të kenë nevojë për votat e opozitës për ratifikimin e marrëveshjes IPA dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera.

Unë ju them sot publikisht, nëse ju nuk qëndroni si kryeministër, bashkë me Kabinetin qeveritar këtu përpara deputetëve, për të dhënë llogari për mënyrën se si është themeluar Qeveria, si janë arritur ato pazaret e ulëta, në Grupi ynë Parlamentar, nuk do ta aprovojmë, nuk do të marrim pjesë me votimin për ratifikimin e marrëveshjes IPA dhe asnjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare që kërkon 2/3, pra që kërkon votat e opozitës. Ky është deklaram publik, sepse një shumicë si është themeluar në këtë qeveri, është plotësisht e varur nga opozita. Ditët i keni të numëruara dhe unë ju garantoj për këtë, por le të punojmë në interes të qytetarëve të vendit, duke ratifikuar marrëveshjen IPA në seancën e ardhshme, por ju ftoj që të silleni në mënyrë konstruktive, nëse jo, këto janë pasojat të cilat do t'i keni.

Ju e dini se si është themeluar kjo Qeveri, më lejoni të përmend edhe një herë përpara juve, pas 2-3 muajve vonesë, nëpërmjet sigurimit të votave nga kontrabandimi i deputetëve, nëpërmjet pazareve të ulëta politike. Është çështje juaj se si i keni arritur këto marrëveshje, por që duhet të jepni përgjegjësi para qytetarëve të vendit dhe para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Dhe, më tragjikja është dakordimi i plotë dhe varësia e plotë nga Beogradi. Është e pafalshme që pas 17 vjetëve ne tash të kthejmë funksionimin normal të institucioneve të vendit në varësi të disponimit që vjen nga Beogradi.

E respektoj plotësisht të drejtën e deputetëve të komunitetit serb për të qenë pjesë e institucioneve dhe i respektoj plotësisht të drejtat e tyre, por është e pafalshme që tash të kushtëzohemi në çdo vendim që merr kjo qeveri dhe ky Kuvend nga ana e shumicës nga deputetët e Listës serbe. Vendi nuk ka dalë nga kriza me zgjedhjen e kësaj qeverie, përkundrazi është thelluar kriza, është e pafalshme që ende kemi 1 mijë e 600 të pagjetur nga lufta e fundit dhe nuk mund të hapet kjo temë me këtë përbërje të qeverisë. Ne si

Lidhje Demokratike do të jemi gardian të mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, për të ndaluar këtë qeveri të çojë vendin mbrapa ashtu si ka filluar me shkëlqje të vazhdueshme, duke shkarkuar borde me “hu në krah”, duke shkelur procedurat ligjore të shpronësimeve, duke marrë veprime arbitrare jashtë çfarëdo kornize ligjore dhe kushtetute në vend.

Ka shumë për t’u sqaruar, unë e ftoj kryeministrin që të qëndrojë deri në fund të seancës, t’u japë përgjigje deputetëve të Kuvendit të Kosovës për marrëveshjen që ka arritur për themelimin e koalicionit qeverisës, për atë se çfarë përfaqësojnë disa anëtarë të kabinetit brenda kësaj qeverie. Të sqarojnë se çfarë do të bëjnë 4-5 ministri me fushëveprim të njëjtë, si: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e Tregtisë, e Arsimit, tash e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Të sqarojnë se si do e adresojë çështjen e AKSOS-it, edhe plot probleme të tjera, me të cilat tash do të përballet. Të sqarojnë në veçanti fushëveprimin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që dijeni është një precedent i rrezikshëm për kushtetutshmërinë në Kosovë. Nuk guxojmë ne ta rajonalizojmë vendin nëpërmjet ministrive të tilla. Jemi marrë në dhjetë vjetët e fundit, kemi parandaluar një gjë të tillë, në të gjitha segmentet e shoqërisë: në polici, në gjyqësi, edhe në çështjet ambientale, në të gjitha çështjet pa përjashtim. Ndërkohë që tash themelohet një Ministri e Zhvillimit Rajonal, unë ju paralajmëroj ku po e çoni vendin duke rajonalizuar çështje që kanë të dalin në funksion të natyrës plotësisht politike.

Unë kërkoj nga kryeministri që të bëjë të qartë marrëveshjen që ka arritur me Listën serbe, edhe me Vuçiqin, në këmbim të mbështetjes që ka marrë nga Lista serbe, konkretisht si janë marrë vesh për themelimin e Asociacionit të Komunave, e sipas të gjitha informatave pretendojnë ta themelojnë nëpërmjet marrëveshjes që kanë arritur, e jo sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese. Cilat janë premtimet për Komunën e Prilluzhës, të Gorës, e në veçanti rolin e Radoiqit në arritjen e këtij koalicioni.

Dokumenti që kemi marrë, të nderuar deputetë, parimet programore, dokument dhjetë faqesh, që secili nga deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së do ta marrë fjalën për të prekë segmente të caktuara të këtij dokumenti dhjetë faqesh. Është fatkeqësi të votohet një qeveri me një dokument të tillë, pa asnjë vizion se çfarë do të bëjë me temat e mëdha të këtij vendi, si do ta mbajë zhvillimin ekonomik që është arritur 4% gjatë kësaj qeverie. Si do ta mbajë buxhetin 2 miliardë euro, është për keqardhje që tani veç vjen rishikimi i buxhetit në Kuvend me 200 milionë euro më pak se sa ka qenë në qeverinë paraprake. Si do t’i mbajë relacionin me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke qenë se të gjitha marrëveshjet financiare ndërkombëtare varen nga relacioni që do të ketë qeveria me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Si do ta luftojë korrupsionin në radhët e veta, në veçanti dhe si do të adresojë çështjet e sfidave dhe reformave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Në veçanti, si do të bashkëpunojnë me opozitën, sepse shumicën e marrëveshjeve do të ketë nevojë për 2/3 e votave të deputetëve të Kosovës, në veçanti demarkacioni me Malin e Zi, kufirin me Malin e Zi. Është për keqardhje se si është adresuar ditët dhe javët e fundit kryeministri në media lidhur me çështjen e demarkacionit. Ne do ta mbajmë për fjalësh, është gjuajtur gaz lotsjellës, është përdorur dhunë për atë marrëveshje, ne do ta mbajmë për fjale kryeministrin publikisht për fjalët që ka thënë lidhur me demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Lidhja Demokratike e Kosovës si gjithmonë do të jetë opozitë konstruktive, por nuk do të lejojmë që institucionet dhe shoqëria kosovare të degradojë nga kjo lloj qeverie që është themeluar në këtë lloj formati. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës, pastaj do të vazhdojmë, deputetët qeveritarë, për arsye se po i shoh ka reagime nga Kabineti qeveritar, po e bëj kombinim mes deputetëve dhe Kabinetit qeveritar. Faleminderit! Urdhëro, zoti kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryesi e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të vendit,

Media,

Të gjithë të pranishëm,

Do të thotë, thirrja e seancës për ditën e zgjedhjes së Qeverisë dhe për mungesën e debatit për mua e ka një të vërtetë. Unë kam qenë deputet dhe i kam takuar grupit të deputetëve që kanë kërkuar debat. Pra, nëse kjo s'është e vërtetë, le të ma thotë dikush, kam kërkuar debat, kam pasur dëshirë ta dëgjoj debatin, jo vetëm të pritët një grup parlamentar që s'ishte këtu, por kam menduar se është diçka e drejtë. Ju lus, ne kemi një përvojë pune në Kuvend, dhe ju keni konsideratë në këto të vërteta, sepse respekti duhet të vijë reciprok. Nëse është e vërtetë që kërkesa për të mos pasur debat ka ardhur nga "Vetëvendosja" dhe LDK-ja, atëherë çfarë kriteri po përdorim ose çfarë serioziteti kemi ne ndër vete, nëse duam të kemi seriozitet. Nëse është veç fizkulturë, në rregull, e kuptoj atëherë. Kemi filluar me opozitarizëm, por nëse gjejmë ndonjë kriter si ta bëjmë këtë, është më mirë për të dy palët: për pushtetin, për opozitën dhe për qytetarët.

Edhe unë kam qenë ulur këtu, kam kërkuar debat, ka ardhur propozimi të mos ketë debat. Ka ndodhur si ka ndodhur, është votuar ai propozim. Unë s'kam ardhur për atë debat dhe nuk vij në seancë edhe 100 vjet të mbani diskutime, nuk vij se kam qenë këtu kur kam kërkuar debat, keni kërkuar që të votoni. Harrojeni këtë, mos bëni hajgare askush. Ju kam dërguar programin qeverisës brenda jave, i mirë, i keq, e keni programin. Kurdo që jeni të gatshëm të diskutojmë për programin qeverisës, vij dhe ju respektoj, ju respektojmë kërkesën për nesër, për raportim, pyetje, interpelancë, çdo kërkesë e Kuvendit do të respektohet. Sa i përket kësaj teme, mendoj që jeni duke bërë hajgare, vazhdoni me hajgare. E keni pasur mundësinë atë ditë, keni kërkuar që ta ndalni atë mundësi, tash po e paguajmë bashkë.

Dua vetëm të reflektoj diçka, në marrëveshjet që po thuhet me Listën serbe. Kolegët e Listës serbe janë këtu, mos harroni, nuk ka marrëveshje tjetër pos bashkëqeverisjes me përgjegjësi, qysh është bërë me çdo parti shqiptare, qysh është bërë me PDK-në, me "Nismën", me komunitete. E vetmja marrëveshje që ka Ramush Haradinaj me Listën serbe është që këto përgjegjësi t'i marrim, të punojmë në bazë të këtyre përgjegjësive në këtë vend dhe betimi është dhënë me Kushtetutën e vendit.

Unë nuk po shkoj çka ka ndodhur në të kaluarën, por kësaj here kështu e keni, nuk ka një germë të nënshkruar prej Ramush Haradinajt që e turpëron veten, familjen, vendin dhe interesin e Kosovës. Ndoshta, dikush e ka imagjinatën më të zhvilluar, nëse ndonjëherë historia gjen diçka tjetër, ballafaqohemi, por nuk ka. Unë ju ftoj që të rrimë në punë e t'i kushtohemi punës, unë kam respekt për opozitën, se kam qenë vetë opozitë tri mandate, e di çka është opozita, çdoherë do të jem.

Tani i kisha lutur për mirëkuptim deputetët, se po vazhdoj me punë, e ju vazhdojeni debatin. Faleminderit shumë! Ditën e mirë!

KRYETARI: Kolegë deputetë, vazhdojmë!

Ndërkohë që Kabineti qeveritar është duke u larguar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën. Vazhdojmë me seancën. Është vendim i Qeverisë. Ne jemi duke vepruar në bazë të Rregullores, do ta respektojmë pikë për pikë. Ju kisha lutur, kolegë deputetë, do të reagoj në momentin kur dilet nga rendi i ditës. Do ta mbajmë në bazë të Rregullores, keni kërkuar edhe nga unë që të jem strikt. Faleminderit!

Urdhëro, zoti Krasniqi, fjala është për ju, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar deputetë,

Tashmë jemi në një seancë, e cila, nëse ju kujtohet të gjithëve, burimin e ka pikërisht te loja e opozitës në raport me Qeverinë që ishte ende e pavotuar dhe me shumicën parlamentare.

Ditën kur duhej të votohej pikërisht Kabineti qeveritar, ishte opozita ajo që kërkoi të mos debatohej. Ishin po këta njerëz që sot po thërrasin për debat dhe e akuzojnë edhe Qeverinë për mungesë të vullnetit për debat, e që deshën të mos ketë atë ditë debat përkundër kërkesës sonë për debatim.

Dhe, kjo seancë buron pikërisht nga ky qëndrim krejtësisht joparimor, nga kjo lojë politike e ulët, e cila, për fat të keq, është duke vazhduar edhe sot e kësaj dite. Sot ju e patë se edhe në fjalimet e pararendësve absolutisht asnjë fjalë nuk u tha në lidhje me temën dhe titullin e seancës që e kanë shkruar propozuesit. Aty thuhet “parimet programore të Qeverisë...”, e kështu, e ashtu... por gati asnjë fjalë s’u tha kurrkush për parime programore. Njëra anë shpreh mllef dhe frustrim për qëndrimin e përjetshëm në pozitë, ana tjetër, që ende nuk po e dinë që janë në opozitë, e duhet ta kuptojnë sa më shpejt, dhe po ashtu na shantazhuan publikisht, e shantazhuan publikisht qytetarin e Kosovës se në kundërshtim me traditën politike që ka merituar vlerësim në gjithë këto vite në Kuvendin e Kosovës, pozitë-opozitë, kur është dashur që të mendohet për çështjet që ndërlidhen me të mirën e përbashkët, këta sot na thanë që do të votojnë dhe kundër programit IPA-marrëveshje me Bashkimin Evropian për t’i refuzuar 71,5 milionë euro, të cilat janë të dedikuara për qytetarët e Kosovës, sepse ato s’janë mjete të Qeverisë, e as të Parlamentit. Janë mjete të dedikuara për sektorët prioritarë të Qeverisë. Dhe ne sot e pamë një shantazh publik, një kërcënim për krejt qytetarët e vendit tonë, nga LDK-ja, kur thanë “ne s’ju votojmë nëse ju nuk u përmbaheni kushteve që jua vëmë ne”. Më falni zotërinj, ju jeni në opozitë, nuk mund t’i vendosni kushte Qeverisë, e as shumicës.

Por, unë mendoj se është jashtëzakonisht e nevojshme, pikërisht për ato që po i thoni, pikërisht për këtë balancë politike që për herë të parë e kemi, që të ketë një së paku tentim për mirëkuptim dhe që të ketë së paku një qëndrim parimor në lidhje me raportimin, që duhet ta bëjë Qeveria para të gjithë neve si deputetë, edhe para deputetëve të shumicës, edhe para deputetëve të opozitës.

Ju folët edhe për seancën dhe po flisni si të them, as sikur gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, po diçka edhe pak më shumë “u shkel Rregullorja, s’u shkel Rregullorja...” Kjo seancë është thirrur në pajtim me Rregulloren. E keni shfrytëzuar të drejtën tuaj për të thirrur seancë të jashtëzakonshme me 40 nënshkrime, është mbajtur pas dy ditësh. Ju keni kërkuar prapë të ndërpritet ajo seancë. Bile, shikuar tamam - kjo seancë ka përfunduar atë ditë, s’duhet të vazhdojë hiç. S’keni pasur njerëz, s’keni pasur deputetë, s’keni mundur ta mbani, keni thënë “po e ndalim”. Por, në momentin që ka përfunduar

kjo seancë, i nënshtrohet pastaj Rregullores dhe Rregullorja nuk kallëzon se seanca e jashtëzakonshme duhet të vazhdojë kur të keni qejf ju, mund të mbahet kur të doni ju. Ekskluzivitetin e përcaktimit të seancës e kanë deputetët që kërkojnë seancë të jashtëzakonshme. Kjo është e pakontestueshme dhe duhet të ruhet. Ju e keni përcaktuar dhe është mbajtur. S'keni qenë në gjendje, s'keni pasur kuorum, e keni ndalur. Nuk mund tash që me të njëjtat 40 nënshkrime prapë ta përcaktoni sa herë që s'keni kuorum, 25 herë. Po të mos kishim ardhur ne sot çfarë do të ishte bërë? Prapë s'do të kishit kuorum. Prapë me ato 40 nënshkrime, deri në fund të këtij mandati do ta vazhdoni seancën? Është e pamundshme. Dhe, jemi pajtuar, sepse kur e keni ndërprerë atë ditë seancën, për vazhdim jeni pajtuar që vendos Kryesia.

Kemi tentuar të merremi vesh atë ditë bashkërisht, kemi pasur një takim goxha të mirë dhe goxha normal, që ta dijë edhe opinioni publik, siç do të duhej të ishte, deri në një moment kur, për efekte publike politike të fushatës, u çuat kinse u bëtë nervoz dhe dolët të mbani konferenca e të shtyheni cili po dilni i pari, për t'ia marrë kartën politike tjetrit dhe të thoni "ne u hidhëruam valla". Nuk u hidhëruam, sepse ju e dëshironit një ditë, ne u thamë "hajde, po i bëjmë dy seanca". Le ta dijë opinioni. Pse ju thamë dy seanca? Sepse subjekti, objekti i kërkesës së kësaj seance është nul, është i tejkaluar. Po doni të flitni për fjalimin e kryeministrit në ditën kur e ka bërë ekspozenë në seancë. Domethënë, krejt çka po doni ju të diskutoni në bazë të kësaj kërkesë, janë parimet programore, atë që s'keni dashur atë ditë, pikërisht atë që s'keni dashur, ato dhjetë faqe që i përmendët. Ndërsa, më 19 shtator kjo Qeveri e ka dërguar te të gjithë deputetët programin, jo me dhjetë, por ndoshta me 120-130 faqe. Tash, pyetja është: A po doni përnjëmend të flitni për dhjetë faqe, apo 130 faqe? A po doni të diskutojmë për programi, apo po doni të bëni fushatë?

Ne jemi të gatshëm 100% edhe për fushatë, edhe për program. Po, veç fushata është mirë të bëhet jashtë Kuvendit, të mos keqpërdoret Kuvendi për fushatën lokale. Fushata është në terren, te qytetarët e Kosovës, atje ku jemi ne bashkë çdo ditë dhe çdo mbrëmje dhe besoj se edhe sot është mirë ta bëjmë atë punë. Përndryshe, programin e keni secili deputetë, secili grup parlamentar. Jemi absolutisht 100% të mendimit që duhet ta debatojmë atë program, duhet dhënë rekomandimet tona. Ka hapësirë për t'u përmirësuar, ka hapësirë për rekomandime dhe ka hapësirë për t'i sugjeruar Qeverisë çka të shtojë ose çka të ndryshojë në atë program. Po, a e keni përnjëmend të debatoni për program? Nëse e keni përnjëmend, atëherë hajde po merremi vesh, po e caktojmë seancën e debatimit për programin që tash e kemi, se materiali na ka ardhur në bazë të rregullave, e ka miratuar Qeveria, tash e dy javë është në Kuvend, secili e kemi pasur në sirtar. Nëse doni ta lexoni e lexoni, nëse s'doni ta lexoni prapë vijmë e diskutojmë për diçka që s'ka të bëjë me temën, por të thoni "s'po doni debat", kjo nuk është e saktë.

Arsyeja pse jemi sot këtu është pse s'keni dashur ju debat. Sot po doni të debatoni për diçka që s'ka asnjë kuptim më, për një fjalim të kryeministrit kur ka qenë kandidat për kryeministër, e njeriu e ka sjellë tash programin e Qeverisë, e kemi në dorë tash e dy javë ditë, e s'po doni të flitni për programin.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, unë kërkoj nga të gjithë që të merremi vesh sa më herët, nëse doni këtë javë ta mbajmë seancën, të diskutojmë gjerë e gjatë për programin e Qeverisë, por jo për fjalimin e kryeministrit kur ka qenë kandidat, sepse ajo ka qenë një ekspozë e tij, e cila nuk ka të bëjë në kuptimin, as cilësor, as konkret, as sasior, me programin që e kemi marrë.

Prandaj, kurdo që dëshironi, është mirë të mbajmë debat, ta mbajmë një seancë të veçantë, ashtu qysh e kemi mbajtur sa herë që i kemi votuar programet qeveritare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Liste serbe, e dëshironi fjalën? Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ahmet Isufi, fjala për ju.

AHMET ISUFI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar,

Sot kjo seancë vërtet s'e ka asnjë kuptim, vazhdimi i kësaj seance. Pse po e them këtë? Për shkak se është kërkuar që të ketë debat, opozita ka kërkuar që të mos ketë debat, është votuar në këtë Kuvend dhe më duket çështje e kryer kjo.

E dyta, është kërkuar që të flitet për parimet programore, e nuk është bërë as kuorumi nga ata që e kanë kërkuar dhe vetë e kanë shtyrë seancën.

E treta, e keni programin qeveritar, urdhëroni lexojeni, sepse njëri nga folësit tha: Nuk e lexojmë programin e kësaj Qeverie... Çuditshëm duan të kritikojnë, e nuk duan bile të shohin çfarë ka në atë program për ta korrigjuar Qeverinë dhe për t'ia dhënë kahun këtij vendi, që, në fund të fundit, të udhëheqin institucionet. Kjo Qeveri, u tha si është krijuar, megjithatë kjo Qeveri u krijua. Pajtohuni, shkojmë më tutje, të vazhdojnë të punojnë Qeveria, Kuvendit e institucionet e Kosovës dhe krejt ato që janë probleme ne mund t'i zgjidhim këtu bashkë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe është krejtësisht e pakuptueshme, sepse sa ekziston ky Kuvend, kur ka pasur çështje të rëndësishme kapitale për vendin, ka pasur unitet, ka pasur marrëveshje, ka pasur edhe votime, të cilat vërtet e kanë nderuar këtë institucion. Prandaj, çdo marrëveshje ndërkombëtare që ka ardhur këtu, pavarësisht nga pozicioni pozitë-opozitë dhe dallimet që kanë mundur të ekzistojnë. Për ne është e çuditshme që del dikush këtu dhe thotë ne

s'e votojmë një program të Bashkimit Evropian dhe thotë, "sepse i kemi disa çështje tjera". Çështjet tjera duhet t'i lëmë veç pozitë-opozitë, por për çështjet kapitale për vendin gjithmonë duhet të jemi unikë pavarësisht prej pozicioneve.

Po ashtu, unë po ju them se kjo Qeveri ka filluar të punojë me një dinamikë shumë më të madhe, shumë më të mirë, me një program që konsideroj se do të debatohet këtu nëse është interesimi i deputetëve normalisht, por lejojeni mundësinë që e ka çdo Qeveri që për 100 ditë ta tregojë veten, pastaj urdhëroni, mos i ndalni kritikën, punoni çdo ditë si opozitë, kryejeni obligimin tuaj, por paraprakisht ruajuni prej atyre që mund të jenë acarime të fjalorit, sepse, në fund të fundit, ne jemi të interesuar që ky vend të ketë funksionalitet, të ketë qeveri serioze, që e zhvillon vendin, pavarësisht kush mund të jetë në qeverisje.

Unë e konsideroj zotin Haradinaj shumë funksional gjatë këtyre ditëve, bashkë me Kabinetin qeveritar dhe i dini veprimet që i kanë ndërmarrë, qoftë me Haden dhe Shipitullën, qoftë me veteranët, qoftë me bordet politike, e dini se menjëherë ka filluar të veprojë ashtu si duhet vepruar, qoftë me trajtimin që e ka përmend për Ligjin për Prishtinën, po ashtu edhe trajtimin e rrugëve, trajtimin e "Trepçës" për gjendjen që e ka sot, e shumë tema të tjera, që i dini edhe ju. Edhe një ju kisha lutur, mos fantazoni se çfarë ka mundur dikush të mendojë e të veprojë, por bazohuni më mirë në fakte, dilni me fakte kritikoni, e keni atë të drejtë, sepse opozita këtë rol e ka.

Dhe, përfundimisht, kisha kërkuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës që ta ftojë Kryesinë dhe ta propozojë temën për trajtimin e programit qeverisës, sepse ka nevojë që edhe pozita, edhe opozita, edhe qytetarët e vendit, ta dinë se çfarë përmban ky program. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sa për korrektësi, më e fortë se Kryesia është seanca, i vendos të gjitha. Kjo është seancë. Grupi Parlamentar "Nisma", zoti Bilall Sherifi e ka fjalën. Le të bëhet gati Grupi "6+" pastaj.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, deputetë të nderuar, qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Kolegë të opozitës,

Zoti kryetar,

Unë për herë të parë po dal në këtë foltore të kësaj sale të Kuvendit të nderuar të Republikës së Kosovës dhe për dallim nga shumë kolegë, unë po u them kolegëve të opozitës, mos u ndalni së foluri, se vetë fjala parlament vjen prej fjalës parla - për të folur.

Të lisni bash çka ju mendoni, përderisa na jepni edhe neve të njëjtën të drejtë që edhe ne të flasim. Deputetët, nuk po flas për qeverinë, se qeveria duhet të punojë, jo të flasë. Qeveria është për të punuar, ne deputetët jemi këtu për të folur.

Tash po hyj pak në temë. Glauku filloi me përsiatje filozofike, me pikëvështrime, po Glauku s'mund të shohë tash çka sheh ti, se pika jote e vështrimit e sheh Kadri Veselin. Pika ime e vështrimit ju sheh juve këtu.

Tash Glauku përshkrimin se si erdhi te formimi i Qeverisë, sigurisht e ka nisur prej pikës së vet të vështrimit. Natyrisht, pika e tij e vështrimit i sheh ato.

Më lejoni tash mua të tregoj se çka sheh pika ime e vështrimit. Që sovranit prodhoi tri grupe relativisht të barabarta politike, këto s'hyjnë me parti, koalicione, por thjesht tri grupime, të cilat iu afruan sovranit dhe përafërsisht si të barabartë i votoi edhe na solli këtu.

Dhe, Glauku harroi, e ka mbajtur në mend atë teorëshin e Listës serbe, por nuk e përmendi tremujshin e këtyre të dërguarve të sovranit në Kuvend, çka bënë.

Pse, ia humbën vendit tre muaj? Pse nuk arritën që brenda tri orësh, tri ditësh, ta formojnë Qeverinë e Republikës së Kosovës?

Dhe, pikëvështrimi im thotë, fjala magjike, pse nuk ndodhi kjo ishte kryeministri, jo programi. Kush kryeministër? Të jemi korrektë. Kjo e bllokoi Republikën e Kosovës dhe krijimin e institucioneve të Kosovës, jo programi, jo idetë.

Lista serbe po, unë nuk bëj pjesë në kategorinë e njerëzve që janë hipokrit, po e kemi pritur. Unë po them po, e kemi pritur, ama Kosova ju ka pritur juve tre muaj. Besa, e pata dhënë votën publikisht, që nëse i bëni 60 deputetë shqiptarë, siç po kërkonte, do ta keni votën time të 61-të. Nuk keni arritur t'i bëni, jo për tjetër, për faktin se s'keni arritur të merreni vesh kush po bëhet kryeministër?

Ne u treguam qytetarëve të Republikës së Kosovës paraprakisht, e kemi Ramush Haradinajn kandidat për kryeministër. Ju i treguat po, e keni Albin Kurtin kandidat dhe gjithashtu LDK-ja, LAA-ja, përkatësisht doli me ofertën e Avdullah Hotit për kryeministër, shumë mirë.

Kur erdhën këtu u bllokua, këtu mbeti ajo. Prandaj i humbëm ata tre muaj. Nuk do të lëshohem më shumë në argumente, pse u prit tri orë.

Shihe, qeveri Kosova gjithmonë do të ketë, a ju kujtohet. Unë kam qenë një nga ideatorët, jo i vetmi, por një nga ideatorët e 2014-ës, bashkë me Glaukun, Albinin e shumë të tjerë që të mos i lëmë të formojë qeveri fituesi i zgjedhjeve. Na i prishi krejt Enver Hasani, këtë e dimë, e prishi lojën, pse e kishte në dorë.

Mirëpo tash, derisa nuk ndërrohet Kushtetuta, këto janë rregullat e lojës, u desh ta votojmë kryetarin e Kuvendit, Kadri Veselin, që e kishin këta kandidat, që e kishte PAN-i. Tash doni të vazhdoni ta bëni Qeverinë, por jo, prapë doli kryeministri në rrugë, jo programi. Çka duhet të nxirret nga kjo?

Deri tash qeveritë e Kosovës me shumicë të madhe shqiptare ia kanë bërë dëmet më të mëdha vendit. Deri tash qeveritë nuk kanë rënë për shkak se pakicat e kanë kushtëzuar qeverinë? Dhe çka po ju dhimbet, nuk besoj që ju dhimbet Qeveria që e rrëzon Lista serbe, sepse edhe ju po doni ta rrëzoni!

Nëse kjo Qeveri hyn në pazare me Listën serbe në kundërshtim me Kushtetutën, në kundërshtim me interesat e vendit, ju jeni këtu, edhe unë jam këtu dhe ne të gjithë do ta ndalim këtë qeveri, se në fund të fundit, kjo qeveri e ka një mandat: të zbatojë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Çdo marrëveshje që del jashtë kësaj, nuk do të mbështetet nga deputetët e “Nismës për Kosovën”, besoj edhe nga shumë deputetë të tjerë që nuk janë të “Nismës”, se për juve nuk diskutoj, nuk do të duhej të shtrohej si çështje a do të mbështetet apo jo, sepse edhe për nga roli i opozitarizmit ju e keni për detyrë për të mbrojtur vendin nga veprimet arbitrare apo veprimet e dëmshme që nesër mund t’i bëjë Qeveria.

Këto janë ato që pak fjalë që desha t’i them dhe të përfundojmë këtë seancë, natyrisht kjo është dashur të vazhdojë, është dashur të zhvillohet, të kryhet dhe të ecim te seanca të tjera përmbajtjesore.

Shihe, demarkacioni, marrëveshje të fshehtë me Listën serbe nuk ka dhe nuk do të ketë.

Edhe unë ju zotohem këtu në emër të deputetëve të “Nismës” që një marrëveshje, të gjitha ato marrëveshje të cilat i kemi kundërshtuar sa kemi qenë në opozitë, jemi bashkë me të gjithë ata deputetë, qofshin në pozitë, qofshin në opozitë, që do t’i kundërshtojnë këto. Nuk do të ketë zbrapsje as për demarkacion, as për Asociacionin, ashtu siç ka thënë Gjykata Kushtetuese për njërën, përkatësisht në Zhleb edhe në Çakor.

Tjetra, nuk kemi çka të diskutojmë rreth kësaj, por mënyrën, rrugën se si duhet të vijmë, se si duhet së bashku të ecim për t’i realizuar këto, këtu jemi të gatshëm të ulemi e të bisedojmë.

Duke dashur që të ofrohem edhe për bashkëpunim me kolegët, të vetafrohem, të opozitës, pa marrë parasysh në pikat ku mund të pajtohemi dhe në pikat ku nuk do të mund të pajtohemi. Le të ecim së bashku aty ku mund të punojmë së bashku dhe le të kundërshtohemi aty ku mund dhe duhet të kundërshtohemi, por të ruajmë së paku minimumin e korrektesisë në raport me njëri-tjetrin dhe të jeni të sigurt se në interes të vendit këtu do të jem në mes, ulur, por do të vëreni, do të shihni që në vendimet e gabuara do të jem shpeshherë edhe bashkë me ju.

Në përgjithësi, kjo foltore dhe ky Kuvend, këto institucione do të funksionojnë gjithmonë, gjithmonë dikush i bën.

Prandaj, nëse nuk keni arritur të merreni vesh që ju ta bëni, lëreni zotin Ramush Haradinajn së paku 100 ditë, se nja 30 gati shkuan, pa e lënë rahat, le të punojë, pastaj ta vlerësojmë në bazë të punëve, të cilat do t'i bëjë qeveria në krye me zotin Haradinaj.

Unë ju falënderoj shumë dhe ju uroj suksese të gjithëve veç e veç, por edhe si parti në këto zgjedhje lokale tash që janë duke u mbajtur. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Albert Kinolli, nga "6+" e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pa dashur të kthehem aty ku edhe filloi ky debat parlamentar, pa e mohuar të drejtën e askujt për të shprehur mendimin e vet të lirë, mirëpo ne si Grup Parlamentar "6+" dëshirojmë të respektojmë pikën e rendit të ditës, ashtu siç jemi dakorduar në Kryesinë e Kuvendit dhe ashtu siç presin edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar "6+" e ka shqyrtuar me kujdes programin qeverisës e parimet e tij dhe mendojmë se përkundër faktit se shoqëria kosovare ballafaqohet me probleme të shumta në jetën e përditshme, duke filluar nga zhvillimi ekonomik, hapja e vendeve të reja të punës, me qëllim të uljes së papunësisë, problemet në arsimim, shëndetësi, mirëqenie sociale, ku skema për asistencë sociale aktuale është diskriminuese, sidomos kur kemi parasysh gjendjen e rëndë socio-ekonomike të komuniteteve pakicë, si dhe në sfera të tjera të jetës, me theks të veçantë kujdes të posaçëm mendojmë se duhet t'i kushtohet Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ku komunitetet pakicë joserbe pothuajse totalisht janë të përjashtuara si në qasje, si në përfitime në buxhet me projekte të tyre për komunitetet e tyre përkatëse.

Sidoqoftë ne si Grup Parlamentar “6+” mendojmë se ky program qeveritar është në harmoni në përputhje me nevojat dhe kërkesat e të gjithë qytetarëve dhe si të tillë e përkrahim dhe e mbështesim, duke shpresuar në bashkëpunim të ndërsjellë dhe efikas në dobi të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për diskutim janë 18 kolegë nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, asnjë tjetër nuk u lajmërua. Avdullah Hoti, është mirë të m’i sillni me shkrim, e thashë në fillim të seancës, po e shoh, nuk po doni, ose veç të lihet lista e të shkohet me dorë, një nga një. Qysh në bazë të grupeve parlamentare, si të lajmërohen? Kartela nuk kemi, në momentin kur t’i kemi, do ta kemi më lehtë. Unë po mundohem të mbaj një procedim.

Si po doni të shkojmë, me listë janë 18, të tjerët a mund t’i shkruani, t’i sillni, pastaj i kombinoj në bazë të grupeve parlamentare. Po filloj me Avdullah Hotin, si deputet, a dëshiron? Urdhëro! Replikë, pas Albertit. Urdhëro, replikë, veç ka qenë mirë më herët, kur ka folur Bilalli. Replikë.

GLAUK KONJUFCA: Për t’i kontribuar të vërtetës se çka ndodhi në seancën kur u zgjodh qeveria, e porosita të ma shtypin transkriptin, i cili po thotë kështu: “Deputeti Pal Lekaj, në emër të PDK-së, AAK-së, “Nisma”, të PAN-it, pra, propozoi mocion procedural për ta mbyllur debatin”. Ky mocion e ka mbyllur debatin. Mocioni i Pal Lekajt, domethënë, ju e keni mbyllur debatin. Kur ne kërkuam që Qeveria Haradinaj të shkojë në debat, të shkojë në votim, faktikisht, ju dolët dhe thatë: “Jo, nuk bën të ndalet debati”, se debati është më i rëndësishmi në botë. Kur erdhi Lista serbe, në momentin që është shfaqur Lista serbe, ju e keni ndalur debatin. Qysh, debati qenka më i rëndësishmi, e kur erdhi Lista serbe nuk qenka më i rëndësishëm! Plus ju e nxorët në votim mocionin që e propozova unë, mua po më akuzoni? Të njëjtin mocion e nxorët ju për mbylljen e debatit. Kjo hipokrizi po më befason.

Domethënë, e vërteta është kështu. Ne kemi kërkuar të nxirret në votim Haradinaj për t’ju treguar që jeni të varur prej Listës serbe, ju thoshit debat. Kur erdhi Lista serbe, tash nuk është i rëndësishëm debati. Çka është në fund konkludimi: konkludimi është që nuk e keni pasur për debat, por për Listën serbe.

KRYETARI: Bilall, kundër-replikë, pra, një minutë.

BILALL SHERIFI: Jo, se reagoi në replikën time dhe kam të drejtë në kundër-replikë.

Pajtohem Glauk, pajtohem për dallim prej teje, ama ti nuk fole për atë tremuajshin, aty ta përmenda emrin unë, pse u prit? E pritët tre muaj, e bllokuat vendin, i kishit 61 vota. Pse

nuk e krijuat Qeverinë e Republikës së Kosovës kur i kishit votat, po e latë të varet nga Lista serbe? A ndieni përgjegjësi që kjo qeveri varet nga Lista serbe, kur i keni pasur votat shqiptare e s'ë keni bërë Qeverinë.

KRYETARI: Atëherë, Memli Krasniqi, Avdullah Hoti, për çështjen e seancës, jem non stop replikë, kundër-replikë, po dy minuta i keni, jo dhjetë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Populli ynë e ka një fjalë të urtë, mijëra fjalëve të urta të jashtëzakonshme, thotë: “Ruaju, mos ia bëj tjetrit gropën, se bie vetë në të”.

Ju atë ditë keni kërkuar mocion dhe mos e shtrebbëroni të vërtetën, ju lutem! Keni thënë mocion, e keni prezantuar, e propozuat atë mocion e keni thënë ta nxjerrim në votim. Në momentin që ka dalë në votim, seanca ka shkuar në pauzë, po de, ka shkuar seanca në pauzë. Ne kemi dalë, ka shkuar në pauzë. Në momentin që jemi kthyer, është votuar, është votuar mocioni juaj dhe ju, për hipokrizi, jeni kallëzuar hipokritë atë ditë, nëse po përmendni hipokrizi, sepse në momentin kur ju keni dashur ta ndalni debatin dhe në momentin kur erdhi koha të votohet, tash u penduat, sepse e patë që humbni.

Problemi është ky: a po doni ta debatojmë programin, e caktojmë një seancë, flasim për programin, a po doni të bëjmë fushatë zgjedhore, bëjmë fushatë zgjedhore.

KRYETARI: Zoti Hoti, fjala për ju. Pastaj kalojmë te diskutimet, se janë më tepër kryetarët e grupeve parlamentare.

AVDULLAH HOTI: Unë, kryetar i Kuvendit, ju ftoj ta udhëhiqni Kuvendin e Kosovës sipas Rregullores, sepse fakti që po, në rregull Ganimete, dëgjo deri në fund, mandej do ta ndërrosh opinionin, të garantoj.

Fakti që sot, pas tri javësh e mbajmë këtë debat, vazhdohet ky debat, është për faj të kryetarit të Kuvendit.

Ne i kemi mbledhur 53 nënshkrime, kemi kërkuar seancë të jashtëzakonshme, është aprovuar në Kryesinë e Kuvendit, kemi ardhur këtu në sallë, nuk ka ardhur kryeministri. Nuk është ndërprerë seancë për mungesë të kuorumit, sepse opozita asnjëherë nuk e bën kuorumin, po ta bënte kuorumin opozita, do ta kishte Qeverinë, mos e harroni këto, Bilall, se t'i i di këto rregulla elementare të parlamentarizmit, së paku.

Kemi kërkuar ta ndërpremë seancën në mënyrë që qeveria të jetë prezente. Kemi mbledhur 6 nënshkrime sipas rregullores për të ftuar mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit,

për të caktuar kohën për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, kryetari i Kuvendit nuk e ka ftuar për një javë apo 10 ditë Kryesinë e Kuvendit për të vendosur. Kur e ka ftuar Kryesinë e Kuvendit, prapë nuk e ka respektuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për seancë të jashtëzakonshme që ajo të vazhdojë në kohën që ne e kemi kërkuar dhe ka ndodhur për herë të parë në 17 vjet, pra në Kryesinë e Kuvendit nuk është aprovuar kërkesa e parashtruesit për seancë të jashtëzakonshëm. Prandaj, po mbahet ky debat dhe unë kërkoj që të respektojmë në përpikëri Rregulloren e Kuvendit dhe të respektohet opinioni i secilit deputet në paraqitjen e vlerësimeve, për “parimet qeverisëse” të kësaj qeverie. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetar i grupit, u mbyte me këtë rregullore. Ke ardhur herën e parë edhe nuk po e di. Pyete akademikun e nderuar, Sabri Hamiti, ju lus, gazetarëve, pyete dhe tregon si është rregullorja. Nuk po e di. Kemi biseduar një orë në mbledhjen e kaluar. Kam respekt për ty. E ke dëshpërim për shkak të opozitës, po problemi në Rregullore, kjo është, mos më keqkupto, nuk dua as ta ulë intelektin tuaj, të respektoj, po për besë, nuk po e di. Rregullore është kjo. Po unë të lejoj replikë, vetëm për besë, Rregullorja është kjo. Për hir të opinionit, atë ditë, në qoftë se më lejohet, bile, po më vjen keq se po flas nga këtu, vetëm pak.

Atë ditë në seancë, kur kemi qenë te mocioni, ka bërë një gabim opozita e tanishme, po flas si kryetar i Kuvendit, ka bërë një gabim. Unë kam ardhur në seancë, ju e dini, vetë grupi im parlamentar e ka bërë një gabim, për arsye se menjëherë është dashur të shkohet në votim, e nënkryetari ka qenë korrekt, nënkryetari i Kuvendit nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ka qenë korrekt, menjëherë të shkojmë më votim dhe kishte përfunduar kjo historia e mocionit të “Vetëvendosjes”, se e ka iniciuar, thjesht kishte përfunduar atëherë.

Sido që të jetë, tash kjo po bëhet lojë fjalësh, u shkel Rregullorja, nuk u shkel, është mirë të futemi në pjesën e punës së Kuvendit. Ne duhet të dalim nga ky labirint, të cilin, zoti Hoti, po mundohesh ta mbash, po seanca duhet të vazhdojë. Keni mundësi të luftoni kundër programit qeveritar, kundër pozitës, në forma të ndryshme, po dilni prej kësaj situatë, se as juve s’ju ndihmon.

Urdhëro, kundër-replikë. Unë s’kam asgjë. Urdhëro, po në Rregullore thërras publikisht mediat le ta pyesin akademikun e nderuar, ka qenë nënkryetar një kohë të gjatë, le ta bëjë interpretimin.

AVDULLAH HOTI: Si ka punuar akademiku në Kuvend, të gjithë e dimë, kryetar i Kuvendit.

Neni 16, pika 2 e Rregullores së Punës së Kuvendit thotë: “Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen e Kryesisë, nëse kërkohet nga një grup parlamentar ose së paku nga pesë për qind, përkatësisht nga gjashtë deputetë të Kuvendit të Kosovës”. Ju nuk e keni thirrur mbledhjen e Kryesisë për gati 10 ditë.

KRYETARI: Mos lëviz, të lutem, të lutem, zoti Hoti, sqaroja opinionit, shumë mirë e lexove, a ka të përcaktuar aspektin kohor. Shumë mirë e lexove, atë veç interpretoje, Rregulloren lexoje edhe një herë. A ka obligim, në qoftë se do të ishin 40 nënshkrime, e kam thirrur atë mbrëmje. Në mbrëmje menjëherë e kam thirrur më datën 10, me të 9-tin u votua qeveria, me të 10-tin ka qenë seanca e jashtëzakonshme. 6 deputetë kur e thërrasin, nuk e obligojnë Kryesinë, as kryetarin e Kuvendit. Armend, fol ti, atëherë. Fol ti, atëherë, je i grupit parlamentar, interpreto ti edhe Arbenin ku e kam, qe edhe Arbeni. Urdhëro, fol kryetar i grupit.

AVDULLAH HOTI: Prapë, kryetar i Kuvendit,
Po ju lexoj kërkesën për caktimin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, për caktimin e kohës, për vazhdim të seancës së jashtëzakonshme të filluar më datë 10 shtator.

Deputetët nënshkrues kërkojnë që mbledhja e Kryesisë të Kuvendit të mbahet më 11.9.2017, në orën 12:00 dhe të caktohet vazhdimi i seancës më 12 shtator, në orën 10:00. Ju këtë nuk e keni bërë.

KRYETARI: Unë po i vej në pozitë të keqe deputetët. Arben ose Armend, flisni secili prej juve. Faleminderit! Rregulloren do të mundohem në mënyrë perfekte ta respektoj si për grupin parlamentar, ku jam unë kryetar i partisë, njëjtë për opozitën, bile do të jem i pakompromis në këtë aspekt.

Kolegë deputetë, e fillojmë, prapë Lëvizja “Vetëvendosja”, nuk ka sjellë asnjë emër. Lidhja Demokratike e Kosovës, Driton Selmanaj e ka fjalën. Shkojmë pastaj nga Partia Demokratike e Kosovës, nuk ka sjellë asnjë emër. Shkruani emrat, ju lutem, në listë.

DRITON SELMANAJ: Përshëndetje për të gjithë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar përfaqësues të mediave,
Njerëz të mirë të Kosovës,
Në fakt, edhe në legjislaturën e kaluar ka pasur një tendencë që Kuvendi të shndërrohet në një treg plaçkash, ku kryetari i Kuvendit provonte të shitej si shumë demokrat dhe dilte, ama çdo ditë, përtej Rregullores dhe tash përsëri po provon që të njëjtën gjë ta bëjë. Të lutem, kryetar, nëse nuk e ke mësuar akoma Rregulloren, merr këshilltarë, përkundër që ke paguar mjaft shtrenjtë, ke sjellë diku 7-8 këshilltarë, 10 këshilltarë dhe përsëri çdo

seancë, po të them me përkushtimin dhe me sigurinë më të madhe, sepse kam qenë atje lart, gjithmonë të kam përcjellë, që keni bërë shkelje të vazhdueshme.

Kemi vendosur në vitin 2013 një precedent interesant për parlamentarizmin në Kosovë: ikte shumica prej Kuvendit. PDK-ja ikte prej Kuvendit. Sa herë vinin ndonjë tematikë e rëndësishme, PDK-ja ikte. Tash po ndodh edhe një precedent tjetër: Qeveria po ik. A keni pa ndokund në demokracitë perëndimore parlamentare ku Qeveria dhe shumica e Kuvendit? E keni çoroditur parlamentarizmin, e keni çoroditur jetën parlamentare në Kosovë. Mosni, ju lutem, të provojmë ta shpëtojmë atë çka na ka mbetur për t'u shpëtuar, sepse vërtet unë s'po mund t'u kuptoj, nuk po di. Në fakt, PDK-në nganjëherë e krijoja përshtypjen që mund ta kuptoja, se ikjen, hipokrizinë, në tradhtinë e pati instaluar si kulturë, si standard edhe në Parlament. Ama Ramushit pak i besoja. Për Ramushin kam pasur besim që ky është njeri i fjalës, është njeri i besës, nuk ik. Besoni të gjithë, unë sot po e shoh: është njësoj, njësoj sikur këta.

Kemi bërë një qeveri, të cilën disa po e quajnë një lloj kompotqeverie, me katër kryeministra. Unë po e shoh kryeministrin e vendit tim si kryeministër i dorës së dytë.

Për deputetët e PDK-së po e shoh që kryeministër është Kadri Veseli, për deputetët e AKR-së po e shoh që kryeministër është Behgjet Pacolli, po i shoh edhe për Listën serbe kryeministër është dikush tjetër.

Dhe, tash çka, kur ne si parti politike, ku ju si partnerë, në fakt, të koalicionit, e shihni zotin Haradinaj si kryeministër të dorës së dytë, po ne, po njerëzit jashtë, të dorës së tretë, katër apo të pestë. Me keqardhje, po ky është realiteti.

Tash po shoh disa nga ju, po thirreni në vlera të LDK-së, faleminderit, faleminderit shumë që po keni konsideratë. Po i kujtoni kësaj shoqërie që LDK-ja është parti institucionaliste, është vërtet e tillë. Jo, ju vetë e thatë, ju vetë, dhe faleminderit shumë. Po mos harroni, tash po e kërkoni edhe IPA-n, sepse ju po kërkoni që ne të tregohemi institucionalistë.

Të njëjtën gjë do ta thoni edhe për demarkacionin, do ta sillni të njëjtën dhe do të thoni kështu: LDK-ja duhet ta votojë. Besomëni, me hipokritë kemi vendosur të mos sillmi më njëjtë, sepse e instaluar këtë kulturë, nuk dini t'i respektoni ju ata të cilët janë institucionalistë në këtë vend, nuk dini t'i respektoni ata të cilët mendojnë për të mirën e këtij vendi, do ta shohim edhe për demarkacionin kur të vijë çfarë do të jetë sjellja juaj dhe do ta shihni secilin vendim që e sillni këtu në Kuvend, cila do të jetë qasja jonë.

Tash, në fakt, kur po flasim për dyshimet tona për marrëveshjen eventuale me Listën serbe, pse ne kemi dyshime? Unë personalisht kam dyshime. A nuk ishte po kjo Serbi dhe po presidenti Vuçiq, Daçiq e Gjuriq që për pesë muaj e torturuan kryeministrin tonë në Kolmar të Francës? Pse u bë kaq lehtë i pranueshëm ky person për ta? Pa të drejtë, absolutisht pa të drejtë, e quanin “kriminel”, e torturuan, e brenda natës thonë: “Jo, ky është i pranueshëm”, përkundër që kjo qeveri në krye të saj ka njerëz komandantë të UÇK-së. Qysh të besoj unë që, në fakt, nuk ka diçka përtej asaj çfarë flitet këtu? Dhe, kjo besomëni, po më nxit të mendoj seriozisht të them, mos jeni duke e dëmtuar seriozisht shtetin e Kosovës? Ruani qetësinë, sepse do të kemi kohë për të gjithë.

Dhe, pse po ndodh kjo, pse po ndodh krejt kjo situatë? Unë mendoj për dy arsye: e para, ka të bëjë me verbërinë për pushtet, për ambicie krejtësisht personale të dikujt. E dyta, ka të bëjë me frikën nga çpushtetizimi, sidomos të PDK-së. Këta frikësohen për të zezat që ia kanë bërë Kosovës prej vitit '99 e tutje, këta frikësohen se abuzimet e parasë publike do t'u dalin në shesh, këta frikësohen që shkatërrimi i pasurisë të Kosovës nëpërmjet procesit të privatizimit do t'i dërgojë prapa grilave shumë nga ta, këta frikësohen se aura e pushtetit po perëndon dhe me këtë, perandoria e krimit do të rrëzohet si piramidë prej letre.

Në fakt, unë ndihem mirë, pse subjekti, të cilit kam vendosur t'i takoj, e ka sjellë PDK-në në këtë gjendje. Pse po e them në këtë gjendje? Keni mbetur që vetëm ¼ ose 1/5 e pushtetit ta keni ju. Në vitin 2015, po kjo LDK e detyroi Hashim Thaçin të bëhej zëvendës i Isa Mustafës, nëse e mbani mend, u pati bërë zëvendëskryeministër. Më 2017, po kjo LDK përbën një koalicion me AKR-në, e detyroi Kadri Veselin natën të bëjë një koalicion dhe të heqë dorë prej pozitës prej për të cilën e kishte ëndërr të madhe, të bëhej kryeministër.

Dhe, të nderuar deputetë, tash po ndihem mirë normalisht që po kjo LDK to t'ju detyroj shumë shpejt të bini prej pushteti. Në aspektin e përbërjes nuk po flas hiq, domethënë e kemi vendosur mjekun të merret me rrugët, kemi vendosur mjeken të merret me planifikim hapësinor, nuk e di, do të bëhemi rast studimi për shumë studiuës. Unë, në fakt, këtu nuk po e shoh qeverinë, po e shoh më tepër si një klub heterogjen të njerëzve, me qëllime dhe objektiva krejtësisht të ndryshme, si një klub që nuk garanton as zhvillim, as prosperitet, as përmirësim, as integritet, dhe asgjë tjetër. Nëse qeveria e kaluar, të nderuar deputetë, është rrëzuar kinse për mungesë vendimmarrje për tematikat e mëdha, po ju jap fjalën sot, kjo qeveri do të rrëzohet për mungesë të vendimeve më të vogla, se s'do të vijnë punët, as s'do të kenë mundësinë të merren me tema të mëdha.

E vetmja shpresë për këtë vend është roli i fuqishëm i LDK-së në opozitë, përfshirë edhe partnerët e tjerë dhe sa më shpejt të shkohet në zgjedhje të parakohshme, ndoshta në pranverë, pse jo. Faleminderit!

KRYETARI: Do ta marr unë fjalën, nëse ka mundësi.
Faleminderit!

Ju përsëndes, e mora fjalën, siç e patë, isha duke dalë për një pauzë, por më nxiti kolegu që na ka ardhur tash deputet dhe kam një histori, të cilën dua ta theksoj dhe e cila është e mirë për publikun, në rend të parë.

Kur kam ardhur si kryetar i Kuvendit, mandatin e kaluar, një nga hapat e parë, të cilët i kam bërë ka qenë që t'i jap mundësi çdokujt, ama çdokujt, qoftë medias, shoqërisë civile, të ketë mundësi, qasje në çdo dokument. Çdo para, shpenzim publik, nuk ka institucion që e bën transparencën si Kuvendi i Republikës së Kosovës që nga ardhja ime si kryetar. Për çdo informacion, ja ku i keni mediat, kanë mundësi të marrin informacione. Në të njëjtën kohë, edhe një partneritet me shoqërinë civile, them të drejtën kam qenë jashtëzakonisht i nderuar, kemi marrë shumë edhe partnerë donatorësh. Na kanë ndihmuar shumë, njëri nga ata më i fuqishmi, i cili e ndihmon çdoherë rritjen e transparencës, punën profesionale në Kuvend është USAID-i.

USAID-i, i cili ndihmonte edhe një nga organizatat më kredibile, me të cilën kemi ende partnerit, është KDI-ja, një organizatë joqeveritare e jashtëzakonshme. Por, realisht unë mundohesha me atë timen të jem sa më transparent, kur kthehesha në njëfarë forme, nuk kisha shumë kohë, por në lajme, në këto televizione shihja njërin nga personat e KDI-së, ama çdoherë, s'ndalej hiq, ama e linte krejt këtë pjesën çka kemi folur, çka kemi bërë këtej dhe veç shaj, fyej, shaj, fyej! Për besë, më vinte turp. Ne në politikë është rrezik të flasim, është rrezik për arsye se çkado të flasim, mund të keqkuptohet. Është momenti i parë që kam mundësi, kam mundësi tash si në pjesën, në taborin tonë, në klub me ne është tash, ky është politikan, e kam fjalën për Driton Selmanajn. Ama nuk e keni idenë. Rrinte te ne, vinte në mbledhjen e Kuvendit, e shihte krejt atë mundësinë, e cila ka qenë krejt publike, unë edhe mediat i lejoja brenda, ky veç dezinformonte.

Ama fyerje, bile-bile thosha, çka ka, se s'ka njeri pa pasur probleme diçka? Për besë, brenda shpirtit kishte urrejtje patologjike, gjëra të tilla nuk i thotë. Njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm, vendi ynë është shtet i pavarur, sovran, ku ka institucione, problemet i dërgon atje. Ama fyerjet individuale janë të rënda. Qe edhe këtu filloi të flasë, do të kthehem te ajo pjesë. Dikur, kohë pas kohe u detyrova, fola me partnerin, fola seriozisht, tash nuk e kam problemin e kësaj, unë jam jashtëzakonisht i kënaqur me partneritetin, por problemi është se nuk jemi një pasqyrë korrekte dhe të tregoj drejt, këtu ka ardhur ky në politikë, që ta dini, e kanë larguar prej atij projekti.

S'e kam larguar unë, si manipulues është larguar, si keqpërdorues i shoqërisë civile. Asgjë nuk ka më keq, se shoqëria civile ka rolin e tyre të pavarur, veç nuk është mirë të luhet roli gjoja i pavarur dhe, në njëjtën kohë, çdo ditë të hysh me ne në politikë, rri, ja në politikë. Shumë mirë që ke ardhur tash në klub, fol çka ke. Ky shtet është sovran, ka institucione, fol çka ke, orientoi qoftë politikisht çka ke këtu, por në të njëjtën kohë, mos mendo se e ke dorën aty me e "rreh", a e kupton, në kuptimin sikurse paraardhësit tuaj familjar. Stupci, ka kaluar 81-82-a, ka kaluar, veç dijani, ka kaluar dhe respektoji njerëzit. Ky është Kuvend, duhet t'i respektoni njerëzit, çka do që ke, fole, e ke keqpërdorur, e ke tradhtuar shoqërinë civile, je turpi i shoqërisë civile, po më vjen keq që po ta them.

Shoqëria civile e meriton çdo respekt, por ti je turpi, sjellja jote s'është e mirë. Jo, po e personalizoj, për arsye se gjatë shoqërisë civile nuk ka fyerje, e cila nuk është bërë për Kuvendin pikërisht nga ky person, e tani më vonë na doli nga ekspert në politikan, paska qenë me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Krejt çka ka, megjithëse ky mandat do të jetë edhe shumë i mirë, do të orientohen edhe në disa çështje, për të cilat që 17 vjet flitet, këtu do të adresohen saktë, nuk do t'i ikim më asnjë centimetër, çdo gjë, shteti juridik, transparenca, përgjegjësia para qytetarëve për çdo gjë, prej ditës së parë, 12 qershorit, për çdo gjë duhet të jepet përgjegjësi. Unë jam munduar shpesh të them: ndalini fjalët se, thjesht, veç jeni duke folur, duke lënduar njerëz. A e dini, që kanë familje? Janë qenie njerëzore, pastaj cili Zot, more, cili prind ju ka bërë më shumë se sa neve. T'ju dëgjoj çdokush çka flisni, s'keni guxim pastaj asnjë hap ta ndërmerrni, i cili është institucional, i cili e çon andej kah duhet të shkojë shteti. Kuvendi debaton politikisht dhe sjell vendim politik, mund të shkojë nëpërmjet rezolutës çdo vendim që merret, çka është shqetësim. Gjërat juridike shkojnë në pjesën e Prokurorisë, gjyqësisë, te gjyqtarët, edhe ato, por edhe politikisht mund të krijohen.

Ky Kuvend ka mundur të krijojë distancë nga kriminalitetet, të cilët ndoshta kanë penetruar edhe në këtë Kuvend, të krijohet një distancë, ka mundur Kuvendi ta bëjë, asnjëherë s'e ka bërë, që 17 vjet që ekziston. Le ta bëjë sot, le ta bëjë nesër, në të njëjtën kohë ato çka janë, le të jenë të përgjegjshme kur flitet, e jo pastaj të iket: jo veç e fola unë, nuk e di unë, mendimi im personal, unë jam i mbrojtur prej Kushtetutës, unë mund të flas çka të dua në Kuvend. Kur flet ti, flas edhe unë, përgjegjësinë e kemi të njëjtë, të barabartë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Selmanaj!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Vërtet po ndihem keq, media, njerëz të mirë të këtij vendi që po detyrohem të merrem me këtë nivel të njerëzve. Pse po e them këtë? Unë, dëgjomëni vetëm pak, ruajeni qetësinë, unë jam detyruar të marr vendim ta lëshoj KDI-në nga ky. Kam themeluar organizatë të re “Demokraci +” që financues i parë i projekteve të mia ka qenë pikërisht USAID-i. USAID-i me atë mesazh ka dashur të më thotë mua, s’e kemi pasur personale me juve, por kanë qenë projektet për të cilat kryetari i Kuvendit s’po mund të të durojë ty në Kuvend.

Deklarimet e mia publike në “Klik”, që kurrë s’kanë qenë fyerje personale, por dikush e ka mizën nën kapuç dhe ndihet i tillë. Unë nuk merrem me ta, por unë kam provuar gjithmonë të jem racional në gjykimin tim individual dhe u kam thënë shumë njerëzve, a ky është investimi i organizatave ndërkombëtare në demokracinë në Kosovë, kur dikujt i thua dikur të mos flasë keq për dikë. Jo, jo, unë kam për ta shprehur mendimin tim sa herë dhe kurdo që mendoj ndaj kujtdo. Bile më kanë thënë mos dil nga KDI-ja, jemi në gjendje të negociojmë edhe pagën, përkundër që kisha një pagë të madhe, kam thënë: “Jo, faleminderit”, veç nëse është kontestuar angazhimi im për këtë formë, unë jap dorëheqje.

Pastërtia ime personale, po e flas, është sikur loti, jam në gjendje që të përgjigjem kujtdo, kurdo, ku të doni, ama dikush nëse historia e tij është e njollosur deri në fund, mos u merrni me timen. Mund ta them kështu, unë po ndihem mirë për një arsye, qytetarë të Kosovës, ndihuni mirë veç për një arsye: SHIK-u është dobësuar në Kosovë, pse po e them? A di çfarë të dhëna po jep për familjen time? Axha im, të nderuar, ka qenë në burg me Azem Sylën në vitin ’81, është i burgosur politik 3 vjet, Agim Selmanaj është axha im, i burgosur politik. Në një dhomë ka qëndruar me Azem Sylën në Prizren, çfarë flisni more ju?! A po e shihni deri ku keni shkuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veseli, kundër-replikë.

KRYETARI KADRI VESELI: Vetëm pak, a ka mundësi të ndalet minutazhi, se e kam veç një minutë, pavarësisht se jam kryetar i Kuvendit, ka mundësi të filloj prej momentit, do të jem shumë specifik. Dëgjo, e keni marrë zangat SHIK-u, SHIK-u, ‘do të ngiheni’ SHIK në këtë mandat, do të shkojmë deri në fund, edhe Komisionin Hetues dhe të gjitha. Veç atëherë, edhe me media, në mënyrë transparente, dëgjo veç atëherë mos bëj ciu-ciu e të tërhiqesh, mos bëj, qëndro deri në fund!

Dëgjo, mos manipulo me plagët e njerëzve, edhe me hajnitë, se njëri nga ata je ti, shko padit ku të duash, se je shpifës dhe je i pasjellshëm, je pa dinjitet, kjo është. Edhe dëgjo, ky Kuvend do të shkojë deri në fund në çdo temë, i thërras të gjithë qytetarët e këtij

vendi, jo s'e kam lëshuar, lirinë e gjeta në mesin tuaj, qysh ka thënë Skënderbeu, edhe unë e kam gjetur në mesin tuaj... Po, dëgjo çdo gjë çka ka të bëjë prej 12 qershorit në këtë vend, vetëm të ulemi, do të shkojmë deri në fund, është e vërtetë, por shpifës e manipulues je ai që thashë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

Jo s'ka më vonë, me radhë, qysh jeni të regjistruar. E humbe të drejtën, e ke radhën, urdhëro, dil, nëse do, nëse jo, unë të fshij prej listës. Qysh e keni dhënë listën, ashtu, kënd do ta zëvendësojë të grupit parlamentar, dikush tjetër, s'doni. S'ka replikë, s'ta ka përmendur emrin kurrkush.

Zoti Sejdiu e ka fjalën, s'ke replikë, s'ta ka përmendur emrin. Ty ta përmendi emrin a, jo, jo, zoti Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuar qytetarë të Republikës,

I nderuar nënkryetar,

Në fakt, kanë kaluar afër katër muaj prej ditës kur qytetarët e Republikës së Kosovës kanë votuar në zgjedhjet nacionale për këtë Kuvend. Prej asaj dite e deri më sot, pra fiks katër muaj dhe është hera e parë që mund të flasim qoftë për fjalimin e kryeministrit, qoftë për parimet programore, apo edhe për atë dokumentin 120 faqesh që e ka dorëzuar ditën kur u mandatua nga Vuçiqi.

Atë ditë u paraqit një dokument që i thamë "Parime programore", një javë apo dy më vonë na dërguan një dokument, i cili ishte program qeveritar, por në fakt është nisje që nuk do t'ia dëshiroja askujt. Nisje e një qeverie, e cila bëhet me aminin e një shtetit që na lufton në çdo cep, në çdo kohë, në çdo mënyrë dhe pa debat. Pra, republikë parlamentare saktë sipas preferencave të atyre që nuk e duan këtë republikë. Republikë parlamentare saktë sipas preferencave të atyre që e luftojnë këtë republikë. Republikë parlamentare saktë sipas atyre që mendojnë se mund të ecin pa Parlament, sikurse që sot po e bën kryeministri i kësaj republike, është hera e dytë që e sheh Parlamentin vetëm si një vend për votë, asgjë më shumë, e në fakt, është Parlamenti ai të cili i përgjigjet ky kryeministër, pra, republikë parlamentare, jo ndryshe.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Kanë kaluar katër muaj prej se Koalicioni PAN qëndron së bashku ditë e natë, katër muaj fiks dhe për katër muaj, po i abstraktoj ditët e fushatës, po i abstraktoj, po ju mirëkuptoj, ka qenë fushatë, s'keni mundur të flisni me njëri-tjetrin, por kanë kaluar katër muaj prej ditës kur kanë dalë rezultatet zgjedhore dhe çdo ditë prej asaj dite keni thënë që 'jeni

gati', jeni gati për të punuar, siç po thotë kryeministri, jeni gati që të qeverisni. Por, në fakt, për këta katër muaj keni sjellë një dokument që në fillim i thatë "Parime programore", më vonë i thatë "Program i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021", një dokument i cili është asgjë më shumë se përmbledhje dëshirash e 15 subjekteve që e formojnë këtë koalicion.

Pra, me plot kontradikta në mes vete, secila faqe në kontradiktë me faqen tjetër, asgjë veçse vazhdim i mendësisë së 17 vjetëve të fundit sa i përket qeverisjes në këtë vend. Pra, qeveri ekstremisht e madhe për nga numri i ministrave, zëvendësministrave, 21 ministra në një vend me 1.8 milionë banorë. Republika popullore e Kinës me 1.5 miliardë banorë i ka 22 ministra, sa për informacion. Por, fatkeqësisht qeveri ekstremisht e vogël për nga mendimi mbi politikat zhvillimore, qeveri që do të peshojë tepër rëndë për nga shpenzimet për vete, normalisht me 21 ministra e numrin e zëvendësministrave, krejt çka mund të shohim do të jetë hollimi i xhepit të qytetarëve dhe jo rritja e buxhetit e vendet e punës.

Kryefjala në këtë program sa i përket temave zhvillimore është profiti, është kryefjala "profiti". Mendimi ekonomik reduktohet në profit dhe gjithkush që di pak për ekonominë, pak për zhvillimin, e kupton që profiti është pasojë dhe jo synim, pra është pasojë e një rritjeje ekonomike, e një mirëmenaxhimi, i një punësimi, e një paraje që qarkullon në këtë ekonomi, e tek atëherë mund të flitet për profit. Këta kryefjalë të politikave zhvillimore e kanë profitin, por nuk duket as për së largu qoftë edhe një shenjë e politikave zhvillimore që do të shpinte drejt prodhimit, e rrjedhimisht drejt punësimit. Rrjedhimisht, drejt një mirëqenie për qytetarët, e jo për ata 21 ministra.

Pra, përsëri qeveri e fjalëve të mëdha, e avazeve të njëjta. Nëse lexohen dy dokumentet që i keni dorëzuar, e nuk janë problematike të lexohen, sepse janë edhe të thjeshta, edhe kontradiktore, e pra nuk ka përmbajtje në to. Pjesa që pretendon të mbulojë ekonominë, bujqësinë, energjinë dhe politikat fiskale shihet qartazi që është vazhdim i avazit të vjetër. Qartazi politika neoliberales, politika të cilat shohin edhe pak hapësirë për privatizim, duke i mbyllur me njëfarë ideje të agjencisë së participimit, duke i kamufluar me një agjenci të participimit, e duke përfunduar në profit përsëri, por jo për punësim, industri, zëvendësim të importeve, promovim të eksportit, zvogëlim të disbalancit tregtar, po thjesht, agjenci e participimeve, e cila siç po thuhet aty në dokument, synim kryesor e ka profitin, ashtu thuhet "synimi kryesor është profiti", thuajse është kjo biznes.

Por, e mirëkuptoj, sepse saktë një biznesmen do të mendonte kështu. Profitin, si mënyrë e vetme për të argumentuar qenien dhe ekzistencën e biznesit, por kjo nuk është biznes, kjo është ekonomi. 1.8 milionë njerëz me 30% papunësi që presin prodhim, industri, presin mirëqenie, e ecje përpara. Sot, në vend se të kemi një Ministri për Zhvillim, një Ministri

të Financave dhe një Ministri të Bujqësisë, sot ne i kemi 8 ministri, të cilat merren me zhvillim, e ato janë, është e rëndësishme, pra në vend se të kemi 3 ministri dhe mbi to të ekzistojë një agjenci nacionale zhvillimore, ne e kemi bërë saktë të kundërtën. Ne e kemi shpërqendruar komplet mendimin ekonomik, e kemi fragmentuar komplet koordinimin e politikave ekonomike, i kemi bërë 8 ministri dhe secila prej tyre e ka kryeministrin e vet, sepse këto nuk janë të koordinuara më dhe, për hir të qytetarëve të kësaj republike, është e rëndësishme që t'i lexojmë secilën ministri se cilat janë, është Ministria e Inovacionit, e cila mendohet në një ekonomi, e cila s'ka prodhim. Interesante kjo, përndryshe ministrinë e Inovacionit i shihni në vendet e zhvilluara qoftë nën ministri, të cilat merren me zhvillim ekonomik, qoftë nën Ministrinë e Arsimit.

Më pastaj, vazhdojmë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Ky është ai personi për të cilën foli edhe Glauku dhe Ministrinë e Infrastrukturës. Dhe, asnjëra prej këtyre nuk e ka një agjendë të qartë, kontradikta të thella në program, kontradikta të thella. Keni agjenci të participimeve, asnjëherë nuk flisni për industri, besoj që është e tepërt të flitet tash me tetë ministri dhe për numrin e zëvendësministrave, këshilltarëve, stafit tjetër përcjellës, mbase edhe kështu e keni menduar zvogëlimin e papunësisë, ndoshta, nuk e di.

Kjo është qasja në të cilën fatkeqësisht kjo qeveri e ka reduktuar mendimin për zvogëlimin e papunësisë. Në këtë frymë është edhe dokumenti që ju po e quani Program qeverisës. Asgjë më shumë, një dokument 120 faqesh me kontradikta të thella në të. Çdo njeri, i cili ka dy ditë lexim ekonomik, e sheh këtë. Në fakt, Republikës së Kosovës sot i duhet një rimëkëmbje ekonomike, e kjo rimëkëmbje nuk ndodh me këtë mendësi, ndodh vetëm me ndryshimin e modelit ekonomik, ndodh vetëm me lëvizjen nga oferta në kërkesë, ndodh vetëm në ndërtimin e industrisë, ndodh vetëm me ndërtimin e zëvendësimit të importeve, kapaciteteve që zëvendësojnë importe dhe kështu stimulojnë eksporte. Por, në fakt, këto 1 minutë e gjysmë, nënkryetar, do t'i përdor për të shpjeguar një element, i cili mendoj që është jashtëzakonisht problematik.

Njërin prej dikastereve kryesore ekonomike kjo qeveri e ka nënkontraktuar, ia ka deleguar dikujt tjetër. E këtë nënkontraktim ia kemi dhënë Republikës së Serbisë, përkatësisht ministrit të Bujqësisë, i cili duket se do të qeveriset nga Beogradi. 1/3 e pjesës së programit që trajton parimet programore dhe ekonominë merret me bujqësi. Një pjesë e këtij dokumenti flet për strategji të munguar, një pjesë tjetër e këtij dokumenti flet për ngritjen e fondeve për bujqësi, a po kuptoni çka po themi? Po themi Serbisë ia kemi nënkontraktuar bujqësinë, ai do ta bëjë strategjinë, ne do ta financojmë me logjikën që ky ministri Rikallo do t'i lërë bujqit në Serbi pa punë, do t'i mbyllë fabrikat në Serbi për të

punësuar bujqit e Kosovës, e për të ndërtuar kapacitete përpunuese në Republikën e Kosovës.

E, pra, le që s'mund ta bëjë atë, por s'mund as ekonominë e këtij vendi ta zhvillojë me këta njerëz, sepse mbi 1/3 e importeve të ushqimit në këtë vend vijnë nga Serbia, e ju ua keni deleguar e nënkontraktuar bujqësinë e përpunimit të ushqimit atyre. Përveçse kjo është absurditet, është edhe recetë ideale për shkatërrimin e radhës të potencialit për krijimin e industrisë së përpunimit të ushqimit, që do të lidhte bujkun me prodhim, punëtorin me fabrika, buxhetin me tatim, e shtetin me zhvillim. Pra, bujqësinë në duar të Serbisë, privatizimi në duar të Agjencisë së Partecipimit, ekonominë e vendit përsëri në tetë ministra, pa koordinim, e program pa mendim. Kjo është Qeveria të cilën po e shohim këto ditë, ky është programi të cilin na e keni dhënë për ta lexuar, e kjo është mendësia me të cilën po vazhdojmë 17 vjetët e fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Të nderuar kolegë,

I nderuar kryesues,

Ftesës suaj për seancë të jashtëzakonshme i jam përgjigjur jashtëzakonisht shpejt dhe me një kureshtje të jashtëzakonshme, por edhe jashtëzakonisht shpejt e kam kuptuar se asgjë të jashtëzakonshme nuk ka për këtë seancë. Bile, kjo seancë e thirrur në këtë mënyrë është edhe e pakuptimtë.

Pra, nën a: nuk ka asgjë të ngutshme, nën b: çështja është krejtësisht e parëndësishme dhe nën c: është krejtësisht e pakuptimtë.

Të nderuar kolegë,

Sa për t'ua rikujtuar sidomos atyre që e kanë nënshkruar kërkesën dhe e kanë ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme, në krye me zotin Hoti, si i pari i nënshkruar, seanca e 9 shtatorit ka qenë për ta zgjedhur Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe i mandatuari ka qenë zoti Ramush Haradinaj. Pra, në atë kohë e ka pasur statusin e kandidatit për kryeministër, ose statusin e mandatarit për kryeministër.

Dhe ai, pra mandatar, jo kryeministri, si mandatar ka prezantuar para jush, duke u bazuar në nenin 65 dhe nenin 84 të Kushtetutës, si dhe nenin 29 të Rregullores së Kuvendit. Pra, kandidati për kryeministër, zoti Ramush Haradinaj, ia ka paraqitur Kuvendit përbërjen e Qeverisë dhe programin për miratim. Në të njëjtën seancë të Kuvendit, ju, të nderuar kolegë, ju nënshkruesit e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, keni kërkuar për të mos pasur debat. Pra, në seancën e 9 shtatorit, ju që keni nënshkruar dhe e keni thirrur

këtë seancë keni kërkuar vetë të mos ketë debat. Dhe, sipas nenit 50 të Rregullores së Kuvendit për mocionet procedurale është votuar për të mos pasur debat.

Po ashtu, më pastaj është votuar për Qeverinë dhe mandatarin, ose kandidati pas votimit më nuk është kandidat për kryeministër, por është kryeministër. Kemi ndërrim të statusit, nga kandidati për kryeministër, tani e kemi një gjendje të re, kemi kryeministër.

Mbledhja e 9 shtatorit për të gjithë ata që kanë nënshkruar - duhet pasur kujdes, se është thirrur me vonesë dhe është e pakuptimtë. Edhe në atë seancë, pra zoti kryetar i Kuvendit e të nderuar kolegë, kryesues, e sidomos i drejtohem kryetarit të Kuvendit, edhe pse nuk është këtu, ky debat, kjo seancë që është thirrur sot është e pakuptimtë dhe nuk ka pasur asnjë nevojë emergjente, nuk ka qenë e ngutshme dhe aspak e rëndësishme.

Duke u bazuar në këto tri elemente, unë i ftoj ata që kanë nënshkruar, që e kanë thirrur këtë seancë, ta tërheqin thirrjen e tyre, sepse nuk ka kuptim. Pra, seanca që është thirrur për sot është e pakuptimtë, nuk ka qenë e ngutshme, nuk i ka plotësuar nevojat dhe elementet kryesore të Rregullores së Kuvendit. Nuk është e ngutshme dhe nuk është e rëndësishë së veçantë. Pra, ju ftoj juve që e keni nënshkruar ta tërhiqni dhe t'i tërhiqni nënshkrimet dhe të ndërpritet debati, e të mos vazhdojë më tutje. Kjo i bie, sikur të thirret zoti Hashim Thaçi sot në interpelancë, ose zoti Isa Mustafa, pasi kanë ndryshuar status, që nuk është më kryeministër, e sot të thirret në interpelancë. Edhe zoti Haradinaj, ditën e 9 shtatorit e ka pasur statusin e kandidatit për kryeministër dhe është vepruar konform Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

Kjo seancë është e pakuptimtë dhe kërkojmë nga ju që t'i tërhiqni nënshkrimet dhe seanca të ndërpritet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Dëshiroj të them se në këtë seancë, në të cilën ne jemi thirrur, vetëm tema për të cilën jemi thirrur nuk është kah debatohet. Po silllet shumë debati rreth Listës serbe. Lista serbe për tre muaj rresht nuk ka qenë fajtores që ne i kemi lënë qytetarët e Kosovës pa Qeveri dhe pa institucione.

Hera e parë në jetën time që dëgjoj që ministri i Bujqësisë, domethënë një ministër paska mundësi të punësojë edhe bujq. Këtë kurrë nuk e kam ditur. Nuk e kam ditur se një ministër punëson bujq, një ministër menaxhon financat... Unë me atë shkollën time të vockël politike që e kam bërë, e di se ministrat krijojnë politika, vizione, por ministrat, ja

ku e kam atje ministrin, e di që ai nuk ka menaxhuar me para. Me para menaxhojnë institucionet tjera të ministrive. Kjo e para.

E dyta, dëshiroj të them se ne si “Nismë” dhe unë si deputet në momentin që do të shoh se Liste serbe e shantazhon Qeverinë e Kosovës, e shantazhon programin e Qeverisë së Kosovës, zhvillimin e Kosovës, unë së bashku me subjektin tim politik, të cilit i takoj, do të dalim kundër kësaj Qeverie.

Në qoftë se subjekti im politik do të ketë qëndrim tjetër, atëherë unë do të kem qëndrim individual, sepse partia së cilës unë i takoj nuk zgjohemi të gjithë në orar të caktuar, nuk flemë të gjithë në orar të caktuar dhe nuk mendojmë të gjithë sikur “makushët” njësoj në orar të caktuar. Ne kemi mendime dhe qëndrime tonat individuale.

Më vjen shumë keq, tepër keq, që qytetarët e Kosovës po e shohin që ka këtu parti politike në këtë Kuvend që e kanë program, synim, zhvillim, shkatërrimin e atyre pak institucioneve të cilat janë ndërtuar. Qytetarët e Kosovës do ta shohin se kush ka ardhur këtu me program për të bërë edhe luftë qytetare, kush e di forcën dhe dhunën në vend të fjalës, të logjikës, të kundërshtimit. Të gjitha këto avash-avash do të shpalohe në këtë Parlament dhe do ta shohin qytetarët e Kosovës se kush çka është. Do të flasim edhe me fakte, do të flasim edhe me dokumente, do të flasim edhe me dosje, por jo me akuza paushalle.

I kemi dokumentet, bash për ty i kemi, edhe për bosët tu që janë takuar më 2004, më 19 shtator, me bosët e vet të Shërbimit Sekret Serb në Beograd. I kemi raportet e Policisë dhe të gjitha do t’jua përplasim një nga një. Unë nuk jam Kadri Veseli, që ju ka krijuar për t’i shkatërruar këta kënde, e tash i keni dalë tepërcë teknologjike edhe le të ju durojë në shpinë. Unë s’kam për të ju duruar, të jeni të bindur. Mua nuk mund të më ndalë askush, as me dhunë. Unë nuk frikohem. Unë mund tash të vij e t’i bie shuplakë Albin Kurtit, por unë nuk jam rrugaç, dhe Albin Kurti i ndërsen zagarët e vet të na mëshojnë neve.

Dhe, le ta ketë turp Rexhep Selimi. Rexhep Selimi le ta ketë turp. Kur unë ia kam mbrojtur familjen dhe ky një zë nuk e ka bërë, por ka marrë qëndrim për aktin e poshtër që ka bërë deputeti juaj, ka marrë qëndrim ta mbrojë... Po, kjo... po e lëmë, tjera herë do të flasim për tema të tilla.

KRYESUESI: Problemet e TV-Klanit mos na i sillni këtu!

MILAIM ZEKA: Po kthehem në temë.

Dëshiroj të them diçka: Unë pres nga të gjithë deputetët e Kosovës në Parlamentin e Kosovës, hajde hapim hetime, hajde hapim hetime për borde, hajde hapim hetime për procesin e privatizimit, hajde hapim hetime për Postë-Telekomin e Kosovës, hajde hapim hetime për Radiotelevizionin e Kosovës, hajde hapim hetime për mënyrën se si janë emëruar prokurorë e gjykatës. Mua më keni me vete. Mua më keni me vete!

Hajde hapim hetime për korrupsionin! Hajde hapim hetime se si është shitur KEDS-i, për sa milionë është shitur? Kujt i është falur KEDS-i? Sa ka kushtuar një kilometër asfalt? Hajde hapim hetime sa para kanë shkuar kot, e nuk është ndërtuar asnjë shkollë?

Hajde, për këto më keni, por jo, sepse ju disa bibanë, që thirreni në emrin e patriotizmit, ju flisni shqip, por jeni më të zinj se Lista serbe, sepse veprimin e mendimin i keni prej Vuçiqit dhe prandaj kjo mua më pengon. Hajde, për çdo proces që ju... kemi deputetë të rinj dhe e kemi shansin për herë të parë, hajde e hetojmë UDB-në, hajde e hetojmë SHIK-un, e keni nënshkrimin tim. Hajde t'i hetojmë! Pse juve... për çka po u pengon vetëm SHIK-u, e s'po ju pengon fare UDB-a. Hajde vëlla! Hajde i qesim dosjet! Hajde, thoni duam ta hetojmë Milaim Zekën, por jo të dilet në medie, jo në portale, jo të më akuzoni familjarisht e kombëtarisht, sepse, në fund të fundit, unë që kam jetuar prej vitit 1982 nëpër Evropë, e që kam punuar, urdhëro, le ta marrë Policia e shtetit tim raportin nga Policia suedeze, austriake, franceze, a kam qenë në jetën time vetëm një sekondë diku në burg?

Ndërsa, për luftën time, për punën time, flet komandanti im atje ku është ulur. Ai le të flasë a kam qenë unë e kush kam qenë në Koshare, çfarë madhështie i kam bërë luftës së Koshares?

Por, krejt në fund, dëshiroj të them diçka edhe po e përfundoj fjalën time. I kërkoj falje publikisht Besa Gaxhërit. I kërkoj publikisht falje dhe po të kërkoj falje shpirtërore, sepse kam qenë në gjendje të rëndë shpirtërore dhe të kërkoj shumë falje ty dhe krejt deputetëve, të cilët janë ndjerë të fyer nga sharja ime në korridor. I kam kërkuar falje për një incident në aeroport publikisht, por edhe privatisht, koleges sime që po ashtu, po ashtu në afekt dhe privatisht, jo publikisht, po privatisht i kam thënë "lopë e Danimarkës".

Çohu ti "tarak" e më thuaj mua "lopë" e çka të duash, ti çohu lirisht e më thuaj "kali", më thuaj "lopë", unë prej teje nuk fyhem. Lirisht! Frashërit do t'i kërkosh ti falje, në qofsh gjallë, ti do t'i kërkosh falje. Po të betohem, ti do t'i kërkosh falje Frashërit. Më ka rrahur Albin Kurti, më ka rrahur Glauku, më ka rrahur Rexhep Selimi. Mua më ka rrahur Albulena Haxhiu, babagyshin e së cilës e kam pasur idhull, idol. Këta më kanë rrahur. Unë me karkaleca nuk merrem.

KRYESUESI: Milaim...!

MILAIM ZEKA: Por, dijëni veç diçka, po e përfundoj, zoti kryesues.

KRYESUESI: Të lutem, regjia...

MILAIM ZEKA: Jo, ai nëse ma marrë fjalën, unë piskas, këtu më ke, këtu do të me kesh.

KRYESUESI: Faleminderit, Milaim! Milaim, të lutem ulu në vend! Milaim, të lutem, të gjithëve na ka ardhur keq çfarë ka ndodhur, por të lutem ulu në vend! Tani fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që ky Kuvend duhet t'u kthehet temave, të cilat janë shumë aktuale, shumë të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës, temat për të cilat qytetarët tanë edhe na e kanë dhënë besimin dhe besojnë se ne do t'i zgjidhim.

Pra, përpara se të fillojmë të diskutojmë për programin qeverisës, mendoj se Qeveria e Kosovës bashkë me ne, Kuvendin e Kosovës, në rend të parë duhet të zgjidhë një problem, i cili tani e më shumë se dy vjet po e mban peng vendin dhe është bërë pengesë për hapërimin e Kosovës në rrugën evropiane.

Pra, ne duhet ta zgjidhim demarkacionin për të vazhduar me zgjidhjen e problemeve tjera, të cilat i ka ky vend. Demarkacioni me Malin e Zi nuk është më vetëm çështje ndërmjet nesh, apo çështje ndërmjet nesh dhe Malit të Zi, por është çështje strategjike e miqve dhe partnerëve tanë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Prandaj, ne e kemi për obligim dhe detyrim që ta zgjidhim e të hapërojmë tutje. Ramush Haradinaj si një patriot i vërtetë, një burrshtetas dhe kryeministër i Republikës së Kosovës, që vjen nga një familje shumë e respektuar, e që ka dhënë shumë për vendin, e ka për detyrë dhe obligim që këtë partneritet, këtë miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n ta ruajë dhe ta sforcojë, sepse është një nga bazat e themelimit të shtetit dhe të lirisë sonë, dhe hapërimin tonë nga rruga jonë evropiane, në rrugën drejt integriteteve në këto institucione.

Pra, ne duhet ta zgjidhim demarkacionin përpara festave të nëntorit, me qëllim që qytetarët tanë të lëvizin lirshëm për festat e fundvitit. Dikush këtu edhe mund të mos i pëlqejë, sepse këtë temë e ka përdorur për kauza politike, jo pse ka ndonjë brengë tjetër.

Tani do të diskutojmë edhe për programin qeverisës, për shëndetësinë, për arsimin, për kulturën, sportin, rininë, problemet e veteranëve, pensionet e familjeve të dëshmorëve, disave nga ata që u janë ndalur pensionet padrejtësisht, për punëtorët e arsimit të viteve të '90-ta që presin zgjidhje nga ky Kuvend dhe mundësinë që ata e kërkojnë që ne t'ua japim që ata të punojnë dinjitetshëm dhe të jetojnë dinjitetshëm në Kosovë, por gjithsesi edhe për pensionistët dhe "Trepçën", si dhe zhvillimin ekonomik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Programi për shëndetësi ka nevojë të përmirësohet nga ky që është ofruar dhe mendoj që prioritetet në shëndetësi ne duhet t'i listojmë kështu:

- implementimi i sigurimeve shëndetësore, duke e funksionalizuar SISH-in dhe AFSH-në si parakusht i domosdoshëm për fillim të realizimit efikas të sigurimeve shëndetësore, e që nuk kishte ndonjë afat të përcaktuar në programin qeverisës dhe mendoj që këto afate duhet të precizohen;
- funksionalizimi i sistemit shëndetësor primar, sekondar dhe terciar në tërë Republikën e Kosovës deri edhe në veri, që i mungon një shtrirje e tillë;
- ndërtimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës,
- lidhja fizike e klinikave në Qendrën Klinike Universitare;
- integrimi i Spitalit të Mitrovicës Veriore në sistemin shëndetësor të Kosovës;
- digjitalizimi i shpërndarjes së barnave në sektorin publik me qëllim të parandalimit të abuzimit me barna në këtë sektor;
- rishikimi i pakos ligjore në sektorin e shëndetësisë;
- harmonizimi dhe plotësimi i ndryshimit të ligjeve me qëllim të përmirësimit të gjendjes në sektorin e shëndetësisë;
- funksionalizimi i mjekësisë familjare në të gjitha komunat e Kosovës, sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetit;
- punësimi i të gjithë mjekëve që e kanë përfunduar specializimin në Kosovë;
- rritja e pagave për mjekët bazuar në performancën e tyre, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore më kualitative;

- me qëllim të ngritjes dhe ruajtjes së kuadrit mjekësor në Kosovë parashihet që t'u ndahen specializime në bazë të nevojave kadrovike të gjithë atyre që kanë përfunduar studimet në mjekësi;

- mbështetja, ngritja profesionale dhe angazhimi i stafit të mesëm qenësor sipas standardeve të OBSH-së, e që është duke munguar;

- ofrimi i kushteve ligjore të barabarta për zhvillimin e sektorit privat shëndetësor dhe publiko-privat me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve shëndetësore;

- të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore të cilësisë sa më të lartë.

Këto ditë fushate kemi dëgjuar të diskutohet për shëndetësinë dhe e veçanta e këtyre diskutimeve nga disa subjekte politike në komuna që kanë udhëhequr është se po mburren se e kanë rritur numrin e vizitave mjekësore në qendrat mjekësore që ata i kanë udhëhequr. Pra, ata, ose nga naiviteti, ose nga padituria, po mburren me rritjen e sëmundshmërisë në komunat që ata i kanë udhëhequr. Para disa ditësh e kemi dëgjuar një deklaram se në kryeqytet numri i vizitave mjekësore është rritur në 1 200 000 vizita mjekësore. Pra, i bie që kryeqyteti ynë me 200 000 banorë, një qytetar i kryeqytetit ka shkuar te mjeku 6 herë. Kjo është shqetësuese dhe mendoj se kjo e përcakton orientimin se nuk është investuar në parandalim. Dhe, është shumë shqetësuese nëse 1 200 000 qytetarë të Prishtinës kanë shkuar në vizita mjekësore, sepse kjo dëshmon se ajri në Prishtinë është tejet i ndotur, si njëri nga faktorët që ndikon në rritjen e sëmundshmërisë, që kushtet sociale në kryeqytet nuk janë të mira dhe kjo është nga faktorët e rritjes së sëmundshmërisë dhe në vend se të shqetësohen për rritjen e sëmundshmërisë, ka të atillë që mburren me rritjen e sëmundshmërisë së Prishtinës dhe kjo është shqetësuese.

Për më keq, një udhëheqës tjetër institucional, për të bërë pak krahasim me këto 1 200 000 vizita mjekësore në Prishtinë, tha: “Në Qendrën Klinike Universitare janë 3 milionë e gjysmë vizita mjekësore”. Pra, po krahasohen se kush më shumë ka të sëmurë! Kjo është më shumë se naive. Kjo dëshmon se sistemi ynë shëndetësor nuk funksionon. Kjo dëshmon atë që kam thënë prej fillimit që jam në këtë Kuvend, se ky sistem duhet të ndryshohet dhe të përshtatet sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, ku vetëm 20% e vizitave mjekësore duhet të kryhen në institucionin terciar, deri në 10% e këtyre vizitave duhet të përfundojnë dhe të kryhen në institucionet sekondare dhe primare të shëndetësisë. E, kjo nuk po ndodh dhe kjo duhet të përmirësohet, e mund ta bëjmë bashkë pa dallime politike, për interesin e pacientit, për interesin e qytetarëve.

Nuk do të flas shumë për programin e arsimit, sepse do të pres që ministri i ri i Arsimit ta zgjidhë një problem që këtu tani e pesë vjet e kam ngrehur, për problemin e çantave të stërngarkuara shkollore dhe derisa nuk ka mundur të zgjidhet një problem i çantave të stërngarkuara të fëmijët në shkolla, atëherë presim të vazhdojmë me ministrin e ri të Arsimit ta zgjidhë edhe problemin, edhe të cilësisë, por edhe një problem, një brengë, që është për të gjithë prindërit që i dërgojnë fëmijët në shkolla.

Gjithsesi, një nga kërkesat e mia në Kuvend ka qenë funksionalizmi apo zbatimi i Ligjit për sponsorizime, zoti Hoti, ligj të cilin ju e keni bllokuar si ministër i Financave, i cili ka hyrë në fuqi në janarin e vitit 2017, e është dashur të fillojë të zbatohet deri në fund të qershorit. Nuk po zbatohet as ai, as Ligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport, sepse këto dy ligje do të mundësonin që sporti ynë dhe kultura të zhvillohen dhe të mbështeten nga sponsorët. Kërkoj nga ministri i ri i Financave, që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, këto dy ligje t'i jetësoj gjithsesi edhe me Ligjin për menaxhimin dhe sigurinë e objekteve sportive, nëse i bënë të domosdoshëm në këtë botë të pasigurt, në të cilën po jetojmë.

Mendoj që këto janë objektivat të cilat duhet t'i njuhë Qeveria e re bashkë me mbështetjen për rininë dhe për infrastrukturën sportive.

I nderuar ish-ministër Kujtim Shala, edhe me 6 tetor Kosova do të vazhdojë të luajë në Shkodër, një nga vërejtjet e mia të cilën ua kam bërë në vazhdimësi. Prandaj, kërkoj një mbështetje për infrastrukturën sportive, sepse të rinjtë tanë kanë nevojë që të mbështeten nga shteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu ka kërkuar replikë, më duket nuk ia ka përmendur emrin. Edhe ti a? Tash me radhë. Meqenëse është fjala për program, po bisedojmë, por zakonisht është dashur me ministrat të debatohet, e jo deputetët ndërmjet veti sa i përket programit qeverisës. Sidoqoftë shfrytëzoheni meqenëse është fjala për program, merreni të dytë fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Shkurt t'i përgjigjem deputetit.

Ligjin për të ardhurat e korporatave dhe Ligjin e sponsorizimeve jemi kujdesur që t'i sjellim në Kuvendin e Kosovës për të mundësuar që klubet sportive të financohen shumë më tepër sesa në të kaluarën.

Gjatë qeverisjes deri në vitin 2014, kompanitë kanë mundur të sponsorizojnë klube sportive deri në 5% të fitimit të tyre.

Gjatë qeverisjes sonë e kemi rritur këtë në 10%, e kemi dyfishuar, plus edhe 10% tjera, pra 20%, me vendimet e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sport. Pra, e kemi bërë 20%.

Atë çfarë keni kërkuar ju në mandatin e kaluar këtu ka qenë kundërkushtetuese, ka qenë si mënyrë për të mundësuar shpëlarje të parave prej bizneseve te klubet sportive. Kjo është e vërteta. Ta kam thanë atëherë, po ta them edhe tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar Hoti!

Vërtet kam menduar që je ndonjë ekonomist më i mirë, e jo kaq i dobët. Po më befason si mund që një ligj, të cilin e ka aprovuar ky Kuvend, ju të mos e dërgoni në Gjykatë Kushtetuese, e tani pas një viti thoni është kundërkushtetues. Pse nuk e keni dërguar Ligjin në Gjykatën Kushtetuese nëse ka qenë, ose pse nuk e keni bërë kundërshtimin te Presidenti, nëse Ligji për sponsorizimet ka qenë kundërkushtetues.

Ju e keni pasur obligim për ta zbatuar ligjin. Unë nuk di se paratë e Nuxhetit të Kosovës mund të shpërlahen. Nëse ju e keni këtë aftësi, tregojeni.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu e ka fjalën, edhe ky për replikë.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, sa për informim për deputetin Haxhiu, shëndetësia primare në komunën e Prishtinës është shembull tashmë për krejt republikën. Janë 33 qendra të mjekësisë familjare që janë komplet të renovuara, asnjë medikament nuk mungon, të gjitha pajisjet funksionojnë, përderisa sot në Republikën e Kosovës kemi ende telashe me salla operative, ende telashe me oksidiol, ende telashe me zbardhjen e rasteve që kanë vdekur. Pra, e keni një model të mirë në Prishtinë, e keni një model i cili funksionon, ndoshta është mirë të lexoni pak e të shihni se si rregullohet shëndetësia.

KRYESUESI: Faleminderit! Bekimi, kundër-replikë!

BEKIM HAXHIU: I nderuar deputet,

Besoj që je i ri në Kuvend, nuk e ke përcjellë punën, ndoshta ke pasur punë në Komunë rreth ndërtimeve, lejeve, keqpërdorimeve, rehatimit të militantëve e të tjera.

Besoj, i nderuar, nuk je për mburrje, sepse në vend se të përqyroheshit te gropa e ujit në Kolovicë, e dilni t'i shëtitni me jahte fëmijët tuaj nëpër Budvë, e duhej të merreni me shëndetin edhe me parandalimin e atyre dukurive që kanë qenë.

Jo që nuk është për shembull qeverisja në Prishtinë, por është për tmerr.

Prandaj, i ke tre milionë e gjysmë vizita të referuara në sektorin terciar dhe unë kam qenë kritiku më i madh për gjendjen në shëndetësi dhe unë kam qenë kritiku më i madh për gjendjen në shëndetësi. Ju jeni përqyrravë në Kolovicë, e keni dalë të shëtitni në Budvë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë të Kuvendit,
Të dashur qytetarë të Republikës,
Katër muaj po bëhet hajgare me popullin, dhe me këtë Kuvend.

Para një muaji, në fund erdhi dita për t'u formuar Qeveria, po atë ditë në vend se të diskutohet programi qeveritar nuk kishim program qeveritar, po e pritnim Listën serbe për të ardhur nga Beogradi. Pas gjithë asaj pritjeje, u pamundësua debati për shkak të një pauze 15-minutëshe, u votua Qeveria pa e parë programin qeverisës. I kishim vetëm nja 10 faqe për parimet, por kur i shikua ato parime, ato me të vërtetë nuk ishin as parime, ngase nuk tregonin se çka duhet të bëhet me arsimin, çka duhet të bëhet me ekonominë, çka duhet të bëhet me sfera të ndryshme të jetës në Kosovë, që të përmirësohet jeta e qytetarit të Kosovës, por ishin vetëm fjalë boshe.

Menjëherë pas asaj ne e kërkuam një seancë të jashtëzakonshme, më shumë se 40 deputetë nënshkruan. Sipas Rregullores, seanca është dashur të mbahet menjëherë brenda 40 orëve, por seanca e jashtëzakonshme nuk është thirrur për tri javë.

Në mënyrë që të përgatitet një program qeverisës që të na dërgohet neve, ashtu që të pamundësohet debati lidhur me programin qeverisës të Qeverisë.

Në fund e morëm një program, por në program unë i shikova disa pjesë, ngase nuk kishim edhe shumë kohë për t'i shikuar, por në shumë pika me të vërtetë nuk kemi as prioritete, e nuk kemi as se çka do të bëjë Qeveria lidhur me çështjet kyçe, të cilat e pamundësojnë jetën normale të qytetarëve të Kosovës dhe i shtyn ata në migrim.

Në këtë program shohim vetëm që është rritur numri i ministrive dhe inovacioni i vetëm është rritja e numrit të ministrive, edhe Ministria për Inovacion.

Nëse e shikojmë listën e objektivave të Ministrisë së Financave, për shembull e kemi një objektiv, i cili quhet shfrytëzimi i partneriteteve publiko private.

Ky është mekanizëm e nuk është objektiv, është mekanizëm për t'i rritur investimet, për të mundësuar investimet kapitale aty ku shteti nuk ka fonde dhe është mënyrë se si të kemi investime kapitale kur nuk kemi buxhet.

Por, fatkeqësisht, këtu është listuar si objektiv i Qeverisë lidhur me këtë.

Pastaj, për shembull, e kemi lehtësimin e qasjes në financa, ngritja e kapitalit për Fondin Kosova për Garanci Kreditore, por kur shikojmë brenda këtij objektiv i shohim që është krijuar prej USAID-it, është krijuar një fond kosovar për garanci kreditore dhe funksionon nga donatorët e huaj.

I vetmi send që aty thuhet dhe merret si diçka që është krijuar nga donatorët, plasohet si objektiv i Qeverisë, e që fatkeqësisht nuk mund të jetë objektiv, ngase tashmë është krijuar. S'mund të kesh një objektiv për diçka që tashmë është krijuar.

Dhe në të njëjtën kohë, pastaj thuhet që Qeveria do ta mbështesë këtë fond. Me sa fonde do ta mbështesë, si do ta mbështesë, çfarë do të jetë qëllimi i Qeverisë në aspektin e mbështetjes së këtij fondi.

Domethënë, një program qeveritar që lë shumë për të dëshiruar, ngase në të vërtetë as konceptet bazike, siç është prioriteti apo objektiv i nuk i ka të dallueshme, domethënë janë të përziera edhe qëllimet, edhe synimet, por edhe objektivat e çdo ministrie.

Unë vetëm edhe diçka desha të them në fund: Është një Qeveri ku janë krijuar 21 ministri, e ku nuk dihen kompetencat e ministrive të ndryshme, ngase, për shembull, e kemi Ministrinë për Zhvillim, por e kemi edhe Ministrinë për Zhvillim Rajonal, çfarë është dallimi ndërmjet tyre? Cilat janë kompetencat më ndryshe të një ministrie nga ministria tjetër? E problemi kyç në Kosovë ka qenë përzgjedhja e kompetencave dhe përzgjedhja e përgjegjësive ndërmjet aktorëve të ndryshëm që e kanë qeverisur Kosovën.

Tash me këtë Qeveri, prapë kemi krijuar të ministrive të cilat hyjnë në kompetencat e njëra-tjetres dhe nesër-pasnesër kur të ketë dështime qeveritare, ata me siguri do t'ia hedhin fajin njëra-tjetres. Domethënë, Ministria e Pushtetit Lokal mund t'ia hedhë fajin Ministrisë së Zhvillim Rajonal; Ministria e Zhvillimit Rajonal me siguri do t'ia hedhë fajin Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ngase çfarë dallimi mund të ketë një ministri, domethënë ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Zhvillimit Rajonal. Zhvillimi është zhvillim, është i njëjtë për gjithë Kosovën. Kosova është një vend i vogël për ta ndarë në rajone dhe ky është një gabim shumë i madh i Qeverisë me rritjen e numrave të ministrive.

Vetëm një kuriozitet, Gjermania sot me më shumë se 80 milionë banorë i ka diku 12-13 ministri, e po të kishte qenë me numrin e popullsisë, numri i ministrive në Kosovë, Gjermani është dashur të kishte për shembull 1 111 ministri. Kjo është diçka e pashpjegueshme.

Edhe me madhësinë e Buxhetit që e ka Kosova, por edhe me numrin e banorëve, tregon që kjo Qeveri, edhe me programin qeverisës, edhe me numrin e ministrive, edhe me përzierjen e kompetencave që ka, edhe me përzierjen e asaj se çka do të thotë objektiv, e çka do të thotë prioritet, ka filluar si e dështuar, prandaj po më vjen keq për qytetarët e Kosovës që do të humbim prapë nja 4-5 muaj derisa rrëzohet kjo Qeveri dhe të kemi zgjedhje të jashtëzakonshme, ndoshta në fillim të pranverës.

Prapë po humbim kohë kur Kosova duhet të punojë shumë në integrimet evropiane dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do ta mbaj fjalën time, do të thotë do të tërhiqem, sepse e kam të domosdoshme që kryeministri të jetë i pranishëm, zoti Haradinaj, jo ai si person, por në funksionin që e ka.

Dhe, meqë jam njëri nga përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, besoj që kemi çështje të rëndësishme parësore publike që duhet t'i bisedojmë me të.

Do të thotë, për çështje për të cilat unë do të diskutoj në Kuvendin e Kosovës do ta pres kryeministrin, kurdo që të jetë ai. Unë nuk flas diçka, ato që i kam, i them kur të jetë kryeministri këtu.

Sidomos, kur ai po pretendon për disa të vërteta, për të cilat gjithë e dimë që nuk janë të vërteta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk ma mori mendja që do të dal 3-4 herë te kjo foltore, e kjo është arsyeja që edhe këtë herë do të mundohem që të jem pak më i shkurtër. Është për keqardhje që atë që e

paralajmërova në fillim, që këtu gjithçka mund të flasim, veç debat për program e Qeveri sot nuk do të ketë, doli e vërtetë.

Tash unë nuk jam i sigurt a janë deputetët që e kanë ftuar këtë seanca të papërgatitur, nuk kanë lexuar as parime, as program, apo realisht me të vërtetë është gjithçka në funksion të fushatës elektorale, në ethet e së cilës, tek e fundit, të gjithë jemi, sepse përfaqësojmë parti politike që janë në garë.

Po e them këtë, sepse, me ndonjë përjashtim të vogël, këtu u fol për tema që nuk kanë lidhje me Qeverinë, që nuk kanë lidhje me këtë Qeveri, as me atë të fundit, që nuk kanë lidhje me programin, që nuk kanë lidhje me prioritete, s'kanë lidhje me projekte.

U fol për tema për të cilat flitet vit pas viti, dekadë pas dekadë, dolën njerëz të rinj që ndoshta deshën të dëshmohen në partitë e veta të reja, të cilat i kanë kapur prej brenda për t'u treguar që edhe ne jemi burra të mirë edhe ne e duam këtë parti, jemi të zëshëm dhe kemi çka të themi. Realisht, ne e dimë cili ka qenë në cilën parti prej kur është koha që njerëzit kanë filluar të dalin në televizione, ose të japin deklarata.

Nuk ka nevojë për t'u dëshmuar më shumë. Bile disa më shumë u kanë kryer punë partive kur kanë qenë në ato parti, e emrin e kanë pasur shoqëri civile, ose gazetarë, ose diçka tjetër, sesa tash që kanë hyrë brenda.

Disa kanë pasur sukses, disa kanë mbetur jashtë, nuk kanë mundur ndoshta ta marrin besimin e popullit, s'i ka mbështetur lidhshipi i partisë, por kështu është politika.

Ajo çka mendoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe që ma merr mendja secilin do të ishte dashur brenda vetvetes ta brejë është devalvimi, të cilin jemi duke ia bërë kësaj foltoreje.

A ka mundësi të paktën të ruhem, ta kemi një limit që të mos ketë fyerje, ofendime, shpifje personale?

A bën të mos pajtohem ne pozita-opozita për çështje që ndërlidhen me projekte, me program dhe me prioritete, por të paktën të mos lëshohemi në nivelin "ad hominem", të mos e shajmë njëri-tjetrin.

Problemi është që jemi duke e rënduar skenën tonë politike. Nëse shkojmë në këtë nivel, duke u munduar dikush të dëshmohet para dikujt që "jam shumë i devotshëm për parti", ose për këdo qoftë, po shkojmë në një pikë, nga ku pastaj kthimi është një problem

mbrapa. Po shkojmë në një pikë ku pastaj kemi qenë dëshmitarë të skenave që asnjë njeri nuk e bëjmë të ndihet mirë, përkundrazi duhet turpëruar.

Kjo skemë politike ka nevojë për të pasur pak më shumë racionalitet. Kjo skemë politike ka nevojë përnjëmend për diskutime. Ju po kërkoni diskutim, e nuk po diskutoni. Edhe ato shkaras që po i diskutoni, tash keni filluar t'i keqinterpretoni.

Po marr shembull prej ish-kolegut tim, tash kolegut në Kuvend, zotit Hoti. E përmendi Ligjin për sponsorizim. Mos burrë, se s'kemi për të bërë asgjë me Ligjin për sponsorizim. Unë ministër kam qenë në atë Qeveri. Me vjet s'e kemi bërë Ligjin për sponsorizim. Nuk është në fuqi Ligji për sponsorizim, një shembull po e marr: E kemi miratuar, asnjë rregullore që është dashur ta kryejmë nuk është kryer. Asnjë klub sportiv në Kosovë, asnjë sportist në Kosovë, asnjë përfitim s'e ka prej atij ligji.

E kemi bërë edhe një ligj, i cili edhe ashtu nuk krijon zgjidhje. Nuk është mburrje, zoti Hoti, të thotë "e kemi bërë prej 5% në 10%". Nuk është, sepse realisht nuk ia dyfishon mundësinë e investimit të kompanisë, por përkundrazi ia rëndon, sepse ai duhet të shpenzojë më shumë, ndërsa lirim në tatim e ka më të vogël. Ok-ej! Dil shpjegoje, pra. O e di unë atë Ligj të sponsorimeve, o s'besoj që e dini as ju dy që keni qenë, njëri në Kulturë e Sport, e tjetri në Financa. Sepse jam marrë me atë temë dhe është e vërtetë që ka qenë vështirë për ta bërë zgjidhjen më të mirë, pikërisht pse ka qenë problematike, se kjo nuk ka qenë zgjidhje dhe unë këtë zgjidhje nuk kam dashur ta kryejë, sepse ajo nuk i ndihmon bizneset, aq më pak sportistët.

Por, t'u kthehem edhe gjërave tjera. Po e ripërsëris, do të ishte mirë të merremi vesh që të debatojmë përnjëmend për programin, kur Qeveria është këtu. E ke programin, e keni programin tash dy javë secili, se këtu për shembull ishte një deputet që pak më herët foli për programin, e tash ai doli prej rendit të ditës. Më fal, ai doli prej rendit të ditës, deputeti paraprak, se fliste për programin. Nuk fliste për parimet programore, ia kishte filluar ta lexojë dokumentin prej 130 faqesh, në vend të këtij me 10 faqe.

Ju po kërkoni të flitni një herë për 10, e tani për 130. Ok-ej! Në rregull është, e drejtë juaja, por e vërteta është që nuk ka asgjë substanciale në debatin e sotëm, për fat të keq, dhe ne duhet të flasim përnjëmend për programin e Qeverisë.

Unë jam njëri prej atyre që do të diskutoj në detaje për atë program, po ejani të merremi vesh, ta bëjmë seancën, sot mund ta mbledhim Kryesinë, nesër, kur të vendosin udhëheqësit e këtij Kuvendit dhe e thërrasim kryeministrin me krejt Qeverinë, qëndrojnë këtu përballë nesh dhe diskutojmë për tema konkrete, për fusha specifike, i japim mendimet, në fund të fundit, ju e dini, shumica e vendos, sepse, në fund të fundit, është

programi i Qeverisë ai me të cilin ne kemi për ta matur edhe performansën e kësaj Qeverie.

Por, po ashtu po e përsëris që do të ishte mirë, pavarësisht diskutimeve të debateve që të ruhet në nivel së paku optimal, të mos them minimal, i korrektësisë qytetare, i korrektësisë politike dhe i një jetike, i një morali që mos të degradojmë më shumë në nivelin e fyerjeve dhe të shpifjeve personale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala, për replikë, ia ka përmendur emrin.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë në asnjë rast nuk e interpretoj përbërjen as përfaqësimin e subjekteve tjera politike dhe mbi këtë logjikë edhe sot, edhe fjalën e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së e pranoj si autentike, edhe si fjalë, edhe si sjellje, si përfaqësues autentik i PDK-së, është qind për qind i PDK-së.

Tani unë do të bëj dy saktësime të vogla.

E para, ne sot nuk e kemi në rend të ditës programin e punës së Qeverisë, sepse ne si kërkues të kësaj seance e kemi vënë një pikë tjetër të rendit të ditës. Kemi temë tjetër, objekt tjetër, parimet e qeverisjes, ose më ndryshe - ekspozenë e atëherë ish-kandidati për kryeministër - mandatarin, tani kryeministër i Kosovës, dhe përbërjen e Qeverisë.

E dyta, meqë u nënvizua dy herë Ligji për sponsorizim, unë atëherë si përfaqësues i Qeverisë, si sponsor i atij ligji, kam kërkuar që të mos votohet amendamenti i Komisionit Parlamentar FunkSIONAL të asaj fushe, sepse kam shpjeguar që ai amendament bie ndesh me Ligjin për të ardhurat e korporatave. Meqë ai bie ndesh me atë ligj, është i pazbatueshëm dhe s'mund të nxirret asnjë akt tjetër nënligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shkumbin Demaliaj. A deshe kundër-replikë?

SHKUMBIN DEMALIAJ: I nderuar kryesues,
Deputetë të Kuvendit të republikës,
Përfaqësues të medieeve,

Më vjen keq se ata që vazhdimisht kanë kërkuar për të debatuar edhe parimet, edhe programin, sidoqoftë le ta quajmë, nuk janë të interesuar as të qëndrojnë në këtë seancë, e kanë kërkuar që ne të jemi me prani, sepse s'po i kanë numrat për ta vazhduar seancën. E pse nuk i kanë numrat, dihet se për debatin për krijimin e Qeverisë nuk votohet. Kemi ardhur veç për t'ua bërë qejfin. Veç për t'jua bërë qejfi kemi ardhur në këtë seancë.

Zoti kryesues i Kuvendit,

Dua të njoftoj se fushata për zgjedhjet e 22 tetorit ka marrë hov, zhvillimi është kah shkon shumë mirë.

Po të njoftoj si deputet, partitë politike, secila me programin e saj, se për këtë kishin ardhur sot, se është fushatë zgjedhore, bile të ju njoftoj, e sidomos Aleanca i ka punët më së miri. Më vjen keq, tash se jemi në koalicion, duhet të them se edhe PDK-ja dhe “Nisma” dhe qysh më 22 tetor do t’i kemi nja 10 komuna të para të tria bashkërisht. As “Vetëvendosja”, as LDK-ja asnjë komunë s’kanë për ta marrë pa balotazh, por edhe për balotazhin që do të krijohet duhet të merren vesh me neve. E dinë këta. A jam kah shkoj mirë kryetar për fushatën?

Dhe pas 22 tetorit do ta shohim anën tjetër, do ta shihni edhe 100-ditëshin e kryeministrit Haradinaj. Më vjen keq, zoti Kurti! Je inxhinier! Asnjë projekt kurrë nuk ia ke ndërtuar Kosovës. As semaforin qysh duket në mëhallën tënde te rruga jote. Keni ardhur me koncepte të gabueshme. E ke një turmë deputetësh, falënderoju qytetarëve që u kanë respektuar.

Këta qytetarë që ju kanë respektuar, respektoni edhe ju. 98% e deputetëve në listën tuaj janë njerëz që i kanë shkelur krejt subjektet politike, disa të përjashtuar, nuk jeni alienë. Nuk guxoni ta ofendoni më qytetarin e Kosovës. Varet krejt edhe nga kryesimi që do t’i bëhet këtij Kuvendi, edhe kësaj Legjislature. Çfarë edukate politike do të mbjellim ne në Kuvendin e Kosovës dhe në institucionet e Republikës.

Shoh se këtu dalin njerëz edhe duan t’ia bëjnë gjyqin dikujt. E kemi të rregulluar me ligj, është e rregulluar me Kushtetutë, çfarë republike jemi, cili është sistemi tripartit që funksionon. Të mos bëhem i mençur të ju kallëzoj se njëqind herë na kallëzuat çka është Rregullorja. E keni ditur që nuk ka pasur shkelje në procedura për t’u ndërtuar Qeveria. Do ta kishit mësyre drejt Gjykatën Kushtetuese, se kur ju dhemb shkoni, kur nuk ju dhemb e përsëritni. Gjithë si mekanizëm e keni të vendosur një CD në krye, prej anëtarit më të vogël në qytet, apo në fshat, apo në një lagje, deri te kryetari.

Në radhë të parë i keni shkelur parimet e juaja. Gjysma e partisë e keni mundur kryetarin tuaj në zgjedhje. Këta jeni ju! Vetë Visar Ymerin e keni mundur, gjysma e partisë. Këto janë meritat tuaja. Keni pasur liderë përpara, thoni “ne jemi ne”. Në këtë rast, më vjen keq po lëshohem edhe në atë çfarë u diskutua më herët.

Ish-kandidati për kryeministër zoti Hoti,

Është tmerruese për ta thënë një fjalë nga goja jote “nuk i votoj donacionet e IPA-s e atyre si Lidhje Demokratike e Kosovës”. E keni lëshua partinë vetë në zero, ju jepni leje

gazetarëve thua se janë në “Click” apo në emisione tjera, për të dalë për të folur në emër të Lidhjes Demokratike. Nëse ai është qëndrimi i tyre, le të dalin të flasin, po binduni se është tmerr të dëgjohet vetë prej gojës tënde. Nëse ju keni menduar dhe flitni për çdo ditë për atë dy miliardin e famshëm, ne këtu do t’i diskutojmë të gjitha këto elemente.

Kosova nuk është e askujt tjetër, përpos e qytetarëve të saj, dhe institucionet e Republikës janë të Republikës së saj.

Opozita në këtë rast, e përmendin fjalën katër muaj, e merren me çështjen e Listës serbe. Askush më mirë nuk e di sesa kemi jetuar në robëri. Ne nuk kemi luftuar dhe çliruar për t’i dëmtuar dhe për t’i shkelur pakicat në Kosovë. Askush më mirë se Kosova nuk e di. Janë parti parlamentare, janë qytetarë të Republikës. Nëse ka nevojë dikush për Republikën e Vuçiqit, le të shkojë te Vuçiqi dhe t’ia ndihmojë, ashtu sikur kanë bërë fushatë në territorin e Republikës së Serbisë. Sikur të kishte ndodhur diçka e tillë në Shkup, në Kukës apo në Bajram Curr do t’ua kishim pranuar. Po pse ju lejoi bash Serbia, deri te Livadhi i Shehit?! Ende mund të jenë ato elementet e asaj rruge. Më mirë është dashur të diskutohet për t’ia kushtëzuar ndoshta në bisedime edhe Serbisë që t’i pranojë diplomat e qytetarëve që vijnë nga Lugina e Preshevës. Shkollohen në Kosovë, nuk e kemi bërë asnjë kërkesë për të drejtat e atyre studentëve që studiojnë këtu. Vetëm në Kosovë mund të punësohen, mund të jenë mjekë, inxhinierë, njerëz shumë të jashtëzakonshëm, por u shkelet ajo e drejtë.

Kështu që, më vjen keq zoti Kurti që po të drejtohem kështu, po kam pasur rastin të takoj anëtarë të “Vetëvendosjes”. Më interesonte për të biseduar me ta, thoshin “Albini është shumë i mençur, për atë jam në ‘Vetëvendosje’”. Bile pati ardhur koha për të menduar, thashë nuk kam nevojë të mendoj më se mendon edhe Albini për mua. Deri qatë ke shkuar, tash s’po mendojmë më. Por, kur e pashë se nuk e keni burrërisht, e keni me burracakëri, bile atë ma ke dëshmuar këtu kur ke folur herën e fundit pak para ardhjes së Qeverisë së re, kur ke dalë këtu e ke thanë “hajde matemi!”. A të është ka prishur kandari Albin, a? Ka Qeveria. Albin! Më vjen keq që të drejtohem kështu, po me kandari të prishur nuk duhet regjistruar. Lëreni fushatën, kandidatët janë të mirë të gjithë. Këtu në Kuvend jemi për tema të tjera. Krejt tema tjera kemi, çka duam t’i servojmë qytetarit tanë në të ardhmen më të afërt. Republika ka nevojë, shumë ka nevojë edhe për ju. Bila edhe pozita, edhe kryeministri Haradinaj ka nevojë për ju. Çka projekt që e afroni në tavolinë, ta ndihmoni, se është shteti ynë, e jo ju “do të bëni veç çka thotë Beogradi”. Në qoftë se ne mbetemi në mentalitetin çka thotë Beogradi, krejt këto çka thoni ju kanë përfunduar në vitin 1997. Kjo është CD e re për juve. Ne nuk jemi për luftëra të reja. I kemi kryer dhe dihet qysh janë kryer. Por, duam të mendojmë që gjithçka do të përfundojë me trajtimin e duhur.

Ju kisha lutur, jurist jam me profesion, e një çka po e di, zoti Krasniqi e ka drejtuar këtë Kuvend, ka pasur kulturë parlamentare. Ka pasur debat të hapur parlamentar, çdo ditë e më shumë, në vend se ta forcojmë atë çështje, ne jemi duke e shkatërruar secilin institucion në emër të asaj se duam t'i bëjmë gjyq njëri-tjetrit.

Edhe ju kisha lutur që kjo, po ju them edhe një herë, le të shfrytëzohet për diçka të mirë, se nuk është akulllore për ta lëpirë si t'i tekjet dikujt. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Albulena Balaj.

ALBULENA BALAJ: I nderuar nënkryetar!

Dhe, ju kolegë deputetë,

Meqë jam për herë të parë para qytetarëve nga Kuvendi, dua të them që këtu bëhen lojëra politike nga disa deputetë, të cilat fare nuk kanë të bëjnë me vend, ose më mirë të them, më së paku kanë të bëjnë me vendin.

Ky debat fare nuk i shërben edhe nuk u bën nder qytetarëve, sepse fare ose shumë pak u diskutua për parimet dhe programin e qeverisë. Ne e kuptojmë që opozita e kritikon qeverinë, por ama të paragjykohet nuk është e drejtë. Të paragjykohet se ajo nuk do të punojë qysh në ditën e parë, nuk është e drejtë. E kuptojmë se opozita e do pushtetin, por para pushtetit do të duhej, ama do të duhej ta donte shtetin. E kuptojmë se tash opozita edhe mund të thotë se kjo nuk është e vërtetë, por ama thoni cilat janë veprimet tuaja në të mirë të vendit? Cilat janë veprimet tuaja dhe politika e subjekteve tuaj që u bën nder qytetarëve të këtij vendi? Ndoshta rrahjet, sulmet, fyerjet, ndoshta.

Qytetarët kanë nevojë për punë, e disa nga ju jeni në punë dhe nuk punoni. Qytetarët kanë nevojë për bukë, e jo për filozofi politike, qytetarët kanë nevojë për mbështetje, e ju ua merrni mbështetjen qytetarëve dhe e keqpërdorni atë mbështetje. Qytetarët kanë nevojë për shpresë, e ju ua merrni atë, e atyre pak qytetarëve që u ka mbetur pak shpresë, e kanë shpresën te ne, e ne merremi me vetveten.

Të nderuar kolegë deputetë, ju lus, mos e shndërroni Kuvendin në arenë gladiatorësh, në luftë politike, në punë ose në vend pune pa përgjegjësi. Vendi ka nevojë për ne, ne duhet të jemi ata, të cilët duhet të punojnë për vendin, ne jemi ata të cilët duhet të punojmë ndershëm, ne jemi ata të cilët duhet të flasim me qytetarët e të merremi me problemet e tyre, e jo qytetarët të merren me problemet tona, e jo qytetarët të merren me luftën tonë të brendshme, e jo qytetarët t'i shqetësojmë përditë me gjuhën tonë të vrazhdë politike.

Të nderuar qytetarë,

Këtu ka deputetë, të cilët mendojnë se shteti ndërtohet me teori, prandaj në filozofinë politike mundohen të jenë të parët. Në këtë Kuvend, në vend se të përdoren më së shumti fjalët “demokratik, punë, angazhim, bashkëpunim, mirëkuptim, arritje, rezultat”, përdoren fjalët “hajn, kriminel, mashtrues, SHIK”, u lodhëm. Pra, kjo është edukata që ju po përcillni jashtë Kuvendit, kjo është edukata. Këtë edukatë duhet ta marrim më vonë nëse ne vazhdojmë kështu, prandaj jemi këtu. Përveç këtyre, në këto ditë kemi parë se opozita Listën serbe e ka shndërruar në faktor kryesor në Kosovë. Ata duan të jenë vendimmarrës, por ama nuk janë. Nëse kjo Qeveri po u varka nga kaq pak vota, e juve po ju vjen keq se varet kjo Qeveri nga ta, atëherë pse nuk u bëtë burra, e meqë po e doni Kosovën kaq shumë, t’i tejkaloni inatet, të bëheni bashkë e që askush të mos varet nga ta.

Pra, fjala “Lista serbe” në Kuvend përdoret me mijëra herë më shumë se sa fjala “zhvillim”, prandaj jemi këtu. Ne si deputetë duhet të angazhohemi që të kontribuojmë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë, në fuqizimin e kapaciteteve të qeverisë dhe mekanizmave të tjerë për rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian, duke marrë nisma konkrete. Këtë e presin qytetarët nga ne. Sigurisht që edhe ta atakojmë qeverinë, kur nuk punon mirë, kur ka ngecje. Fillimisht qeverisë duhet lënë kohë optimale për t’u marrë me ne, me problemet dhe sfidat reale, më pastaj të gjykojmë për punë ose mospunën e saj. Edhe ne të cilët e përbëjmë shumicën aktuale në Kuvend nuk kemi interes që të mbështesim një qeveri pa rezultate të prekshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne jemi të bindur se kjo Qeveri do të arrijë rezultate, të cilat do të vlerësohen nga qytetarët e Kosovës, rrjedhimisht do ta kenë mbështetjen tonë si deputetë dhe si parti politike.

Dhe, për fund, të nderuar deputetë, ne pamë angazhimin tuaj edhe atëherë kur kishim më shumë se 80 vota. Kur kishit në udhëheqje qeverinë, prandaj më së paku keni të drejtë të flisni ju, sepse ju, edhe vetë e thatë, vendi nuk doli nga kriza, pra në udhëheqjen tuaj, ju e futët vendin në krizë dhe vendi ende nuk paska dalë nga kriza. Unë dhe “Nisma për Kosovën” më së lehti në këtë legjislaturë e patëm të rrimë në opozitë, por ne morëm përgjegjësi, detyra shtetërore dhe kjo përgjegjësi po dëshmon se ne e kemi marrë seriozisht dhe do të vazhdojmë në ditët në vijim me punë të ndershme dhe do të punojmë ndershëm për këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit për këshilla kolegë e kolege të nderuara të pozitës që për herë të parë në historinë e këtij Kuvendi të pasluftës ju e përfaqësoni pakicën, prandaj silluni si pakicë.

Të nderuara kolege e kolegë deputetë,

Sot temë e diskutimit në Kuvend janë parimet e programit të Qeverisë, pra deputetët e Kuvendit të Kosovës me një kërkesë, e cila është sipas Rregullores së Kuvendit, kanë përcaktuar që në këtë seancë të diskutohet për këtë pikë të rendit të ditës. Ne po themi se jemi republikë parlamentare, kryeministri pak më herët tha: “Të shkojmë në punë”, po duhet ta dijë kryeministri se pjesë e vendit të punës është edhe Kuvendi. Ai duhet të rrijë në Kuvend, t’i dëgjojë diskutimet e deputetëve, t’i dëgjojë kritikën e tyre, t’i marrë parasysh dhe t’i futë në programin e tij qeverisës.

Në qoftë se kryeministri mendon që duhet të qeverisë pa Kuvendin, atëherë kjo s’është republikë parlamentare, atëherë është kjo mbretëri. Unë shpresoj shumë që kryeministri në të ardhmen do të qëndrojë në seanca, do t’i dëgjojë kritikën e deputetëve dhe pastaj do t’i implementojë ato në programin e tij qeverisës. Drejt të them, isha i përgatitur të diskutojmë, t’i shtroja një varg pyetjesh kryeministrit për pjesën e programit social, të cilin ai e ka përgatitur te parimet. Pra, nuk po flasim për programin qeverisës, por po flasim për parimet, sepse kjo është tema. Unë po lexoj, meqë janë vetëm pak rreshta, po e lexoj pjesën që ka të bëjë me programin social, respektivisht pjesën e cila merret me këtë çështje: “Të gjithë individët, të cilët për shkak të moshës, shëndetit apo çfarëdo arsye tjetër josubjektive nuk mund të sigurojnë të ardhura personale, Qeveria do t’iu garantojë jetë të dinjitetshme dhe përkujdesje nga shteti”.

Me fjalë të tjera, kjo i bie që nga programi i tij social, nga këto parime që ai i ka paraqitur, do të përfitojë secili qytetar i Kosovës, sepse 1 milion e 700 mijë qytetarë të Kosovës kanë probleme për të siguruar ekzistencën e tyre. Unë do ta kisha pyetur kryeministrin konkretisht: kemi 120 mijë qytetarë që jetojnë në Republikën e Kosovës me nga 68 centë në ditë. Në një vend ku jeta është më e shtrenjtë se në të gjitha vendet e tjera evropiane, ku jeta është më e shtrenjtë se në Berlin, e në Cyrih, se në Paris, e në Vjenë. Kur them “është më e shtrenjtë”, kam parasysh fuqinë blerëse, jemi në varfëri. Çdo qytetar i Kosovës është i varfër, 120 mijë qytetarë jetojnë me nga 68 centë në ditë. Pyetja ime kishte me qenë për kryeministrin: çfarë do të bëni për këta qytetarë? Këta s’kanë kohë t’i presin programet e implementimit, çfarë do të bëni me buxhetin? A do ta rrisni edhe një herë këtë 68 centin për ta rritur së paku edhe 100%, prapë nuk sigurohet jetë me dinjitet. Do ta pyesja kryeministrin që përmendi pensionet. Kemi mijëra pensionistë që jetojnë me nga 75 euro në muaj. Nuk jetohet me 75 euro, s’kanë mundësi t’i sigurojnë barnat, flet për reformim të sistemit të pensioneve, cila është ideja për reformimin e pensioneve?

Ne i kemi dhënë si Lëvizje “Vetëvendosje” disa herë qëndrimet tona, kemi treguar që jemi për një sistem krejt tjetër, i cili fillon me solidaritetin mes gjeneratave, i cili siguron të ardhura menjëherë që pensionistët të jetojnë, të kenë vërtet një jetë të dinjitetshme. Me

këto pensione, si këto 75 eurove, si të tjerat, nuk ka jetë të dinjitetshme në Kosovë. Pastaj, po vazhdoj prapë me pjesën tjetër: “Qeveria do të kontribuojë në zvogëlimin e numrit të familjeve me asistencë sociale”. Unë kisha për ta informuar së pari kryeministrin që qeveria e kaluar e ka zvogëluar numrin e atyre që marrin asistencë sociale, e ka zvogëluar duke i larguar padrejtësisht nga skemat sociale. E ka zvogëluar edhe numrin e pensioneve invalide, si i ka zvogëluar? Ka hequr nga kjo listë qytetarët, të cilët për 30 vjet me radhë kanë marrë pensione invaliditeti dhe pa pritë e pa kujtuar në atë kohë ata u shëruan, qysh po thotë kolegu i nderuar, pas 30 vjetësh edhe i la pa pensione, i la pa bukë njerëzit që kanë marrë pensione për 30 vjet me radhë.

Unë do ta kisha pyetur, qysh do ta rregullosh këtë çështje? A do t’i kthesh në listat e pensioneve ata qytetarë që sot nuk marrin pensione që janë larguar padrejtësisht? Unë mund t’jua them me emra disa prej tyre që vërtet janë invalidë dekada me radhë që kanë mbërritur moshën 60-vjeçare dhe gati në përfundim të moshës, domethënë kohën kur vijnë për pension, u janë ndaluar pensionet, ndërsa ne nuk kemi kurrfarë zgjidhje. Nga këta rreshta që kemi këtu te parimet e kryeministrit për çështje sociale shihet qartë që thjesht s’ka, domethënë mungon edhe baza më e vogël për t’i trajtuar çështjet sociale. Nuk trajtohen kështu çështjet sociale, çështjet sociale trajtohen më së miri me politikën zhvillimore. Lufta më e mirë për zvogëlimin e varfërisë është zhvillimi ekonomik, nuk kemi zhvillim ekonomik, nuk kemi as përpjekje për zhvillim ekonomik.

Unë drejt të them më me dëshirë do të flisja duke pas parasysh që edhe qeverisja e tashme nuk besoj që qëndron gjatë kështu, për shkak se është qeverisje e pakicës, edhe qeverisja në Ferizaj do të shkojë së shpejti. Me shumë dëshirë do të flisja për programin qeverisës të Lëvizjes “Vetëvendosje” për qytetin e Ferizajt, meqë në këtë Kuvend u diskutua gjithçka dhe për tema të ndryshme, nëse më lejohet unë do të vazhdoja me çështjet që kanë të bëjnë pjesërisht me Ferizajn. Ne kemi 31 zotime që kapin 12 fusha të qeverisjes lokale dhe qëllimin, respektivisht fokusin e kemi vënë te shëndetësia, që e përmendët edhe ju, te shëndetësia, tek arsimit, të cilin e keni degraduar dhe tek ambienti ku jetojmë, pra tek urbanizmi.

Por, meqë nuk po dua që ta keqpërdor këtë foltore dhe meqë nuk po dua të bëhem sikur ju që flisni, kemi rend të caktuar të ditës dhe flisni për gjithçka, po e përfundoj me kaq dhe me të vërtetë dua ta them që jam shumë i zhgënjyer. Asnjëherë s’e kam ndier veten më keq si deputet i Kuvendit të Kosovës. Vërtet po e ndiej veten keq, për arsye se me një gjuhë kaq të degraduar, me akuza kaq të liga, me sulme personale, kështu nuk zhvillohet demokracia. E keni gjetur vendin, e keni krijuar Kuvendin në një vend të akuzave personale, po e keqpërdorni foltoren e këtij Kuvendi për të bërë tema të ndryshme, të cilat s’i takojnë kësaj mbledhje. Nuk po i dëgjoni deputetët, qeveria nuk po e kryen detyrën që i takon, ju si deputetë po e shihni, salla është gati e zbrazët, shumica e deputetëve të

Lëvizjes “Vetëvendosje” janë këtu, por të tjerët nuk janë. E di që janë në fushatë, uroj dhe shpresoj që e ardhmja të jetë më e mirë, uroj që ne megjithatë si Kuvend ta gjejmë një gjuhë të përbashkët, ku së paku rrokemi për tema, sepse ka mjaft mundësi që të merremi me tema konkrete, me tema, të cilat i preokupojnë qytetarët e Kosovës. Kryetari i Kuvendit vetëm e bëri një rafal, jo SHIK-u, e SHIK-u e tërë kohën SHIK-u, dhe iku nga Kuvendi, ia la zëvendësit të tij drejtimin e këtij Kuvendi. Mendoj që nuk është kjo rruga që duhet të ndjekim, duhet të merremi me tema konkrete, me tema sociale, me tema të cilat i preokupojnë qytetarët e Kosovës, me temën e varfërisë, me të gjitha temat e tjera, të cilat janë vërtet problem kryesor i vendit tonë.

Me këto tema nuk është marrë as qeveria e kaluar, në këtë program qeverisës, respektivisht me këto parime që ne i kemi këtu shihet që po, nuk ka gatishmëri për t’u marrë prapë me temat kryesore me të cilat ne preokupohemi. Do të kisha dashur shumë që kryeministri të ishte këtu, të diskutojmë së bashku, t’i shtrojmë pyetjet, por ai iku, shkoi për të punuar, e neve na la thjesht kështu. Pra, detyrë e kryeministrit është që ta kryejë detyrën, të qëndrojë në Kuvend. Në Ferizaj do të shkoj posa ta përfundoj mbledhjen e Kuvendit dhe natyrisht që Ferizaj ka jashtëzakonisht shumë probleme, të cilat duhet t’i zgjidhë. Ju jeni shkaktarë të këtyre problemeve që i ka Ferizaj, edhe si Parti Demokratike, edhe si Lidhje Demokratike e Kosovës, jeni shkaktarë kryesorë të shkatërrimit të urbanizmit, të shkatërrimit të shëndetësisë dhe pastaj jam i bindur që më 22 tetor qytetarët e Ferizajt, përkundër dëshirës suaj, do t’i japin fund të kaluarës dhe do të vendosin për një të ardhme, kanë një shembull të mirë të Prishtinës, të cilën ju e kundërshtuat, e qytetarët e Prishtinës e dinë shumë mirë se si ka ndryshuar Prishtina gjatë këtyre 4 vjetëve të fundit.

Faleminderit! Mirupafshim në mbledhjet e ardhshme të Kuvendit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe ty, rruga e mbarë për Ferizaj. Fjalën e ka Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë!

Qytetarë të Republikës,

Veç te ne ndodh që Qeveria që pretendon se e ka shumicën parlamentare ta lëshojë sallën e Parlamentit. Është për keqardhje që Qeveria e Kosovës, pas një muaji bojkoti, vetë e 40-ta s’guxon të përballet me shumicën e qytetarëve në Parlament. Kjo është precedent i ri në historinë tonë parlamentare, siç është precedent i ri edhe ndërprerja e debatit në formimin e qeverisë.

Fjalimet e deritanishme të shumicës parlamentare është se ne duam debat, por duam sipas rregullës sonë. Pra, mos flisni kështu, mos flisni ashtu, flisni çfarë kemi dëshirë ne të

dëgjojmë. Tash neve na është prezantuar një dokument 12-faqesh me titull “Parimet e Qeverisë”, nga një grup politik që s’ka lënë parim pa thyer për t’u bërë bashkë. Dokumenti 12-faqesh është pa substancë, është i thatë dhe singlerisht është vështirë të komentohet mbi një dokument të thatë. Dokumenti i tillë do të duhej të jetë shkruar nga një grup studentësh nën mesatarë, pa përvojë, pa ide e pa bosht të mendimit, apo thënë ndryshe, nga një grup ministrash të kësaj qeverie, të cilët aksidentalisht ulen sot në karriget ministrore.

Thënë të drejtën, nuk është se pritej ndryshe, partitë e bëra bashkë pa kurrfarë parimi, të zëna me kërcënime e pazare të minutave të fundit, nuk është se kanë pasur kohë të merren me ide. Në tavolinën e tyre gjithmonë ka qenë hisja që secili duhet ta marrë dhe sado që na prezantohen dokumente të tilla boshe e të thata, ato s’duhet të mbulojnë të vërtetën e vetme rreth natyrës në të cilën është nisur kjo Qeveri dhe nga kjo nisje burojnë dhe problemet e ardhshme të Kosovës. Dhe, janë tri shtylla, tri të vërteta, secila më e paqëndrueshme se tjetra, secila më e trishtueshme se tjetra, që e karakterizojnë nisjen dhe kompozicionin e kësaj qeverisje.

Shtylla e parë, dhe më e rëndësishmja, është se në fundament të kësaj qeverie është kontrabanda. Mos harroni, votat e deputetëve dhe qytetarëve janë shitur, votat e deputetëve janë blerë dhe në këtë shitblerje janë shpërfaqur edhe ndërmjetësues dhe tregtarë votash sekserë. Të njëjtëve, si shpërblim për punën e bërë u është premtuar një ulëse në këtë Parlament. Kjo ulëse këtu është shpërblësë për tenderë, është pagesë për punën e bërë. Sikur ky vend të kishte hetuesi e prokurori, vendi i të tillëve nuk do të ishte në Parlament, por në bankat e gjykatave.

Shtylla e dytë, jo më pak e rëndësishme, është se ju nuk jeni bërë bashkë rreth një programi, rreth një ideje, pra republikane të Kosovës. Ju jeni bërë rreth tepsisë së parasë së pushtetit, ju s’keni folur asnjëherë deri më sot për ide, asnjëherë. Folët gjithherë për numrin e ministrive kush sa ka për të marrë, numrin e zëvendësministrave, ambasadorëve dhe kur ministrinë nuk ju dolën, ndonëse ishin shumë ashtu-kështu, në radhë të parë, ju i krijuat të reja. Zbuluat poste komike, absurde, përsëritëse për të vetmin qëllim që secilit t’i krijoni një hise. Madje, u treguat me aq apetit sa që në tavolinë vendosët edhe postin e Presidentit dhe po ju them prej këtu që aq larg s’do të mbërrini. Por, ju keni arritur të bëni një gjë: ta ndërtoni modelin më të pamoralshëm politik në vend. Ju i keni dhënë shembull mijëra të ri dhe të rejave që sot na shikojnë këtu, se mashtrimi, rrena, thyerja e parimeve është krejt në rregull, përderisa e merr një karrige, është pazar i mirë.

Ju jeni arsyeja pse ky Parlament është parë dhe shihet si cirk, e politika si biznes pa moral dhe pa kurriz, sepse të tillë e keni trajtuar politikën, si biznes, kush po bën pazar më të mirë me ministri, kush po merr më shumë me më pak deputetë.

Shtylla e tretë, dhe jo më pak e rëndësishme se dy të parat, është se ju përkundër kontrabandës, edhe përkundër që i thytet të gjitha parimet, nuk arritët të bëni shumicë qytetare në vend, jo vetëm shqiptare, qytetare. Ju arritët të bëni shumicë parlamentare, por jo qytetare. Dhe, për këtë ju është dashur të mbështeteni në vullnetin e Aleksandër Vuçiq në Beograd, të artikuluar nëpërmjet Listës serbe në Prishtinë e të negociuar, besoni ose jo, nga Presidenti i Republikës së Kosovës në Bruksel.

A ka diçka më jokushtetuese e më jopatriotike se sa bekimi i një shteti fqinj armiqësor për qeverisjen e vendit tonë? Dhe, siç u pa në seancë e parë, të cilës po i referoheni shpesh, as punimet e këtij Parlamenti s'mund t'i nisim pa një bekim të tillë dhe siç u pa nga vizita e parë zyrtare e një pjese të qeverisë, ky autoritet tash shkon edhe në Moskë, përtej Beogradit dhe ju tash duhet të pyesni për secilin mëngjes se çfarë plani e vullneti ka Beogradi për Kosovën, sepse s'mund ta shkarkoni as Rikallon, duhet të tërhiqni ftesën prej Interpolit atje, e si të dihet çfarë pazuresh të tjera ka në tavolinën negociuese me ta. Kjo është rreziku i republikës, ky është rreziku i Kosovës. Ju mund të konsideroni se keni fituar, e keni bërë një shumicë, një qeveri, po shihni pak përreth, shihni çfarë lëmshi keni bërë. Kush mund të qeverisë kështu? Ku është Qeveria?

21 ministri, 22 parti, 6 zëvendësministra e veç 60 deputetë. Qendra vendimmarrëse gjithandej, 4-5 kryeministra brenda jush, një në Beograd dhe Hashimi, natyrisht bashkë me ta. Ju jeni të ngrysur dhe të dëshpëruar, po shihet, këto s'janë fytyra të fitores, mos bëni hajgare, sepse e dini se çfarëdo që keni bërë, është akti juaj i fundit në politikë, kaq e keni pasur, kaq keni mundur të bëni dhe si i tillë ai do të jetë dhe do të përkujdesemi të jetë i shkurtë. Prandaj prej këtu i ftoj kolegët deputetë që të bëhemi bashkë dhe me qytetarë dhe të nisim obligimin tonë patriotik, obligimi patriotik yni është të ndalim dhe të ndërprejmë këtë rrugëtim të kësaj Frankenshtajn qeverisje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Së pari, po më befasojnë ish-deputetët e rinj, apo ish "analistët" që ishin vazalë të subjekteve të caktuara politike, dhe kjo u pa kur erdhën zgjedhjet. Dikush u bë deputet se i ra numri, si Dritonit, ia pa hajrin numrit, por nëse vazhdon me këtë avaz, jam shumë optimist që s'mund të bëhet më deputet. Ne sot jemi me një rend dite që e kisha lutur zotin Hoti se ndoshta ka qenë më mirë të hiqet, po shihet se këtu deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mungesë të punës në terren, ne e dimë që jemi në fushatë zgjedhore elektorale, janë zgjedhjet lokale dhe po shihet që shumica e deputetëve nuk qenkan të kyçur në fushata dhe janë duke shfrytëzuar këtë foltore jo të flasin për

programin e Qeverisë, edhe pse s'ka kuptim të flasim sot, se është dashur të flitet më 9 shtator, kur është zgjedhur Qeveria, por sot po vijmë po humbim kohë. Dikush flet si Fatoni për Ferizaj, ka mundësi të shkojë të flasë atje me qytetarët e Ferizajt. Unë si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës konsideroj që deputetët, të cilët janë kandidatë për kryetarë të komunave është dashur të japin dorëheqje e të shkojnë atje ta bëjnë garën, nuk është e ndershme ende pa e futur në funksion votën e 11 qershorit të vijmë tash e të kërkojnë votë këtu për zgjedhje lokale. Flas për të gjitha subjektet, nëse mendojnë që kemi kuadro dhe duam t'i shërbejmë vendit.

Ky debat, i cili është thirrur sot nga zoti Hoti dhe të tjerët që e kanë nënshkruar këtë peticion, është dashur të bëhet më 9 shtator. "Vetëvendosja" atëherë dhe Lidhja Demokratike kërkuan debat, ne thamë që duam të bëjmë debat, e aprovuam debatin, por ata e tërhoqën debatin. Arsyet ne i dimë, ndoshta ne ua aprovuam pak me vonesë, por është dashur të kenë durim, të presin, se asnjë kuptim nuk ka sot të flasim për këtë program, derisa ende nuk i ka bërë Qeveria Haradinaj 2 javë qeverisje. Ne duhet ta presim 100-ditëshin e parë, 3-mujorin e dytë, t'i shikojmë a po realizohen këto objektiva? Nëse lexohet programi, është program i mirë, normal që edhe vetë qeveria gjatë rrugës do t'i shohë plotësim-ndryshimet dhe nuk është mirë ne këtu t'u humbim kohë qytetarëve e të flasim për interesa personale, të krijojmë standarde jo të mira, të fyhemi personalisht, si zoti Selmanaj thotë "jo, SHIK-u, Partia Demokratike, u dobësua SHIK-u", nuk është temë këtu. Atëherë në bazë të kësaj na del që zoti Selmanaj po ka dëshirë të forcohet UDB-a në Kosovë, nëse e marrim, ne mund të flasim personalisht, po nuk është mirë t'i ngarkojmë qytetarët.

Mund të kërkohet debat, mediat publike, secili mund të dalë me secilin nëse kemi diçka personale të sqarojmë. Këtu e kemi marrë besimin e qytetarëve për t'i përfaqësuar ata, por ata nuk na e kanë dhënë besimin të sillemi në këtë formë, as të bëjmë sjellje të pahijshme duke u rrahur nëpër studio, por na e kanë dhënë besimin t'i përfaqësojmë, të bëjmë ligje më të mira, të jemi zë i mirë dhe t'ua lehtësojmë jetën. Kanë shumë halle qytetarët tonë. Unë pajtohem me disa parafolës, jemi i vetmi vend që e kemi të mohuar të drejtën e lëvizjes që është e garantuar edhe me konventa ndërkombëtare, kur i gjithë rajoni e gëzon këtë të drejtë.

Fajet nuk i ka populli, por fajet i kemi ne si deputetë, fajet i kanë institucionet, sepse nuk po punojmë për qytetarët, por po shesim mend dhe pallavra këtu para qytetarëve nëpërmjet mediave. Unë them që programi i Qeverisë, i zotit Haradinaj është ndarë në katër shtylla kryesore: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, integrimi euro-atlantik dhe zhvillimi sektorial. Këto katër shtylla, nëse e keni lexuar programin, por këtu po shihet që shumica nuk e kanë lexuar programin qeverisës, po kanë pasur dëshirë të vijmë e të bisedojmë këtu ose të duken që po bisedojmë para qytetarëve, janë të hartuara

mirë dhe nëse implementohen nga Qeveria, qytetarët e Kosovës do ta kenë një jetë më të mirë.

Ne duhet ta kontrollojmë qeverinë në zbatimin e këtij programi, kemi mundur atë ditë të flasim, më 9 shtator, por s'keni ardhur të flisni as më 10 shtator. Edhe sot nëse del shumica, prapë nuk e keni kuorumin, se s'jeni këtu as "Vetëvendosja", as LDK-ja, as gjysma e deputetëve. Është mirë kur të thërrisni debat, të vini të paktën ju dhe të debatojmë për atë çka i keni thirrur deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Te sundimi i ligjit të gjithë jemi të vetëdijshëm që kemi nevojë për një plotësim-ndryshim të infrastrukturës ligjore, apo ta them ndryshe, për një avancim të strukturës ligjore në këtë drejtim. Ne duhet të kemi gjithë ata njerëz, të cilët këtu flasin ose akuzojnë, është mirë të ballafaqohen me ligjin, i kemi prokuroritë, i kemi gjykatat, por edhe ato duhet të jenë më funksionale, më efikase. Kemi mbledhje të lëndëve nga 5 vjet, nga 7 vjet dhe ato nuk kanë kuptim, ndoshta penalet, për penale nuk bëhet vonë, por kur flasim për lëndë civile ka plot ndërmarrës, të cilët ndoshta padrejtësisht kanë konteste civile, gjykatat ua ndalin lëndët nga 5 vjet, edhe nëse atëherë fitojnë, se iu ka bërë padia ose ndalesë padrejtësisht, nuk ka kuptim biznesi i tij, sepse e ka shkatërruar biznesin, i ka humbur punët, e ka humbur numrin e punëtorëve dhe ai është i falimentuar. Ne duhet të kërkojmë nga gjyqtarët, në këtë rast, jo të përziejmë pushtetet, se pushtetet janë të ndara, por të shikojmë a po zbatohet infrastruktura ligjore? Nëse nëpërmjet ministrit të Drejtësisë ka mungesë të vogël të prokurorëve, gjyqtarëve, ta rritim numrin e tyre, t'ua rritim buxhetin, t'ua rritim infrastrukturën që ata ta kryejnë punën e vet në interes të qytetarëve të vendit. Nuk është mirë, edhe një herë po e përsëris, nuk është mirë t'u humbim kohë qytetarëve këtu me zgjedhje lokale, por është mirë të kryejmë punën tonë. Ne ende nuk kemi arritur, ne ende e kemi seancën e ardhshme, ku do t'i formojmë trupat e Kuvendit, të formohen komisionet dhe nëpërmjet komisioneve ta kryejmë punën tonë profesionalisht dhe të ecim përpara.

Unë edhe një herë kërkoj që të mos e fyejmë njëri-tjetrin. Unë flas si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, as nuk do ta fyej kërkon në fillim, por as nuk do ta tolerojmë askënd. Ne shohim disa njerëz këtu, shesin mend, shesin patriotizëm, shesin trimëri, çdo kohë e ka etapën e vet apo çdo proces e ka kohën e vetë. Ka qenë koha kur ne kemi mundur të kryejmë punën, me shekuj shqiptarët kanë dhënë kontribut në këtë vend, falë brezave ne sot e kemi edhe këtë Parlament, andaj të mos e njollosim, ta avancojmë, ta integrojmë këtë vend, ta zhvillojmë këtë vend, ka nevojë qyteti, ka nevojë populli i Kosovës për krijimin e vendeve të reja të punës, ka nevojë për mirëqenies sociale më të mirë, për arsim më të mirë, për avancimin e rinisë, kulturës, sportit, për të gjitha sektorët t'i avancojmë dhe të ecim përpara.

Unë nuk dua t'jua marr kohën më këtu, por kërkoj prej juve që ta tërhiqni këtë debat sot, se s'ka kuptim. Ky debat ka pasur kuptim më 9 shtator, e ripërsëris, më 9 shtator. Keni kërkuar të tërhiqet, ju kemi ndihmuar, e kemi tërhequr, edhe shumica këtu bëhet me numra, ata që e kanë pasur shumicën e kanë zgjedhur qeverinë. Qeverisë i urojmë suksese dhe është mirë opozita të jetë konstruktive, të përkrahë zhvillimin ekonomik të këtij vendi, ka zgjedhje prapë, nëse ofrojnë program më të mirë, ndoshta qytetarëve mund t'ua ndërrojnë mendjen. Por, me këtë avaz më 22 tetor, tash po bëj edhe unë si zoti Topalli, do të shihemi se zgjedhjet e 11 qershorit, ata të cilët kanë marrë vota kundër, nuk do t'i marrin më, se s'kanë program. Po shihet fytyra e tyre, po përzihen edhe në shtete mike që kanë ndihmuar këtë vend, e kanë ndihmuar lirinë e këtij vendi, në vend se të përzihen në komuna të veta atje ku përfaqësojnë programet e veta. Patëm rastin, që ishte shumë qesharak, jo për ne si deputetë dhe për institucionet, por ishte qesharake edhe për qytetarët kur një subjekt këtu përzihet e thotë ta votojmë të majtën në Gjermani. Ndoshta nesër del në Rusi, apo del diku tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuar deputetë,

Ne sot po flasim për programin qeverisës të Kosovës, në fakt, ne ende po vazhdojmë të flasim për parimet, sepse ende s'po mund të pranojmë se qeveria ka bërë një program dhe se tema e parimeve është një temë e kaluar.

S'po e kuptoj dhe s'po mund ta kuptoj cila është esenca e debatit sot, sepse asnjë këtë program qeverisës që e ka sjellë Qeveria e Kosovës nuk po e debatojmë në pika, në mënyrë që të japim kontributin se ku janë të metat e këtij debati. Në fakt, këtu po shohim se kemi shumë patriotë dhe patriotë të veve, patriotë të kompirave dhe po merren me figurën patriotike të zotit Haradinaj. E di se shumë, të gjithë këtu do të kishim dëshiruar të jemi Ramush Haradinaj dhe ta kishim biografinë e Ramushit, por më vjen keq, historia nuk përsëritet dhe nuk mund të ketë më Ramush Haradinaj, nuk mund të bëhet njeriu Ramush duke gjuajtur ve, duke gjuajtur molotov. Ka qenë koha e patriotizmit dhe kush ka dashur ta dëshmojë patriotizmin ka mundur ta dëshmojë. Po merreni shumë me minoritetet. Kjo është një kategori kushtetuese. Po, ne kemi deputetë që janë në partitë tona shqiptare dhe janë gjysmë minoritete dhe, nëse u pëlqejnë aq shumë minoritetet, ata mund të shkojnë edhe në parti të minoriteteve, është e drejtë e tyre, nuk mund t'ua kontestojmë.

Unë e di që për shumë deputetë, është me fat dhe kemi qenë me fat, vërtet deputetë të mirëfilltë që kemi pasur fatin ta votojmë një kryeministër si zoti Ramush Haradinaj. Është nder për vendin që e kemi një kryeministër si Ramush Haradinaj.

Driton Selmanaj, i cili sot s'është këtu, tha deri dje se Ramushi ishte i mirë, s'po mund ta kuptoj, dhe tash kur Ramushi është kryeministër, thotë se nuk është i mirë. Driton, Ramushi është Ramush, si dje, si sot, edhe nesër do të jetë, nuk mund të ndryshojë. Ndërsa, shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se s'do t'i votojmë të gjitha ato projekte dhe investime që do të vijnë nga jashtë. Harroi zoti Avdullah Hoti që të hidhëruar në atë kohë që zoti Haradinaj ishte në Kolmar i ndalur, ne nuk e kemi votuar një projekt dhe nga Kolmari, zoti Haradinaj na ka ftuar që ta votojmë atë projekt, në mënyrë që ai projekt të kalojë, sepse është në të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa, ne po vazhdojmë të merremi, siç është ajo thënia popullore: “Qe arusha, dikush ka thënë qe fërkemi”. Lërimi more fërkemin, qe arusha. Programi ka ardhur, leni parimet, s'po di pse po ndalemi ende në këtë. E di që është fushatë dhe po ju konvenon ta vazhdoni këtë debat, por vërtet është i pakuptimtë vazhdimi i këtij debati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

Unë dëgjova këtu, siç dëgjuam ne të gjithë, shfryrje të ndryshme emocionale, politike, patriotike, të gjithfarshme. Pak dëgjuam për programin, pak dëgjuam për parime, pak dëgjuam edhe për programin legjislativ të kësaj Qeverie.

Vërtet unë kam bërë përpjekje të koncentrohem veç në këto tri çështje dhe natyrisht me shqetësim për parlamentarizmin kosovar, ky që është.

Unë kam bërë përpjekje t'i lexoj me vëmendje edhe parimet e qeverisjes, edhe programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe programin legjislativ që e kanë dërguar, për këtë vit së paku. Nga ajo që mund të konstatohet, prej krejt këtyre tri dokumenteve, unë do të fokusohem vetëm në tri fusha, edhe pse natyrisht do të dëshiroja që këtu të jetë Qeveria, ose së paku ministrat e atyre resorëve, edhe kryeministri, po s'janë. Kjo është parlamentarizmi në Kosovë, kjo është republika parlamentare, sido që të jetë, ne do të vazhdojmë kështu.

Më së pari te drejtësia po kaloj, aty ku e ndjej veten pak më mirë. Në këto tekste, të tri tekstet që i përmenda, kemi fjali të përsëritura tani e 17 vjet nga të gjitha qeveritë. Për shembull: “Qeveria e Kosovës do të garantojë se askush nuk do të jetë mbi ligjin”, apo “Para ligjit të gjithë do të jenë të barabartë”, e fjali të ngjashme. Domethënë, këto janë vërtet do farë broçkullash demagogjike, premtime të gënjeshtërtë, se qe 17-18 vjet kemi parë se në të vërtetë krejt këto premtime të tilla e kanë degraduar drejtësinë në atë masë

sa këtu konstatohet nga të gjithë, se në të vërtetë ne nuk kemi drejtësi. Gjithçka kemi, po vetëm drejtësi nuk kemi.

Këto premtime të gënjeshtërtë kanë pasur pasoja shkatërrimtare edhe për shoqërinë, edhe për shtetin, edhe krejt bota na e zë për të madhe: “Ju keni gjithçka, po drejtësi nuk keni”.

Në këto tri tekste nuk ka asnjë fjalë të vetme për veprime konkrete për arritjen e qëllimit, domethënë përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, asnjë fjalë të vetme. Asnjë fjalë të vetme se si do të veprohet me 400 000 lëndë që presin të zgjidhen nëpër gjykatat e Kosovës dhe një 150 000 në prokuroritë e Kosovës, asnjë fjalë të vetme për lëndët që parashkruhen. Qytetari e dorëzon lëndën në gjykatë për t’i ikur konfliktit personal, sepse e ka një konflikt. Gjykatat tona e lënë të parashkruhet, domethënë edhe shkaktojnë vrasje të njerëzve, siç ka ngjarë në Kosovë, për shkak se gjykatat nuk kanë vepruar, sepse ato janë të kriminalizuara. Nuk ka asnjë fjalë të vetme se si do të hiqen këto gjëra, çka do të bëhet konkretisht.

Pjesa e vetme ku mund të nuhatet diçka e përafërt me një përpjekje për veprim konkret është kur thotë: “Rishikimi i plotë i sektorit të sundimit të ligjit...” Njeriu mendon, eh, këtu do të ketë dhe e lexon çfarë të ketë në të konkretisht, thotë: “Rishikimi i tërë infrastrukturës ligjore...” edhe e sheh programin legjislativ, s’ka kurrëgjë hijë.

Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve. Po s’ka nevojë t’i vlerësojë kapacitetet e institucioneve, është gjendja e keqe, kriminale. Edhe trajtimi në mënyrë të veçantë i kapaciteteve institucionale, edhe krejt kjo në një periudhë 2017/2021, po s’ka kërkesë, ose veprim konkret “do ta bëjmë kështu, ...do të rritim buxhet, ose do të shkurtojmë buxhet, do të rritim numër të prokurorëve, ose gjyqtarëve, ose diçka...”, kjo është punë konkrete.

Natyrisht, ka vetëm premtim për rishikim, asgjë tjetër. Mirëpo, duhet ta keni parasysh, edhe në programin legjislativ e kam vërejtur, Kosova nuk vuan nga mungesa e ligjeve, i ka do ligje, të mira, të këqija, personale a politike, nuk është me rëndësi, Kosova vuan nga moszbatimi i ligjit! Asnjë fjalë e vetme në programin qeveritar, në parimet apo diku, si do të zbatohet ligji? Ky është problemi i Kosovës. Kemi aty veprime konkrete, ose fjalë konkrete: “Rritja e sigurisë fizike për gjykatësit dhe prokurorët, duke i mbrojtur ata me, gjoja, truproja”. Po, kë po e ruan? Ata që e kanë sjellë në këtë gjendje drejtësinë? Kjo është ruajtje e krimit të organizuar, e gjykatësve dhe e prokurorëve që sot punojnë me direktiva politike. Kjo do të thotë edhe disa njerëz shtesë t’i punësosh, domethënë t’i rehatosh disa dosta. Po, kjo nuk ka të bëjë asgjë me përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Ata duhet të ruhen, prokurorët dhe gjykatësit, kur marrin vendime për ta mbrojtur këtë sistem.

Qeveria nuk garanton as të drejtat dhe liritë e njeriut, as nuk mund t'i garantojë, se ato i garanton Kushtetuta. Qeveria atë që mund ta bëjë është t'i sigurojë, t'i mbrojë dhe t'i respektojë ato të drejta dhe liri të njeriut. E ato bëhen vetëm me shtetin e mirëfilltë ligjor. E ky program nuk e ka për synim.

Sa për luftimin e krimit të organizuar, ne kemi marrë porosinë e parë prej vetë ministrit të Drejtësisë që është emëruar, qysh në paraqitjen e parë publike ka garantuar se do ta forcojë krimin e organizuar. Këtë e ka bërë me një shkrim të vetin, bile s'ka kërkuar falje, e ka përmirësuar ndoshta, po s'ka kërkuar falje ende dhe kjo është e keqja.

Po mirë, atëherë nëse pajtohen, kështu po e lëmë. Faleminderit!

Te dialogu, ne kemi një premtim në të dy dokumentet për dialogun. Mirëpo, ky dialogu nuk ka asnjë fjalë të vetme, as për drejtimin, as për kahun e dialogut. A do të bëhet ende dialog me Serbinë për çështjet e brendshme të Kosovës? Kjo është çështja interesante që nuk është thënë. Asnjë fjalë në këtë dialog për pasojat e dialogut të mëhershëm. Çfarë ka ngjarë me dialogun e mëhershëm? Ne e dimë se është bërë decentralizimi, janë krijuar mini-entitetet serbe në Kosovë, në bazë të tyre tash kërkohet krijimi i "Zajednicës", ajo është penguar dhe në fund krijimi i një entiteti të vetëm serb në Kosovë, që synon bosnjëzimin. Asnjë fjalë e vetme për të pagjeturit dhe të zhdukurit në Kosovë. Sot e kësaj dite 1600 familje në Kosovë presin me vaj në buzë dhe pa gjumë, dihet për fatin, asnjë fjalë e vetme nëse do të hapet kjo temë në dialogun me Serbinë. Ne e dimë, shprehimisht Serbia i mban njerëzit e pagjetur dhe të zhdukur nga Kosova, nga lufta e Kosovës dhe s'guxojnë ta hapin këtë temë. Çka domethënë kjo? Nga forcat zyrtare ushtarake, policore dhe paramilitare të shtetit të Serbisë, me të cilin po bëhet dialog.

Asnjë fjalë e vetme për vjedhjen e Fondit pensional të pensionistëve kosovarë nga shteti serb, megjithëse ka një vendim të qartë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se kjo vjedhje është e padrejtë dhe duhet të kthehet. Kjo është një e drejtë që ta jep Gjykata Evropiane për qytetarët tuaj, kurse në këtë dialog nuk ka asnjë fjalë. Thuhet këtu: "Dialogu me Serbinë është i paalternativë". Jo, bre, një dialog për fqinjësi të mirë është i domosdoshëm, ama mbi parimin e reciprocitetit, por jo për çështje të brendshme të Kosovës, siç janë duke bërë tani e siç i kanë bërë deri më tani. Prandaj, është kundërshtuar me të drejtë. Jo dialog për ndarjen e Kosovës, as për bosnjëzimin e Kosovës, po për çështjet reciproke që i ndajnë dy fqinjë. Ata nuk duan të pranojnë fqinjësi, ata thonë: "Kosova është pjesë jona".

Te diaspora, po del pjesa e fundit, e tërë pjesa e programit qeverisës nuk asgjë të vetme për mërgatën, asnjë fjalë. Tani e kanë emërtuar veç "diasporë". Asnjë fjalë të vetme, bile as përparime të përgjithshme. Edhe kjo është çështje, qasja e kësaj Qeverie ndaj

mërgatës, është një qasje e sinqertë. Në të vërtetë, kjo mërgata konsiderohet veç për ta mjelë, asgjë tjetër, po asnjë fjalë të vetme, diçka konkrete!

Natyrisht kërkohet, ndoshta diku në mendje, angazhimi i mërgatës, mjetet t'ua marrë, e megjithatë kjo mërgatë e ka mbajtur Kosovën, edhe në shekullin e kaluar, edhe tash, gjallë. Ia ka mbajtur shpirtin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Haradinaj shkoi, tha: “Ju debatoni, e unë po shkoj të punoj”. Nuk besoj se ai bën punë tjetër. Puna e zotit Haradinaj është e ngjashme me punën tonë. Nuk po besoj se ai sot e ka kapur kazmën për të bërë punë fizike. Ndjej keqardhje të thellë, që ai sot nuk është këtu dhe thirrja e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së për mosvotimin e IPO-s nuk është as shantazh, as asgjë tjetër. Kryeministri duhet të na respektojë si deputetë, nuk mund të na respektojë vetëm atëherë kur i duhen votat. Kështu që, nëse ai nuk është prezent për të respektuar vërejtjet që i kemi, atëherë është problem që të llogarisë në votat tona. Ju e dini shumë mirë që asnjë nismë legislative, e cila kërkon 80 vota nuk mund t'i bëni asnjëherë, bile edhe ato me 61 do ta keni shumë problem.

Sot po diskutojmë për parimet. Në dokumentin e parimeve thuhet që kryeministri do ta luftojë korrupsionin pa kompromis. Kryeministri një të tretën e kabinetit e ka me njerëz që kanë probleme me ligjin. Është shumë problem një ministër ta luftojë korrupsionin brenda ministrisë së vet në qoftë se i njëjti dyshohet për korrupsion, pavarësisht prezumimit të pafajësisë. Kryeministri a dikush tjetër nga AAK-ja, më duket zoti Ahmet Isufi, tha që kryeministri po punon shumë, e ka zgjidhur çështjen e Shipitullës dhe e ka zgjidhur çështjen e veteranëve. Unë ju sfidoj, juve këtu, deputetë të pozitës që po e mbron kryeministrin, më tregoni në bazë të cilit ligj, në bazë të cilës rregullore kryeministri shkon dhe merret me shpronësimet.

Janë dy ministri, është Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe është Ministria e Financave, Departamenti i Shpronësimeve, të cilat merren me shpronësimet. Kryeministri nuk ka asnjë të drejtë ligjore dhe kushtetuese të kalojë dhe të marrë vendime teknike e të shkojë e të negociojë me banorët. Kryeministri duhet ta bëjë publike marrëveshjen që e ka me qytetarët e Shipitullës. Janë tri vlerësime, që Departamenti i Shpronësimeve i ka bërë.

Te çështja e veteranëve, i keni gjetur mjetet. Pyetja është, a e ka respektuar kryeministri dhe ministri i Financave Ligjin për plotësim dhe ndryshim të veteranëve, i cili thotë: “Buxheti për pagesën e pensionit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk duhet ta kalojë 0,7 të GDP-së për një vit”. Këto janë parime që po shkelen dhe sot po të ishte këtu kryeministri, ndoshta do ta kishte ditur që ai pikërisht po i shkel parimet e veta të vëna para tri javësh.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e koalicionit të 22 partive është qeveria e parë e cila po varet prej Beogradit. Po ju dhemb shumë, por kjo është e vërteta. Tani, kjo qeveri është formuar, sepse në fillim të këtij viti, ju kujtohet të gjithëve, Kadri Veseli doli me “turnin dëgjimor”. Ai mbajti dhjetëra takime me qytetarë dhe biznese dhe u premtoi atyre se sikur ai të bëhet kryeministër të gjitha problemet e tyre do t’i zgjidhë. Dhe, çfarë ndodhi? Ai faktikisht, nuk e pati guximin as t’i hyjë garës për kryeministër dhe këtë post e dorëzoi te zoti Haradinaj. Po, zoti Haradinaj sot nuk është bërë kryeministër sepse i ka fituar votat. Ai është bërë kryeministër sepse e ka votuar Lista serbe dhe sikur vetëm një deputet i kësaj liste të mos e votonte, ai sot nuk do të ishte kryeministër.

Ne e kemi thënë sa herë që kjo qeveri është kombinimi më i keq i mundshëm që ju luftëtarë, komandantë të bërë bashkë, i keni dhuruar vendit qeverinë e cila varet nga Beogradi. Nga kjo qeveri më së shumti ka përfitur zoti Pacolli. Ai me dy deputetë mori 4 ministri. A e dini çfarë do të thotë kjo? Kjo është thyerje e një parimi tjetër, respektimit të vullnetit të qytetarëve: me dy deputetë, 4 ministri! Pastaj, kemi edhe një ministër tjetër, i cili faktikisht nuk përfaqëson as edhe një parti politike, sepse nuk ka pasur një parti politike e cila ka qenë në garë.

U tha edhe më herët këtu, ministrinë nuk u mjaftuan dhe u desh të shtohen edhe dy ministri të tjera, dhe cilat ministri? Ministria e Zhvillimit Rajonal që ka qenë një ministri, të cilën me shumë mençuri e kemi evituar deri në formimin e kësaj Qeverie, sepse do të ketë implikime shumë negative politike për Kosovën, Ministria e Zhvillimit Rajonal, dhe është formuar edhe një ministri e re, Ministria për Ndërmarrësi dhe Inovacion. Ministria për Ndërmarrësi është komplet një duplikim i punëve dhe përgjegjësive që sot i bën agjencia KIESA, që është në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Nëse i shohim detyrat, objektivat, obligimet, kompetencat, janë po të njëjtat. Neve na mungon përgjigja se sa është buxheti i kësaj ministrie, si dhe ministrisë tjetër, dhe cili është stafi? A do të ketë transfere nga institucionet e tjera të Administratës Publike apo këto ministri janë në pazar edhe për të punësuar militantë të tjerë politikë?

Ministria e Inovacionit, pjesa tek inovacionet te kjo ministri është komplet një duplikim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Nëse e merrni edhe programin prej 120 faqeve do

ta shihni se aty nuk ka kurrfarë lloj harmonizimi të programit. Te Ministria e Zhvillimit e kemi sektorin e TIK-ut, teknologjisë informatike, te Ministria e Inovacionit e kemi sektorin e TIK-ut. Te Ministria e Zhvillimit Ekonomik e kemi Fondin për zhvillimin e këtij sektori, te Ministria e Inovacionit prapë e kemi Fondin për zhvillimin e këtij sektori. Askund nuk bëhet e qartë se sa do të jetë ky fond, nga do të vijnë paratë për këtë fond dhe, si rrjedhojë e kësaj, cilave ministri, cilave institucione dhe cilat projekte kapitale do të shkurtohen, sepse buxheti është i kufizuar.

Te Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike pa kurrfarë analize është bërë bartja e investimeve strategjike te Ministria e Diasporës. Kjo, ndoshta për shkak të shkathtësive shumë të forta negociuese që i pati zoti Gashi, ndoshta dhe për shkak të pretendimeve që ka zoti Pacolli për një listë të projekteve strategjike, siç është Brezovica, “Grandi” dhe shumë të tjera.

Po a e dini, ju deputetë, që Ligji për investime strategjike që ka kaluar në këtë Kuvend i ka institucionet kompetente dhe Ministria e Diasporës nuk është kompetente për zbatimin e këtij ligji. Është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht agjencia KIESA, është grupi ndërministror prej gjashtë ministrive dhe është Parlamenti. Tash duhet ndryshuar ligjin për t’i dhënë kompetenca zotit Gashi për të hyrë dhe për të bërë shitjen dhe negocimin për asetet strategjike, por ne nuk do ta lejojmë këtë.

Të nderuar deputetë,

Siç po e shihni, Qeveria e vendimeve të mëdha, e cila duhej të formohej për të ecur me “hapa të shpejtë”, sipas turnit dëgjimor të Kadri Veselit, është sot Qeveria e cila nuk mund të marrë asnjë vendim, për shkak se për secilin vendim duhet pasur dritën e gjelbër dhe aprovimin e Beogradit. U tha edhe më herët, zoti Haradinaj ulet në ulësen e të parit të Qeverisë, por nuk ka kompetencë. Ai është kryeministër i vetëm dy ministrave të tij. Ministrat e Pacollit edhe në marrëveshjen që është sekret publik do t’i raportojnë vetëm Pacollit. Ne e dimë raportin e AAK-së me PDK-në, ku zoti Veseli gjatë fushatës i ka bërë thirrje elektoratit të vet që të mos e votojë numrin 2, po 1 dhe gjithashtu e dimë që ministrat e “Nismës” do t’i raportojnë “Nismës”.

Kjo është Qeveria e cila, në fakt, nga një ecje e ngadalshme e ka stopuar komplet progresin e vendit dhe të Kosovës. Ne në një të ardhme shumë të afërt, sigurisht se do të kërkojmë debat parlamentar për programin, e vërejtja kryesore e programit është se nuk ka afate kohore. Të gjitha objektivat thuhet vitin 2017/2021 dhe ju shumë mirë e dini që nuk mund ta kaloni vitin 2018, e lëre më të arrini në vitin 2021. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Meqë është hera e parë që e marr fjalën në këtë legjislaturë, më lejoni që përzemërsisht t'ia falënderoj të gjithë ata qytetarë që ma dhanë besimin që të jem pjesë e kësaj legjislature. Do të mundohem që me punë, angazhim dhe transparencë t'ua shpërblej votën.

Sinqerisht, duke e dëgjuar debatin po hamendem dhe ende nuk e kam të qartë se për çfarë po bisedohet sot! Njëra anë bisedon për programin, ana tjetër bisedon për parimet dhe, thjesht, disa kanë filluar të flasin edhe për zgjedhjet lokale dhe fushatën elektorale, që e kanë nëpër komunitat ku edhe ata garojnë, sepse ju e dini që ne kemi nganjëherë edhe "supermenë" deputetë që mund të jenë edhe kryetarë komune, edhe deputetë, edhe ministër, edhe krejt njëkohësisht.

Të dashur qytetarë, në vitin 2014 humbëm gjashtë muaj duke u barrikaduar në emër të programeve dhe parimeve, që në realitet e tëra u bë në emër të qëllimeve për të marrë pushtetin kundër vullnetit të votuesve, kundër rezultatit demokratik të zgjedhjeve. Në vitin 2017 me të njëjtat metoda u përpoqën dhe tentuan që prapë të barrikadohen, duke harruar faktet e 2014-ës, që aspak nuk u interesuan për bëmat e atëherëshme. Filluan të përdorin përsëri, por tani këto bëma filluan t'ia kthejnë në favorin e tyre, sepse atëherë kur ne në 2014-ën u thoshim se rezultati i votave është ky, lideri më i votuar është ky, atëherë na kundërshtonin dhe ishte pa precedent ajo çfarë ne thoshim, ndërsa sot këtë mundohet që ta kthejnë në favorin e tyre.

Prapëseprapë, me gjithë retorikën propaganduese, me retorikën denigruese dhe të rrezikshme, unë ju them se as atëherë, as tani dhe asnjëherë nuk do t'ia dilni të merrni pushtetin duke krijuar anarki, duke akuzuar pa fakte, duke gënjyer opinionin, duke manipuluar rininë dhe duke shpifur e ofenduar sa herë që e hapni gojën.

Në këtë Parlament ka filluar prapë një praktikë e vjetër, ku më shumë flitet për Moskën, për Beogradin, për Kinën, se sa që flitet për Kosovën. E shoh se sa herë që doni ta sulmoni shumicën parlamentare dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, burimin kryesor e merrni në Beograd, e merrni në Moskë dhe e merrni në Kinë. Megjithatë, unë dua të them që meqë u përmend shumë në këtë Parlament që atë ditë kur u votua Qeveria u prit tri orë delegacioni apo, thjesht, kolegët tanë që të vijnë nga Beogradi, edhe atë ditë u dha një mesazh goxha i qartë. Për mua personalisht, edhe andej edhe kënde, një mesazh të mirë e kam marrë, sepse deputetët të cilët erdhën prej Beogradit, më erdhi mirë që nuk kishin marrë urdhra që të mos respektojnë himnin e Kosovës. Nuk kishin marrë urdhra që të dalin prej seancës kur të interpretohet himni i Kosovës. Ata u betuan nën himnin e Kosovës dhe nën flamurin e Kosovës, që është aspiratë e shumë bijave dhe bijve tanë, që

ky shtet do të bëhet, s' do të mund askush ta ndalë, pavarësisht apetiteve dhe dëshirave tona për pushtet.

U tha se u thirr në interpelancë kryeministri ende pa e bërë betimin. Kryeministri u thirr në interpelancë ende pa e pranuar detyrën prej ish-kryeministrit paraprak. Dhe, kur flisni për praktika botërore, më tregoni diku në botë që një kryeministër i ndonjë vendi demokratik ftohet në interpelancë ende pa e pranuar detyrën e tij. Thjesht sot, a po flasim për parime a po flasim për programin? Unë prapëseprapë po e përsëris, ende nuk e kam të qartë. E shoh në çdo fillim të seancës komunikimin e jashtëzakonshëm dhe të mirëfilltë të “Vetëvendosjes” me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Të gjitha do t’i pranoja si deputete e këtij Parlamenti, po se Lidhja Demokratike e Kosovës do të bëhet mekanizëm i “Vetëvendosjes”, këtë kurrë asnjëherë s’e kisha pranuar.

Dhe, thjesht, e dini shumë mirë, të nderuar anëtarë të Lidhjes Demokratike e kolegë të nderuar, edhe Ramush Haradinaj në njëfarë mënyre gati ra në rrjetën dhe merimangën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, por në atë kohë shkonte drejt dështimit. Në momentin që ai u shkëput nga kjo lëvizje, ai u kthye edhe një herë si triumfues në këtë Parlament. Prandaj, keni kujdes, sepse ia keni borxh elektoratit tuaj, ua keni borxh atyre të cilët votën Lidhjes Demokratike të Kosovës ia dhanë gjithmonë për institucione të mirëfillta e demokratike. Mos rrëshqitni, sepse do të gaboni shumë rëndë!

Parlamenti i Kosovës, e në veçanti Kryesia e Parlamentit, duhet të jenë shumë, shumë vigjilentë, duhet të jenë të kujdesshëm e të mos lejojnë që Parlamenti të shndërrohet në arenë luftërash personale, por as në klinikë rehabilituese për familjet apo për të kaluarën tonë. Kosova është një vend i vogël dhe secili prej nesh duhet ta dijë që nuk mund as ta fshehim prejardhjen tonë dhe as ta glorifikojmë atë. Do të vijë koha kur e gjitha do të dalë sheshit. Nëse mandatin e deputetit dikush e ka arsyetuar për ta rehabilituar të kaluarën e tij dhe të familjes, atëherë votat e popullit i ka marrë duke e tradhtuar atë për gjoja punë e angazhim në të mirën e përgjithshme.

Unë besoj, megjithatë, në veprime të arsyeshme dhe jam e bindur se në mbrojtjen e interesave të përgjithshme në çështjet madhore, shumica e deputetëve do t’i thërrasin mendjes dhe do të ulen së bashku për të marrë vendimet e duhura. Sikurse jam shumë e bindur që disa këtu do të zhvishen para opinionit dhe të tregojnë fytyrën e vërtetë dhe epshet e sëmura për pushtet, të cilat asnjëherë nuk do t’ia dalin t’i ndalin hapat e Kosovës, bërjen e Kosovës shtet, që ëndërojnë, për të cilën duhet punuar pa kursyer.

Në fund, meqë sot u fol edhe për fushatë komunale, për një komunë e cila pretendohet të jetë shembull, unë kisha dashur veç t’ia bëj një pyetje kolegut tim, Faton Topallit, që tani është pretendent për kryetar të Ferizajt, a do t’i ketë Ferizaj, po e përdor gjuhën e zbutur,

siç e përdor zoti Albin Kurti, a do t'i ketë Ferizaj kunjat në mandatin e tij dhe a do të ketë Komuna e Ferizajt suficit gjatë udhëheqjes së tij, siç na ka ndodhur me Prishtinën, kur dihen nevoja dhe dihen kërkesat e qytetarëve, ndërsa afër 20 milionë janë suficit në Komunën e Prishtinës.

KRYESUESI: Faleminderit! Pauzë deri në orën 15:15. E vazhdojmë pastaj seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Vazhdimi i seancës pas pauzës.

KRYESUESI: Koha është të fillojmë, shpresoj që deputetët do të vijnë, ata që nuk janë në sallë.

Driton Çausi, nuk është, Visar Ymeri, nuk është. Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Të dashur qytetarë të Republikës,
Të nderuar deputetë të pranishëm,
PAN-i në fushatë u pati fshehur, u pati zhdukur, nuk vinte në asnjë prej debateve televizive dhe besoj që e pati marrë përgjigjen prej qytetarëve, për shkak se nuk erdhi në debate, nuk pati argumente të diskutonte me subjektet e tjera që garonin.

Njëjtë sot Qeveria është zhdukur, po fshihet jo vetëm sot, po qe më shumë se tri javë, por e ka një ngulshim edhe një yrysh të paparë deri tash drejt çështjes së pushtetit. Kjo është e vërteta e Koalicionit PAN, kjo është e vërteta e Qeverisë tonë.

Populli i Kosovës votoi më 11 qershor, votimi ishte qartazi për ndryshim, por politikanët e korruptuar e të kriminalizuar nuk lanë gjë pa lëvizur për ta mbajtur pushtetin për vete.

Me të drejtë, Koalicionin PAN e kam quajtur 'koalicion i krimit'. Ky grup njerëzish, në veçanti PDK, që e kanë zhvatur Kosovën që nga paslufta, u bashkuan për ta zhvatur edhe më tutje shtetin tonë.

Sigurisht që për të arritur këtë qëllim kishin nevojë edhe për partnerë, kush tjetër përveç se AKR-së, disa duke thanë që edhe ju kërkuat koalicione me LDK-në, me AAK-në, me "Nismën", me AKR-në në kohë të ndryshme. Po, është e vërtetë që kërkuam, sepse donim ta ndryshonim Kosovën.

Këto koalicione nuk ishin të mundura për faktin se këta e kuptuan, edhe në takime jopublike, se Lëvizja "Vetëvendosje" është e pakompromis ndaj krimit e korrupsionit, në njërin anë dhe kundër vasalitetit ndaj Serbisë, në anën tjetër.

Jo rastësisht, krejt këto parti në kohë të ndryshme iu bashkuan partisë së krimit, PDK-së, kurse me ne nuk deshën bashkëpunim.

Të dashur qytetarë,

Sa më shumë që ju po i bashkoheni lëvizjes për ndryshime, aq më shumë po bashkohen këta që duan ta zhvatën Kosovën. Por, ka një dallim thelbësor: ne po rritemi, kurse ata gjithnjë po zvogëlohen drejt zhdukjes përfundimtare. Pra, në njërin anë, po bëheni bashkë zhvatësit dhe të korruptuarit, e në anën tjetër populli, sigurisht që dihet fituesi.

Një ditë një qytetar më pyeti: si ndihesh, tha, kur në krye të institucioneve janë ish-pjesëtarët e UÇK-së? Thënë të drejtën, një gjë të tillë nuk e kisha menduar më herët.

Në shikim të parë, një gjë e tillë duke mirë, por kur e mendon më gjatë del një problem thelbësor. Si u bë që Lista serbe, pra Serbia, Vuçiqi, që është pasuesi i Milosheviqit, ishte faktor përcaktues në zgjedhjen e Hashim Thaçit dhe të Kadri Veselit dhe prapë përcaktues në zgjedhjen e Ramush Haradinajt?

I njëjti qytetar më pyeti se nëse kjo që thashë nënkupton që dua të them se këta tre ish-luftëtarë janë njerëz të Serbisë. Sigurisht që përgjigja ime ishte jo. Nuk ka si të jetë ndryshe, po e vërteta, sipas shpjegimit tim, është edhe më e dhimbshme se aq.

Projektet politike të Hashim Thaçit, Kadri Veselit e të Ramush Haradinajt nuk po i pengojnë më Beogradit. Përkundrazi, këto projekte tashmë janë në përputhje me interesat e Serbisë në Kosovë, është tragjike për mua se si është përmbysur e vërteta.

Këta tre ish-luftëtarë dje ishin të gatshëm ta japin jetën për Kosovën, sot janë gati që ta japin Kosovën, madje edhe Serbisë, për pushtet personal.

Përveç se këta persona u zgjodhën me bekimin e Vuçiqit, Kosovës ja bënë edhe një dëm edhe më të madh, duke lënë vendin peng të vullnetit të Listës serbe, përkatësisht Beogradit.

Sigurisht që ka qytetarë që mund të pyesin pse, pra, ne nuk u bashkuam me PAN-in, në mënyrë që të mos i lëmë fuqi Serbisë?

Qytetarë të dashur,

Ne i kishim dy mundësi: ose të bashkohemi me krimin në Qeveri, ose t'u rrimë besnikë parimeve tona, për të cilat na votuat. Pa dilemë vendosëm të qëndrojmë bashkë me ju deri në fitoren tonë kundër krimit dhe kundër ndikimit të Serbisë në Kosovë.

Përveç partive që iu bashkuan koalicionit të krimit për të ndërtuar qeverinë, këtë proces e ndihmoi tepër shumë edhe LDK-ja.

Përderisa në vitin 2014 LDK-ja iu bashkua krimit, sot ajo e ndihmoi po aq sa në vitin 2014, duke mos vepruar për të ndërtuar një koalicion me ne, "Vetëvendosjen" që do ta bënte ndryshimin, për të cilin ka nevojë vendi. Pa dyshim që i gjithë ky mosveprim ka një emër dhe ai është Isa Mustafa.

Përderisa i njëjti në vitin 2014 u bashkua krimit në qeveri, pa kushte, për ambicie për pushtet, për ne vendosi kushte absurde që pamundësonin bashkëpunimin dhe kështu e ndihmoi koalicionin e krimit.

Kërkoj prej nesh të heqim dorë nga dosjet në prokurori, për të cilat po hetohet për korrupsionin si ish-kryetar i Prishtinës.

Madje ky shkoi aq larg sa na quajti kriminelë dhe banditë, vetëm pse kishim protestuar publikisht në Prishtinë kundër projekteve të dëmshme. Po i njëjti ishte në qeveri me ata që kishte deklaruar që i kanë duart me gjak të aktivistëve të LDK-së.

Nga kjo u kuptua që akuzat dhe shpifjet e tij kishin vetëm një qëllim: mosrealizimin e një koalicioni me ne dhe krijimin e mundësisë që PDK me partnerë të ndërtojë qeverinë. Tash është fakt, që ne edhe LDK jemi në opozitë.

Shfrytëzoj rastin që t'i bëj thirrje LDK-së që të ndërtojë një bashkëpunim opozitar kundër kësaj Qeverie të krimit dhe nënshtrimit ndaj Serbisë.

Të dashur qytetarë,

Kosova shpejt do të jetë në sfidën e radhës, e kam fjalën për zgjedhjet lokale. Unë pres nga ju mbështetje edhe më të madhe për subjektin tonë dhe kandidatët tonë.

Kjo është domosdoshme, sepse jeta e kësaj Qeveria do të jetë e shkurtër, e pas kësaj do të vijmë ne, e kur të vijmë ne, do të kemi nevojë për kryetarë të komunave të ndershëm, në mënyrë që bashkë me ta ta bëjmë ndryshimin në Kosovë. Nuk do të mund të punojmë dhe ndryshojmë gjendjen me kryetarë të korruptuar.

Të gjithë ata që mendojnë se rezultati i 11 qershorit ishte aksidental apo si rezultat i koalicioneve, frymës apo individëve, do të zhgënjehen keq, sepse ai rezultat ka qenë vullnet i popullit për ndryshim, si i tillë do të jetë edhe më i thellë, edhe më i gjerë më 22 tetor.

Të dashur qytetarë,
Sot këtu po ju betohem që këtë Qeveri nuk do ta lejojmë për asnjë moment t'i bëjë dëm shtetit tonë.

Sigurisht që për një gjë të tillë do të jetë e mundur vetëm me përkrahjen tuaj. Prandaj, shihemi në tubime, në zgjedhje deri në fitoren tonë të përbashkët. Faleminderit!

KRYESUESI: ...Ganiu duhet të betohet. Gani, çohu në këmbë për betim.

Unë e lexoj tekstin, ti e përsërit veç "betohem", pastaj e ke atë shkresën që do ta nënshkruash.

"Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem".

Faleminderit! E ke atë shkresën.

Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Kësaj radhe po flasim për një seancë të mbetur, ku do të duhej të shterëj ky debat dhe të kalojmë në pika që janë edhe konkrete, edhe atë që ne e quajmë ‘program krahasimor’, por sido që të jetë, ne e shprehim opinionin tonë edhe për këtë kompozim politik apo këtë mazhorancë qeverisëse dhe sigurisht që herëve të tjera ndoshta kërkoj mirëkuptim për deputetë të rinj dhe do t’ia çojmë fjalimet për lekturim dhe sigurisht do t’i pyesim se çka do të flasim, çka do të thumë, sepse edhe ashtu duket që e kishin shumë qejf të kontrollojnë çdo fjalim dhe të japin orientim edhe në diskutimet individuale të deputetëve.

Kështu që, kolegë deputetë, do të ishte normale që të debatojmë për të kaluarën, jo pse nuk kemi çka të themi apo nuk mund të përdorim analogjinë e ndarjes, konceptesh, ideologji apo rrethanat nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

U tha mjaft nga disa kolegë deputetë, po do të sqaroj sipas asaj çka na pret, çka e pret qytetarin e Kosovës në mandatin e kësaj kostoje, ta quaj mazhorancë, për qeverisjen e vendit.

Besoj që nuk është çështje personale bërja e një kompozimi politik, apo si koalicion qeveritar, jo pse janë bashkuar e keqja me të keqen, jo pse janë futur në një ombrellë politike nepotistët me të korruptuarit, jo pse është shkrirë propaganda e patriotëve me fuqizimin e atyre që haptas deklarojnë se adresë të vendimmarrjes e kanë Beogradin, jo pse u dorëzua në terrin e natës kandidati i turnit të dëgjimeve për kryeministër, jo pse u dorëzuan ata që ngarendën në gjykata me arsyetimin se i kanë të montuara rastet nga SHIK-u dhe Kadri Veseli, por mendoj se çdo individ dhe deputet të ndershëm të këtij Kuvendi duhet ta brengosë fakti se u krijua një qeveri e keqe, e cila më së paku do të jetë në shërbim të qytetarëve të vendit. Qeveri e cila u krijua pa program politik, kjo po dëshmohet edhe sot e tri javë, Qeveri e cila u krijua me imponim numrash, Qeveri e cila u krijua për të fuqizuar klanet, grupet, rajonet, në shërbim të së keqes, e ajo e keqe mbi të gjitha është krimi dhe korrupsioni në vendin tonë.

Kjo bindje fuqizohet edhe nga ekspozita e paraqitur në ditën e votimit, e cila as nga arsyeshmëria, as nga besimi, as nga përmbajtja nuk garantohet apo, së paku, nuk shihet fije shpresë, pavarësisht kundërshtimit tonë, se ky koalicion politik garanton shtet ku sundon rendi dhe ligji, ky ku vend do të ketë zhvillim ekonomik se qytetarët e vendit tonë nuk do të braktisin Kosovën për t’i ikur nga frika e këtij formacioni qeverisëse, i cili për ta paraqet një strukturë në shërbim të interesave të ngushta të bartësve të këtij koalicioni.

Kjo Qeveri është e pastrukturuar, me super ministri, me favorizim të atyre që do

t'u lehtësohet grabitja e ndonjë pozicioni politik dhe shembull konkret është shkarkimi i anëtarëve të Agjencisë së Akreditimit dhe disa anëtarëve të bordeve të pavarura, të cilat janë të mbrojtura me ligj.

Tri shtyllat kryesore për zhvillimin e vendit identifikohen me të keqen e kaluar nga ky formacion politik. Policia dhe gjyqësia e ndikuar dhe e kërcënuar vazhdimisht që nga paslufta po nga këta njerëz, ekonomi dhe financat e ndikuar dhe e grabitur po nga këta njerëz, qoftë me privatizimin e pronave shoqërore, qoftë informalitet ekonomik, ndikim negativ të të bërit biznes të mirëfilltë, deri te përkrahja e grupeve të caktuara kriminale dhe për pasurim të paligjshëm.

Arsimimi: Nga kush pritet një arsim cilësor dhe i avancuar nga bartësit e këtij koalicioni që kanë më shumë diploma universitare në sirtarët e tyre, por të pakryera shkollat e mesme, me kuadro të cilësisë së ulët, me shitës dhe blerës diplomash, si dhe me synim që ushtrimi i ndikimit në universitetet publike dhe private të shkojë deri në masën që të konsiderohen pronë private e këtyre njerëzve.

E them me bindje të plotë se këtij mandatarin nuk i intereson aspak ndryshimi, as të metat që i potencova se i kanë. Nuk i intereson përmirësimi i kushteve të jetës së qytetarëve të vendit, krejt çka i intereson është të qenit kryeministër, qoftë edhe i përkohshëm, vetëm e vetëm që të shndërrohet vegël mashtrimi për atë që njihet si 'nëntoka e pasluftës'.

Andaj, e keni nisur në terr, e formalizuar koalicionin në terr, u votuat në terr dhe sigurisht do të përfundoni në atë që e tha kolegu im, Memli Krasniqi, në gropën që keni hapur për të tjerët, në atë do të bini vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prej PDK-së nuk është, Sala është e paraqitur. Zoti Bilall Sherifi, a është këtu?

BILALL SHERIFI: Shpeshherë qytetarët bien në konfuzion kur shohin deputetin këtu nganjëherë, u duket se është duke folur vetë më vete, po në fakt është duke folur me juve që për qëllim keni të mos i lini njerëzit ta shprehin atë çka duan ta thonë.

Ju kisha lutur, së paku unë nuk e ndërpres askënd, kur të dal këtu, më lini të flas atë çka dua ta them e mos më ndërhyjni, i keni minutat tuaj. Kjo vlen për Kujtimin, akademikun, nuk po të linte kurrë të flasësh, gjithmonë po të ndërhynte. Kjo është për sqarim për qytetarët, se shpesh njerëzit hutohen, nuk e dinë çka e gjeti në foltore këtë njeri që po flet, po komunikon me të tjerë.

Këtë sqarim e kam bërë edhe në emër të shumë deputetëve, se vërtet krijohen situata komike, prandaj le ta dinë se kush është shkaktari i këtyre situatave komike, pra ata që mërdhezën atje në vend, u duken pak minuta që i kanë këtu dhe ndërhyjnë edhe prej ulëseve të deputetit.

Vendi ka katër vjet që është në gjendje të jashtëzakonshme, domethënë një herë me një super mazhorancë për tre vjet dhe me një super opozitë, ku isha edhe pjesë e saj, tash kemi një super opozitë, se atëherë ishte e vogël në numër, por telashxinj shumë në përmbajtje dhe jam krenar që kam qenë pjesë e asaj opozite. Sidomos për ata që në foltore nuk dalin dhe i referohen asaj pjese të pozitës, hedhin gurë. Jo, unë për atë pjesë të opozitës jam krenar, sepse kam arritur, së paku konsideroj që kemi arritur të ndalim disa vendime jashtëzakonisht të dëmshme për vendin, ku ju ishit pjesë e saj.

Tash, jemi në një situatë ku patëm zgjedhje të jashtëzakonshme, kemi një moment kur u bënë koalicionet të jashtëzakonshme, kemi momente kur pati përpjekje për koalicionet, sërisht të jashtëzakonshme dhe kemi një qeveri po ashtu të jashtëzakonshme, që për detyrë ka të kryejë punë të zakonshme. Nuk e ka për detyrë të kryejë punë të jashtëzakonshme, punë të përditshme, nëpërmjet të cilave shpresojmë shumë që do t'ua përmirësojmë jetën qytetarëve të Kosovës, do ta përmirësojmë mirëqenien e këtij vendi, duke zhvilluar ekonomikisht vendin, aq sa mundemi, nuk di sa do të bëhet, por zotohemi së paku në emër të deputetëve të “Nismës”, në emër të ministrave të “Nismës” dhe në emër shpresoj të gjithë atyre që kanë hyrë në vullnet të mirë. Kjo Qeveri do t'i zhgënjejë shumë ata që presin vendime të dëmshme për vendin. Jo, nuk do të ketë vendime të dëmshme për vendin. Jo pse unë jam ndonjë supermen dhe do t'i ndal, siç pretendojnë disa këtu se do t'i ndalin ato vendime të dëmshme, porse unë nuk besoj që zoti Haradinaj, ministrat, deputetët e mazhorancës do të bëhen pjesë e atyre vendimeve për të cilat kujdestarët supremenë nuk do t'i lejojnë të ndodhin. Mendoj që nga kjo logjikë është mirë të largohemi.

Tash, shihe, këtu kemi një situatë kur vijmë në foltore, në studio televizive, dhe i shohim, sidomos nga opozita, disa propaganda në formë të frazave dhe përsëriten aq shpesh sa që dikur fillojnë edhe vetë të besojnë këtë. Tash, cilat janë ato? Unë po i përmend disa.

Thuhet se Qeveria e Kosovës është peng e Beogradit, është peng e Listës serbe, përkatësisht peng e Beogradit. Asnjë provë nuk silllet për këtë, thjesht lëshohet, përsëritet në mënyrë të vazhdueshme, asnjë provë nuk silllet. Vetëm fakti që kjo Qeveri është votuar edhe nga deputetët e Listës serbe nuk është provë që kjo është kapur nga Lista serbe. Le të presim, nëse del ashtu siç po thoni ju, vjen koha kur mund të thoni: “Ja, ky vendim dëshmon që ju jeni peng apo Qeveria e Kosovës është peng e Listës Serbe”. Nuk ka diçka të tillë. Këto finesa, këto rafinesa, na tregoni se cila është marrëveshja që keni bërë me

Listën serbe në dëm të Kosovës? Pra ajo ekziston diku, ajo është e nënshkruar, veç ju tash krejt çka mbetet është të na tregoni. Pra, pa e pasur fare asnjë marrëveshje, as ata, as ne, as unë, këta vijnë me këtë aksiomën e tyre, pothuajse e kanë ngritur në nivel të aksiomës, e thonë: “Po, ka marrëveshje, po ne nuk po i dimë”. A ka hipokrizi dhe a ka kundërthënie më të madhe se të thuash: “Ka, po unë nuk e di cila është ajo marrëveshje”. Por unë i kam disa supozime se ju mund të jeni marrë vesh për këtë apo për atë. Po s’shkon kjo kështu. Jo, në një foltore të Kuvendit të Kosovës, ku me qytetarë duhet të jemi të sinqertë dhe t’u tregojmë drejt për atë që dimë, për atë që mendojmë, natyrisht, edhe për atë që supozojmë kemi të drejtë të themi. Po le të mbetet supozim, thoni që është supozim, jo të dilet këtu e të thoni: “Po, ne e dimë, ashtu është veç...” Vjen dita kur merret vesh se cilat qenkan marrëveshjet e dëmshme për vendin. Pritni. Marrëveshje të dëmshme për vendin nga opozita i keni miratuar, nga opozita i keni miratuar. Dalin dhjetë herë, e kam vërejtur, marrëveshjen e 12, 13-ës janë referuar kolegët nga LDK-ja, por nga opozita e keni miratuar atë marrëveshje, e keni votuar.

Nuk është se, të jeni pak të sinqertë, së paku me publikun, nuk ishte zgjedhja e parë e Haradinajt koalicioni i gushtë me Listën serbe, nuk ishte zgjedhja e parë, të jeni korrektë. Ishte zgjedhja e fundit, ose duhej vendi të shkonte në zgjedhje ose ju të dyja ta bënit qeverinë, ju dyja ta bënit qeverinë, që nuk arritët, siç thashë në fillim në cilësinë e kryetarit të grupit, po ashtu jo për shkaqe programore, po për shkaqe të postit të famshëm të kryeministrit.

Pra, nëse, të jemi të sinqertë, nëse tri grupet politike nuk arritën të bëhen bashkë, qoftë dy, e majta e djathta, se këtu ka krejt edhe të majtë, edhe të djathtë, edhe qendër, krejt janë këtu, po ju së paku ashtu si po shoh, njëra e qendrës së majtë e tjetra e qendrës së djathtë, nuk arritët të merreni vesh të bëni qeverinë. Qeverinë është dashur dikush ta bëjë. Vendin nuk ka mundur të rrijë pa qeveri. Tash t’i japim kohë, së paku t’i japim kohë zotit Haradinaj dhe Qeverisë, të shohim a ka marrëveshje të dëmshme për vendin dhe ta gjykojmë pastaj mbi bazën e atyre veprimeve të dëmshme për vendin.

Ndërsa sa i përket çështjes së zhvillimit ekonomik, vendi është në një gjendje vërtet të rëndë, për atë s’kam çka i shtoj. Të gjithë e dimë, mund të mos jetë plani më i mirë, mund të mos jetë programi më mirë, po ky është ai që është, besoj që në rrugë e sipër do të përmirësohet dhe do të matet pastaj me rezultatet.

Shihe, ka çështje të cilat duhet të pritet edhe kostoja politike. Një qeveri merr kosto politike. Këtu kur flitet nëse programi nuk na pëlqen dhe nuk bëhen veprime në funksion të zhvillimit të vendit, atëherë ky koalicion do ta ketë koston politike siç edhe deri në një masë, për shkak të qeverisjes, keq-qeverisjes, ku ta di unë, vitin e kaluar, edhe u pagua një tagër. Pra, tagrat, çmimet janë elektorale, sa i përket aspektit të zhvillimit ekonomik, sa i

përket aspekteve sociale, mirëqenies sociale, sa i përket aspektit të cilësisë së ulët të arsimit, cilësisë së ulët të shërbimeve sociale dhe shërbimeve shëndetësore, ka tagra politike, jam i sigurt që kushdo që qeveris keq në këtë vend, votuesi dikur i ndëshkon, cilido qoftë ai.

Ajo që do të kisha lutur të përmbahemi nga, apo së paku për të qenë sinqertë me votuesin, me qytetarin në përgjithësi, të mos dalim këtu të vërtetat tona, pikëpamjet tona t'i themi si argumente, pa asnjë provë. Nxirrni dhe provat për të gjitha ato tradhti, ato vendime të dëmshme që i paskan, ato marrëveshje të dëmshme, të cilat i paska arritur kjo Qeveri, dilni thoni është kjo një, dy, tre por mos hamendësoni. Dhe këtë vend, po e përfundoj, as nuk e ka sjellë deri në këtë gjendje, as nuk e ka çliruar Lista serbe, as nuk mundet ta zhbëjë. Këtë pavarësi, këtë shtet kështu që e kemi as nuk e kanë bërë ata, as nuk mund ta zhbëjnë. Ose e bëjmë ne, ose s'e bën askush, ose e zhbëjmë ne, ose s'mund ta zhbëjë bash askush.

Unë nuk jam nga ata që dua të minimizoj rolin e tyre, por të jemi korrektë, po e nënvizoj vetëm faktin që e kanë votuar këtë qeveri nuk na bënë të varur nga ata dhe nga askush tjetër.

Nëse kjo Qeveri për hir të vazhdimit të mandatit të vet, me çdo kusht, nesër, i nënshtrohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Bilall!

Kujtimi, replikë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Jo vetëm pse po ju drejtohem si kryesues, po për faktin që unë s'po e udhëheq këtë seancë, i bie që unë as nuk mund t'i jap fjalën, as mund t'ia marr fjalën dikujt tjetër. Ndërkaq ato që i tha shefi i Grupit Parlamentar të "Nismës" janë saktësisht ato që do të thoshte po të ndërhyrja unë, sepse ai s'mund të tjetërsohet. Patjetër që unë në fjalë time, edhe në këtë rast, nuk do ta çoj më tutje, sepse unë kam shumë interes që të bisedoj me kryeministrin e vendit dhe unë, edhe pas tentimeve që ju ta përfaqësoni kështu kryeministrin, unë vazhdoj të besoj që kryeministër i Kosovës është Ramush Haradinaj dhe me atë do ta zhvillojë debatin për të gjitha çështjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani kolegice i kolege,

Narodni poslanici,

Uvaženi mediji, gost, ima samo jedan gost tako da i vas pozdravljam.

Prvo se izvinjavam se prevodiocima što će morati da ostanu samo zbog mene u Sali, jer jedan od najvećih zajednica nije u Sali, tako da se vama izvinjavam, a mislim da je ovo loša poruka što kaže naš narod: Ako se po jutro dan poznaje, mislim da ćemo da imamo dosta problema ovde.

Naime, ja sam hteo da dam svoju sugestiju vezano za program Vlade, međutim, s obzirom da nema nikog iz Vlade ovde, mislim da ne bi bilo korektno od moje strane da pričam, iako sam svestan činjenice da ova Vlada svi znamo kako je, nastalo da ima tanko većinu, koliko će da traje to će najviše zavisiti od same Vlade, odnosno od njenih rezultata, i da budem potpuno iskren moj je interesi nisu sebični, nisu lični. Ja želim da i ova Vlada i ovaj Parlament imaju uspeha, jer pre svega to je uspeh naših građana.

Hteo sam, poštovane kolege, da im se obratim sa ove govornice pošto ne znam oni koji znaju i koji ne znaju ovaj je četvrti mandat u ovom parlamentu, ja sam predsednik Samostalne libelarne stranke, ostalih koji dolazi iz Srpske zajednica, tako da nije samo Srpska lista ta koja je lista Srpske zajednice.

To kažem iz prostog razloga zbog obaveze prema onim koji su dali glas za mene. Ja jednostavno ovde nisam u privatnom režiji i ne doživljavam ovaj dom kao privatnu firmu, tako da se na taj način nećemo da se ponašam. Ovde sam pre svega ispred onih ljudi koji su na poslednjim izborima, uz velike izazove, velike muke i patnje dali glas svom predstavniku, dali glas samostalnoj Libelarnoj stranci, koja a je još jednom po četvrti put u ovom sazivu.

Trudiću se da na svaki način opravdanih ovo poverenje, i svakako ja sam narodni poslanik za sve naše građane koji žive na ovom prostoru, i da ću tako da se ponašam najbolje garancije su više od decenije mog ličnog i rada stranke na čijom sam na čelu.

Dakle, uvažene kolege, uvaženo Predsedništvo, želim samo da vas zamolim da jednostavno poštujemo zakon i ustav, i na taj način da se ophodimo prema daljem aktivnostima. Naime ,ono što je slučaj sa Vladom, Vlada je formirana, znači ima određene pozicije koje su u Vladi i Parlamentu zagarantovane za neveličinske zajednice, jedna od njih je Srpska zajednica, ne za političke stranke nego za zajednicu. Ispred Srpske zajednice u ovom Parlamentu ima dva politička subjekta, jedan od ta dva jeste Samostalna libelarna stranka. I ja znam da je devet veće nego jedan, ali ću se truditi da ja

jedan se bar onako kako do sada radio, borim za interese i svoje zajednice, i građana koji žive na prostoru Kosova.

Tako da kada je u pitanju Vlada postoje pozicije za garantovane za Srpsku zajednicu, tako isto postoji i ovde u Parlament. Tako da vodite računa posebno pre svega predsedavajući i administraciji kažem da komisije, i sve ono što je u vezano za Srpsku zajednicu, da na taj način vodite računa, i nemojte da pravite diskriminaciju i nemojte da kršite zakon odnosno Ustav.

Ja da nisam sebičan i da sam se ponašao više nego korektno jeste upravo i izbor potpredsednika Skupštine. I ako nije bio dovoljan broj glasova za potpredsednike ispred Srpske zajednice, ja sam vođen opštim interesima i činjenicom da ne budem onaj koji blokira. Jednostavno sam prepustio da se na taj način izabere predstavnik Srpske zajednice u Predsedništvo Skupštine Kosova, ali to ne znači da ću sedeti skrštenih ruke, da ću aminovati sve ono što se bude radilo pogrešno. Tako da, poštovane kolege, ja uvažavam potpuno ravnopravno i opoziciju i poziciju, pre svega vas kao predstavnike građana, i na taj način želim i u buduće da mene doživljavate kao ravnopravnog vašeg kolegu. Ono što će biti moja uloga u ovom Parlamentu jeste borba za bolji život svih naših građana i jednostavno decenijama unazad zajedno imali puno i problema, i puno stvari koje ostale iza nas, i trebaće nam mnogo više truda, razumevanje i vremena, kako bi stigli to izgubljeno vremena, kamo da bude nešto bolje za naše građane.

Slobodno vas pozivam gde god budete čuli da ja lično, odnosno stranka na čijoj smo radili nešto protiv interesa naših građana, ja vas molim da i na to skrenete pažnju.

A isto tako se vama obraćam da ću to činiti i ja s druge strane, bez obzira iz koje bilo koje stranke dolazilo to, a pogotovu po gotovu pre svega predstavnicima Srpske zajednice, jer ja pre svega u ovom Parlamentu sam ispred Srpske zajednice. Ja znam da je ručak bio malo pre, i da još imate potrebu za nekim drugim aktivnostima, ali molio bi za pažnju još minut dva, i neću da produžim mnogo, i neću imati prilike da govorim koliko možete vi, koje imate političke grupe, ja nemam jer sam nezavisan poslanik ovde u Parlamentu, nemam svoju grupu, iz tog razloga da imate tu činjenicu u obzir, i da jednostavno znate da sa ove govornice ovde, i opšte tamo god budem imao priliku, raditi na jačanju zajedničkog suživota, na jačanju zajedničkih interesa sve ono što je krasilo samo Stalnu liberalnu stranku i moje partnere u poslednjih deceniji i više.

Još jednom, zaista vas molim da budete podrška za pre svega zaštitu svega ono što je pre svega upisanu u Ustavu, a ima puno stvari koje pišu u Ustavu, zakona koje se jednostavno ne sprovode, zato je više nego potrebna i vaše, poštovane kolege, dobrovolja. Ja sam spreman i pokazao dobru volju za zajednički interes, zato bi vas molio ispred

Srpske zajednice i to vi učinite, bez obzira što drugi predstavnici Srpske zajednice, koje ih ima većinu nisu ovde, sigurno da će oni iako što su više mnogo manje biti za ovom vjerkovnikom nego što ću biti ja, ali nije cilj u priči nego u rezultatima. Nisam želeo na bilo koji naćin pomijem izbore, nisam želeo da ovo neko shvati kao izbornu kompanju, iako bih moga da pričam ćitavu noć kako smo prošli izbore i kako ko došao u ovom Parlamentu. Još jednom se zahvalim na pažnji, i želim da ćestitam izbor za narodne poslanike svima vama koji ste ućesnici u izbornom procesu na lokalnim izborima želim puno uspeha, i pre svega našim gađanima što bolje rezultate. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në programin qeverisës të kryeministrit i lexova ato pak rreshta të ishin shkruar për bujqësi dhe më ra në sy fjala “bujqësia është sektor strategjik”. Pra, lirisht fjalën “strategjik” le ta vendosin në thonjëza, sepse nuk duket ashtu siç e keni shkruar në programin tuaj qeverisës.

Është për t’u habitur që edhe kësaj radhe kjo qeveri nëpërkëmb sektorin më të rëndësishëm që mund të nxisë zhvillimin ekonomik të vendit, pra sektorin e bujqësisë. Sikurse qeveritë tjera, në krye të këtij sektori vendoste një herë një basketbollist, pastaj një muzikant, dhe tash kjo qeveri në krye të këtij sektori, apo këtë sektor komplet e lë në dorën e Listës serbe. Shtrohet pyetja: Si mund të besohet që Lista serbe, e sponsorizuar nga Serbia, do të bëjë përpjekje ta zhvillojë bujqësinë, ta rrisë prodhimin vendor për t’i bërë konkurrencë Serbisë si importuesi më i madh i produkteve bujqësore dhe ushqimore në Kosovë. E besoj që ju të gjithë e dini që vetëm në vitin 2016 Kosova ka pasur import të produkteve bujqësore dhe ushqimore nga Serbia me vlerë prej 670 milionë euro.

Pra, a mund të besoni se kjo ministri do të bëjë strategji për ta ulur importin e produkteve të importuara nga Serbia. Në fjalimin e kryeministrit dëgjova që tha se deri më tani bujku i Kosovës është ndier i vetmuar, e unë si ekspert i kësaj fushe po them që bujku i Kosovës sot me këtë vendim, jo vetëm që është i vetmuar, por është i mbytur tërësisht. Unë e di, jam i sigurt që keni pasur njerëz të zotë, profesionistë që këtë ministri do ta udhëhiqnin mirë, por unë nuk e di se çfarë zori ka pasur që këtë ministri ta lini në dorë të tyre. Veç një gjë e di, që do ta ketë edhe më zor që të menaxhojnë me këtë ministri, sepse do të presë më shumë sesa u desh ta presë atë ditë Listën serbe, 4 orë.

Si pasojë, fermerët e Kosovës, bujqit e Kosovës, edhe më tutje do të shkelen nga konkurrenca e padrejtë dhe e pabarabartë nga vendet fqinja, prodhimet e tyre do të mbeten pa u shitur dhe në fund do të përfundojnë në mbeturina. Përveç kësaj, nuk e di si

do t'i mbrojë Lista serbe pyjet e Kosovës? Si do ta mbrojë Lista serbe tokën bujqësore të Kosovës? Si do t'i mbrojë lumenjtë e Kosovës, prodhimin vendor? Si do ta shtojë përpunimin e prodhimeve vendore, e kështu me radhë. Pra, është për keqardhje që këtë sektor të rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë, këtë sektor strategjik, ta lini në duart e Listës serbe, e cila do të menaxhojë me një buxhet rreth 50 milionë euro që shkojnë në grante e subvencione për fermerët e Kosovës.

Pra, kjo tregon që ju të gjithë nuk e keni hallin e bujqësisë e as të ekonomisë së vendit, por e kishit hallin e pushtetit dhe të pozitave tuaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën për replikë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse ne e respektojmë opozitën dhe me insistimin e tyre ta mbajmë këtë seancë, të paktën le të bëhen fer dhe do të ishte dashur që të diskutojnë për parimet programore. A u mbytet duke thënë "parimet programore". Mos flisni për programin se po dilni prej rendit të ditës, kjo është e para.

Dhe, të lutem, nëse flasim për programin duhet ta ndërpresim fjalën, sepse po dalim prej rendit të ditës, për program do të flasim një ditë tjetër. Këta s'deshën të flasim për program, deshën për parimet programore, pra mos flisni për një material i cili nuk është duke u diskutuar, kjo e para. E dyta, meqenëse u përmend bujqësia, është për keqardhje dikush që e di qysh është vetë profesor i bujqësisë, të flasë pa asnjë lloj kompetence dhe as pa informatat bazike për funksionimin e sektorit të bujqësisë së Kosovës, kjo e para. E dyta, Ministria e Bujqësisë nuk jep as grante, as subvencione. Ato subvencione që i merrti me dhjetëra mijëra euro çdo vit, zoti profesor, deputet, që i ke marrë çdo vit edhe kur kam qenë unë ministër, edhe kur kanë qenë para meje, e që do t'i marrësh edhe prej Nenad Rikalos, ato t'i jep Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e cila është agjenci ekzekutive dhe e kryen punën e vet në mënyrë autonome prej ministrisë, sepse ministria bën politika, miraton programe, bazohet në ligjet që i kalon ky Kuvend, ndërsa grantet, subvencionet i ndan agjencia, janë njerëzit të shërbimit civil, ata që janë dhe që kanë qenë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen dhe me ta qysh ke pasur punë në të kaluarën kur i ke marrë subvencionet, qysh do t'i marrësh, dhe i ke marrë edhe këtë vit, dhe qysh do t'i marrësh edhe vitin tjetër, kështu që mos manipulo me opinionin të flasësh për gjërat, të cilat kushdo që ka pak interesim që të informohet i di.

Do të thotë, asnjë ndryshim në kuptimin e funksionimit institucional nuk ka ndodhur. Për këtë duhet të flasësh kur të vijë programi i Qeverisë, por ju mos e keqpërdorni atë që e thashë prej fillimit. Po thoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, a do?

SALIH SALIHU: Meqë grantet dhe subvencionet i jep agjencia, pse atëherë krenoheni ju si ministër, jeni krenuar si ministër që ju i keni kryer punët, pra? Pse i keni marrë meritat, kur s'paska lidhje me Ministrinë e Bujqësisë, nën një.

Nën dy, me ju, zoti ministër, bujqësia ka kapitulluar. Ju e dini shumë mirë që fermerëve u kanë mbetur produktet pa u shitur, me ju që dy vjet grurin dhe misrin nga 13 centë e kemi pasur, me ju në Qeveri, me gjithë këta kryeministra që i ke pasur, më lirë ka qenë gruri se krundet për ushqimin e kafshëve, domethënë me qeverinë e juaj. E sot po e tregon ti se çka sa u përket subvencioneve dhe granteve. Ti e di që jam prodhuesi më i madh në Komunë të Vitisë i grurit dhe i misrit dhe në qoftë se keni bërë shkelje që m'i keni dhënë, trego ju lutem nëse nuk më takojnë, por e di se çdo sipërfaqe bujqësore që është mbi 2 hektarë i merr ato.

Unë i kam mbjellë, nuk jam sikur ata të tjerët që s'mbjellin fare e marrin. E ti e di shumë mirë kush janë ata që s'mbjellin dhe marrin subvencione dhe grante dhe prandaj s'ke nevojë ta përmendësh si individ se është shumë keq që po i drejtohesh individit. S'pati lidhje me ty kjo punë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të fokusohem në rendin e ditës dhe e kam një mesazh për të gjithë deputetët që foltoren e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të mos e përdorin atë si organ prokurorie, hetuesie, të kursen prej fjalëve, prej fyerjeve, prej shpalljeve të njerëzve tradhtarë, patriotë e tjera, e tjera. Tek e fundit, jemi vend i vogël, jemi vend në tranzicion dhe të gjithë e njohin mirë, fare mirë njëri-tjetrin. Do të vijë koha që do të hapen të gjitha këto letra dhe do të shihet kush sa ka kontribuar dhe kush sa e ka dëmtuar prosperitetin e këtij vendi.

E kam edhe një apel kolegial kur flasim për organizata politike, për parti politike, ne jemi Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kam qenë mbase i pari zyrtar i LDK-së që kam kërkuar që në këtë mandat të mbetemi në opozitë. Jeni bërë të gjithë bashkë, e keni rrëzuar Qeverinë e LDK-së, në rregull jemi. Është një mazhorancë çfarë është, urdhëroni qeverisni, shtyjini proceset tutje. Keni thënë që janë të ngathët në marrje të vendimeve, nuk ka dinamikë, në rregull! Jemi këtu konform Kushtetutës dhe rregullativës ligjore,

janë ndërtuar institucionet, ta shohim, por e kam edhe një kërkesë: Nuk mund askush askujt këtu t'i shesë patriotizëm, sepse nuk rilind republika me dikë që ka ardhur këtu në Kuvend që një muaj, dhe që e dimë backgroundin e tyre, janë breza të tërë që kanë dhënë djersë, mund e gjak për këtë liri e për këtë pavarësi, e cila ka mundur të jetë shumë më ndryshe në qoftë se ne do të ishim në nivel të detyrës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po citoj parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021: “Ky dokument kornizë është zhvilluar me qëllim të afirmimit të mundësisë së Kosovës për të dalë nga gjendja aktuale. Është dokument që përcakton zotimet për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet qeverisjes dinamike në Kosovë”. Në start të punës, kjo qeveri është glomuroze, mjaft heterogjene, nuk garanton koordinim dhe efikasitet, mund të garantojë dinamikë veprimi, por këto mbetet t'i shohim. Në veçanti në dikastere të caktuara udhëhiqet nga emra anonimë, me CV të zbehtë dhe që në aspektin e përvojës, por edhe të menaxhimit dhe peshës politike, nuk janë dëshmuar. Nga 21 ministra, janë 4-5 ministra kompetentë që udhëheqin dikastere të caktuara, të tjerët thjesht kanë ardhur me CV jashtëzakonisht të zbehta.

Të jesh përgjegjës nacional i sektorit të shëndetësisë, apo të punëve të brendshme, apo një dikasteri tjetër, apo të arsimit, është jashtëzakonisht serioze dhe unë mendoj që heterogjeniteti dhe brishtësia edhe në numra thjesht e pamundëson ecjen tutje dhe zbatimin e një programi cilësor për përmirësimin e gjendjes në këtë sektor. Unë do të fokusohem në fushën e arsimit, shëndetësisë, por edhe dialogut me fqinjët, sepse rreth këtij dialogu dhe rreth disa temave të nxehta, që së shpejti do të na vijnë në Kuvend, dhe ne si të zgjedhur të popullit duhet të japim përgjigje konform vullnetit të qytetarëve, vendi gati shkoi në luftë vëllavrasëse.

Arsimi, po e citoj draftin: “Qeveria do të ndërmer reforme të thella në të gjitha nivelet në mënyrë që të rritet cilësia në arsim. Do të ketë rishikim të programeve brenda institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë, duke iu përshtatur nevojave të tregut sipas regjioneve të një vendi”. Ky formulim është i gabuar. Është gabuar edhe në qeveritë e kaluara kur janë hapur universitete në lokalitete të ndryshme pa fizibilitet. Që të hapet një universitet dhe programet e reja duhet të studiohet, duhet të bëhet fizibiliteti për jetëgjatësinë e atyre profesioneve në tregun e punës, jo vetëm në Gjakovë, Pejë, Prishtinë apo në Mitrovicë, por në nivel rajonal dhe për tregun e Bashkimit Evropian, meqë edhe ne aspirojmë të jemi pjesë e atij tregu të punës.

I bëj apel ministrit të Arsimit që ta depolitizojë sistemin arsimor, në veçanti universitetet publike, sepse aty ka njerëz, individë, të cilët e kanë gjymtuar me vite të tëra sistemin arsimor, e në veçanti arsimin universitar.

Shëndetësia, po citoj draftin: “Qeveria e Kosovës do të ndërtojë shërbim cilësor shëndetësor për të gjithë dhe këtë çështje do ta trajtojë me prioritet të lartë. Do të ndërtojmë sistem stabil të sigurimit shëndetësor për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo Qeveri do të garantojë konkurrencën e drejtë ndërmjet sistemit shëndetësor publik dhe atij privat”. Pika më e dhimbshme e këtij shteti dhe e këtij populli është shëndetësia. Dikush mund të thotë ka qeverisur edhe LDK-ja. Po, është më se e vërtetë, por duhet të ju them një gjë. Ka qenë qeveri e numrave të shumtë, por që në sektorët si arsimit dhe shëndetësia është punuar pak. Nuk ka shëndetësi cilësorë pa financim. Fondi për Sigurimet Shëndetësore është premtuar më 2015, 2016, më 2017, më 1 janar ka pasur të hyjë në fuqi Ligji për sigurimet shëndetësore dhe tani ministri i ri i cili nuk vjen nga fusha e shëndetësisë dhe i cili nuk ka punuar me hartim, menaxhim dhe edhe prodhim të politikave shëndetësore, pa një përkrahje financiare serioze, thjesht nuk do të bëjë asgjë. Niveli i vizitave, i kontrollove që janë për nivel primar në Qendrën Klinike Universitare është për keqardhje.

Po vazhdon brenga e mëtutjeshme e mungesës së aparaturave dhe mjeteve shpenzuese elementare. Paramendojeni kur një kirurg hyn në operacion dhe nuk e ka gjilpërën ose penjtë adekuatë. Në vend që të ulet, të planifikojë për operacionin dhe ta ndal vdekjen dhe ta kthejë jetën, ai ballafaqohet me mungesat më banale. Duhet t’i thuhet stop tranzicionit në shëndetësi, thjesht kam kërkuar edhe në një medium nacional, në qoftë se shëndetësia e Kosovës do të jetë prioritet i Qeverisë në tre vjetët e ardhshme, nëse nuk investohen 100 milionë euro, e kemi të kotë, do të na shkojnë prej 100 deri 150 milionë euro trajtim jashtë vendi, në regjion, në Turqi dhe një pjesë e madhe besa edhe në Serbi, sepse pacienti i lodhur i Kosovës është mbështetur për muri dhe duhet t’ia kthejmë dinjitetin mjekut dhe punëtorit shëndetësor, sepse është nëpërkëmbur shumë.

Te dialogu, askund te dialogu me fqinjët, e në veçanti me Serbinë, nuk e pashë fjalën “konsensus nacional”. Ju lutem, i bëj apel Qeverisë dhe mazhorancës, që është e brishtë, do të kemi vendime jashtëzakonisht të rëndësishme, të mos fyhemi, të mos e ulim vlerën autoritetin tonë si të zgjedhur të popullit, po edhe autoritetin e këtij Kuvendi, sepse ne duhet të ulemi dhe të marrim vendime të mëdha për vendin, të cilat mbase mund të na vijnë edhe para Vitit të Ri. Dhe, unë nuk e marr guximin që as të shpall patriotë, as tradhtarë, dhe as të jap vlerësime për grupacione politike. Tek e fundit, ky brumë elektorale, kjo trupë elektorale na ka sjellë këtu. Unë e përfaqësoj tani grupin e dytë parlamentar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe trendi i menaxhimit të punës së Kuvendit, i diskutimeve dhe i adresimeve të çështjeve me interes nacional, më falni është për keqardhje, dhe kësaj logjike të debatimit, të konkurrencës së mendimeve duhet t’i vëmë pikë.

Për dy çështje tjera sensitive, Asociacionin dhe në veçanti Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, duhet të lidhen për fjalën e kryeministrit të vendit dhe po e mbyll fjalimin tim. Uroj që ky Kuvend të punojë për Republikën, për interesin e qytetarëve, e në veçanti në interes dhe perspektivës të fëmijëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Krejt në të kundërtën sakrificës po na vjen ky lloj miksi qeveritar me luftëtarë, me SHIK, me tregtarë, me biznesmenë dhe me Beograd. Kjo është një arritje e re kundër ndërtimit të pavarësisë së Kosovës, e ky grupim vetëm këtë program mund ta ketë - largimin e Kosovës nga pavarësia. E kjo lloj qeverie ka edhe program, natyrisht program për ta rrënuar këtë vend në pavarësi dhe në ekonomi. Me këtë program, kjo Qeveri e pranon faktin se Kosova është në gjendje shumë të rëndë, aty shkruan edhe taksativisht. E pra, në këtë qeveri janë gjithë ata që kanë qenë në drejtim të këtij vendi deri tani, pak a shumë të gjithë ata, të cilët pretendojnë tash ta qeverisin Kosovën, më herët apo më vonë, më gjatë apo jo, e kanë qeverisur Kosovën këto 18 vjet pas luftës.

Rrjedhimisht, këta edhe janë përgjegjës për këtë situatë, e me njerëzit që kanë shkaktuar këtë krizë në Kosovë nuk dilet nga ajo. Aftësia e tyre e vetme është që ta shpijnë Kosovën në një shkallë më të lartë të krizës. Këto janë qeveri të krizave dhe kjo do të jetë Qeveria e krizës më të përkryer dhe ne e kemi thënë edhe më herët dhe do ta përsëritim: Me injorantë nuk ka zhvillim, e me hajna nuk ka shtet.

Këtë popull të veç e ka kuptuar, e meqë populli e ka kuptuar këta po duan ta zëvendësojnë autoritetin e popullit me autoritetin e Beogradit. Po duan ta zëvendësojnë vullnetin e Kaçanikut dhe luftën e UÇK-së me autoritetin e Beogradit. Kjo është kriza e pavarësisë, e vetmja arritje e tyre.

Janë mbledhur 20-30 subjekte bashkë dhe janë vendosur në shantazhin e shtetit të Serbisë nëpërmjet Listës serbe, në mënyrë që ta bëjë një shumicë në minimumin ekstrem. Këta mungesën e votave të popullit po mundohen ta kompensojnë me votat e Beogradit. Këta, në vend se ta fajësojnë popullin që nuk ua dha votën, na fajësojnë neve deputetëve të opozitës që nuk ua dhamë votën për krijimin e Qeverisë. Por, këta kaq pak dinë që po ua drejtuam popullin marrin përgjigjen e merituar, edhe më të rëndë se të 11 qershorit.

Kur qeveritë kuislinge e humbin popullin, u duhet dikush i jashtëm ta mbajë pushtetin. UNMIK nuk keni, e bashkësia ndërkombëtare kësaj radhe nuk ka vullnet, prandaj po u duhet Serbia për të ju mbajtur në pushtet.

Ramush Haradinaj me dhënien e tri ministrive Listës serbe i ka tejkaluar edhe kërkesat e Pakos së Ahtisarit, jo vetëm në numër, por edhe në substancë. Ju po na akuzoni se po ua përmendim Listën serbe. Le t’jua përkujtojmë juve pak i t’i tregojmë qytetarit cila është Lista serbe dhe çfarë kanë deklaruar dhe vepruar ata në vazhdimësi. Ata lirisht, ata realisht, po e drejtojnë qeverisjen e Kosovës, ata që e bënë qeverisjen Haradinaj, pra Lista serbe ka deklaruar gjatë gjithë kohës: “Shteti ynë është Serbia, nuk kemi tjetër dhe nuk kërkojmë tjetër.” E këta, edhe e luftojnë shtetin e Kosovës.

Besojmë se armiqësia e tyre ndaj ekzistencës së pavarur të shtetit të Kosovës është mjaft e qartë, pasi këta kanë kaluar në luftim të hapur e goxha transparent në të. Vetë fakti se të gjithë anëtarët e Listës serbe në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të Partisë Përparimtare Serbe të Aleksandër Vuçiqit, thotë mjaft.

Gjatë zgjedhjeve të fundit, KQZ-ja e dënoi Listën serbe me 25 mijë euro për nxitje të urrejtjes, kërcënim dhe moskrijimin e Ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës. KQZ-ja, natyrisht, e ka vetëm këtë mjet dhe kaq ka mundur të bëjë, do të thotë ta dënojë me 25 mijë euro. Kjo është - e luftove shtetin e Kosovës, por që vjen PAN-i dhe e amnistion Listën serbe, madje edhe e shpërblen me 3 ministri, përfshirë ministrinë e Kosovës, madje PAN-i në realitet i jep Listës serbe edhe të drejtën e vetos për çdo vendim të Qeverisë. Në vend që ne ta heqim shumicën e dyfishtë të Pakos së Ahtisarit, për shkak të së cilës ne jemi me sovranitet të cunguar, fundja as ushtrinë nuk po mund ta formojmë për shkak të saj, këta ia japin të drejtën e vetos edhe në Qeveri.

Pra, një force politike që i fiton votat duke treguar se është kundër Kosovës si shtet me ushtri, ju e bëtë pjesë të Qeverisë, e ia dhatë forcën e vetos në të. E deputetët e të nominuarit për ministra të Listës serbe janë pjesë e këtij spoti televiziv të mbushur me gjuhën e urrejtjes, spot për të cilin janë dënuar me 25 mijë euro. Aty po ashtu dëshmohet se mu ata janë kundërshtarët më të mëdhenj edhe të vetë serbëve të Kosovës, që nuk janë me ta, por janë me Kosovën.

Në të njëjtën kohë, PAN-i, duke marrë Listën serbe në koalicion i godet seriozisht këta qytetarë potencialisht lokalë me shtetësinë e Kosovës, në vend se dialog i brendshëm me pakicat, nënshtrim ndaj Beogradit dhe goditje e çfarëdo pozitiviteti, apo shansi për integrim të pakicave serbe në Kosovë.

Ramushi e Kadria më tamam e kishin bërë veç edhe Ministrinë e FSK-së po t’ua kishin dhënë, përveç asaj të Bujqësisë. Por, për Listën serbe kjo s’ka rëndësi. Edhe ashtu e kanë të drejtën e vetos, me Pakon e Ahtisarit në Parlament, e me Ramushin e Kadrinë në Qeveri. Më 12 qershor, Slavko Simiq, i cili është nënkryetar i Kuvendit, ka thënë se Lista serbe ka marrë mbi 40 mijë vota, duke e shënuar një rekord të ri. Ai ka shtuar se “në

Parlamentin e ardhshëm të Kosovës do të ketë mjaft deputetë për t'i ndaluar ndryshimet e Kushtetutës së Kosovës, ndryshimet e shtetit tonë, pra Serbisë, dhe ndalimin e formimit të, siç thotë ai, të së ashtuquajturës Ushtri e Kosovës”.

Më 1 gusht, ky deklaroi se “kurora e të gjitha kërkesave tona është formimi i ‘Zajednicës’ sipas marrëveshjes ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel dhe nga kjo ne nuk heqim dorë”. E për këtë edhe Gjykata Kushtetuese është deklaruar se është kundërkushtetuese, dhe ata e përfundojnë me “... shteti ynë është Serbia, tjetër shtet nuk kemi dhe as nuk e kërkojmë.”

Në vend se disa prej tyre të gjenden në burg për minimin e shtetësisë së Kosovës dhe shërbimit të interesave të një shteti që në baza ditore e cenon sovranitetin dhe integritetin territorial, apo bën plane për pushtimin e sërishëm të Kosovës, apo të pjesëve të saj, ky koalicion, pra koalicioni PAN, vetëm për shkak të interesave të disa prej liderëve të vet i dhanë pra Listës serbe timonin e drejtimit se kah do të shkojë vendi ynë. Në vend të luftimit të strukturave paralele, këta i përqafojnë, e pastaj edhe i bëjnë faktorë të patejkalueshëm.

Po qe se ne këtu do ta sillnim ligjin me të cilin nga deputetët dhe pjesëtarët e Qeverisë kërkohet të nënshkruajnë deklaratë nëse janë apo nuk janë pjesë e shërbimeve të huaja të inteligjencës, sa prej tyre do ta nënshkruanin, sa prej tyre do të përgjigjeshin para ligjit, nëse nuk e deklarojnë të vërtetën? Që nga zgjedhja e kryeparlamentarit, e edhe kryeministrit me vota ekskluzive të Listës serbe, domethënë të Beogradit, Kosova po kalon nga gjendje jo të zakonshme, anormale, në gjendje të jashtëzakonshme.

Populli thotë “çdo e mirë e ka edhe një të keqe, e çdo e keqe e ka edhe një të mirë”, por kjo i ka edhe rreziqet e veta. E mira e kësaj situate është se shoqëria jonë po kalon drejt një zhbllokimi mental, në të cilën ju e patët futur për më shumë se një dekadë. E zhbllokimi mental po shkakton panik, prandaj edhe ju keni nevojë për të kërcënuar, herë kështu e herë ashtu. Kësaj radhe, kryetari i Kuvendit kërcënon me dosje. Paramendoni, kryetari i Kuvendit i kërcënon deputetët me dosje, që edhe po të ekzistonin, janë mbledhur jashtëligjshëm. Burra e gra, mbylleni gojën se paska vendosur të flasë kryetari i SHIK-ut. Edhe shoqëria civile, edhe mediet, shiheni çfarë po flitni, për shkak se dikush paska dosje për ju!

Kurse, sa për shantazhin e Listës serbe, vetë vizita në Rusi e segmenteve të caktuara, vetë vizita e pjesëtarëve të Qeverisë në Rusi kallëzon për pavarësinë e tyre nga Qeveria. Kurse, në momentin kur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, në mungesë të argumenteve ka patetizëm, patriotizëm, nacionalizëm, diskutime, por unë dua diçka të ju them, pa të keq. Të mos ju kapë kasaveti se as Rusia, as Serbia, më s'kanë çka lypin këtu. Është kryer ajo punë. S'ka mbetur Kosova ta mbani të lirë as ju si "Vetëvendosje", as LDK-ja, as PDK-ja, po Kosova është çliruar. Hajde, ta zhvillojmë. Të merremi vesh qysh ta zhvillojmë. Mos shitni patriotizëm për t'i treguar dikujt përralla me mbret. As nuk është duke u frikësuar populli prej Serbisë, as nuk ka shteg që hyn Serbia këtu. Këtu është NATO. Dhe, s'jemi më ne ata që e mbrojmë gjithë atë sovranitet që po e kërkon ju, por mendoj politikisht. Puna jonë më e madhe është të merremi me të drejtat e atyre që po i kontestojnë ndërkombëtarët, të tjerat janë të parëndësishme.

Kemi praktika sot në Evropë që nacionalizmi e ka rrokur punën përpara, fjalët e mëdha e kanë rrokur... unë s'kam kurrgjë kundër. Jeni rritur si "Vetëvendosje", keni për t'u rritur ndoshta prapë, prapë është drejt, por po ju them - rrituni me idenë e zhvillimit të Kosovës, e jo me idenë e do farë tradhtive, se nuk ka këtu tradhti. Krejt kush është këtu, duke i përfshirë edhe ata që s'janë dhe që po i shani gjithë ditën, thuajse... po çka mund të na bëjnë ata dy? Çka mund të bëjnë ata neve? Pse po qitni petulla në ujë? Çka mund të bëjnë më ata neve? Kanë bërë mjaft 100 vjet. Janë hequr! Udhë e mbarë asaj politike, rruga e mbarë atyre që na kanë bërë! Tash jemi ne këtu. Nëse s'gjejmë rrugë të merremi marrë vesh ndërmjet vete, dijeni që, prapë po ju them, me forca s'kanë për të hyrë, por për të na bërë copë-copë ndërmjet nesh kanë për të na bërë. Bëni çfarë të doni!

A dëshiron replikë, a?

XHELAL SVEÇLA: Zoti kryesues!

Është për të qarë nga vetë fakti që ju shpresoni dhe keni ymyt në NATO-n që ju mbron, e nuk mundoheni të krijoni mekanizma që ne ta mbrojmë vetveten. Do të thotë, ju shpresoni në NATO, kurse çfarë ka mundësi Serbia të na bëjë, ne po e shohim për çdo ditë. Po e shohim edhe me "Zajednicë", e cila do ta bosnjëzojë Kosovën, ashtu siç edhe e ka lënë Bosnjën të varur prej Serbisë, të njëjtën gjë do t'ia bëjë edhe Kosovës, duke e lënë të varur prej Serbisë, qysh jeni ju të varur prej Listës serbe. Ju po e lejon edhe të ardhmen e Kosovës të jetë peng i Serbisë.

Normalisht, që kjo nuk do të ndodhë për shkak se të paktën një fakt po e pranoni: Lëvizja "Vetëvendosje" është rritur, Lëvizja "Vetëvendosje" do të rritet dhe krejt këto procese të mbrapshta, të cilave ju po u jepni rrugë, ne do t'i ndalim.

KRYESUESI: Është e vërtetë që me veprimet tuaja, ju e keni ndalur procesin e integritetit të Kosovës në Evropë dhe me veprimet tuaja e keni ndalur demokratizimin e Kosovës. Uroj që të demokratizoheni edhe ju!

Po them prapë, Kosova është e lirë, ka për të mbetur në NATO dhe mos u bëj merak për atë punë dhe, as “Zajednica”, as Lista serbe, as Partia e Vuçiqit, as Partia e Putinit, s’kanë shans të hyjnë këtu. Harroje ti dhe le ta harrojnë të gjithë ata që ëndërrojnë. Kanë ndryshuar gjërat. Ne jemi të orientuar si komb dhe si popull dikah krejt tjetër. Andaj, nuk kemi nevojë, po them prapë, që t’i shesim mend njëri-tjetrit dhe të bisedojmë, të flasim këtu për interesa elektorale. Po diskutojmë për të metat e procesit dhe të procedurës, që ka të bëjë me seancën e kaluar, seancën themelore të krijimit të Qeverisë.

Të metat t’i diskutojmë, por të mos e shfrytëzojmë këtë foltore thuajse gjysma e rreshtave paskan hyrë në Serbi dhe po punuakan me Serbinë, po bëkan pazare me Serbinë, po shitkan, po blekan, se shiko, nuk kanë çka shesin, se as ti, as ata që s’i lejojnë, e veçanërisht gjenerata e re, jo unë e ti që jemi thinjur, nuk do ta lënë kurrkënd për ta shitur Kosovën. Mos u bëj merak!

Ne mund ta shesim dhe mund ta shesim dhe kemi për ta dëmtuar me këto mend, me mendtë që po i dëgjon njeriu në këtë Parlament, po i dëgjon njeriu nga njerëz që janë përfaqësues të popullit dhe nuk po përpiqen të gjejnë zgjidhje dhe zgjedhje të cilat e çojnë popullin përpara, por po duan të gjejnë fajtorë. Hajde t’i gjejnë fajtorët! E tha, përjashto ato sharjet e Milaimit, s’po dua... por, çështjet tjera, i tha shumë mirë: hajde të bëhemi bashkë që fenomenet negative në këtë vend t’i emërtojmë me emër e mbiemër, pra me argumente, t’i çojmë ku e kanë vendin. Veç kështu e zhvillojmë vendin!

Për t’u distancuar nga të metat, nga gabimet e njerëzve, të cilët duke qenë të pushtetshëm e kanë keqpërdorur edhe djersën e qytetarëve, edhe buxhetin e popullit, edhe krejt. Derisa ne të bëjmë thirrje për ta bërë një ushtri për ta sunduar dikë këtu brenda, e keni gabim.

Shiko, unë nuk kam kurrgjë kundër, por ta ndajmë, të mos hyjmë në tradhti, se s’ka tradhti. Të mbetemi te çështja e zhvillimit të Kosovës. Të mbetemi te çështjet ideologjike të zhvillimit të Kosovës, po. Por, jo bre me tradhti, me nacionalizëm... se shiko, gjeneratat dikur... më falni... e krevan... E ka keqpërdorur... Ismeti... më falni!

Fjalën e ka Korab Sejdiu, po qe se dëshiron të diskutojë. Unë, a?

(Diskutime, polemikë)

I radhës është Anton Quni, këtu është Donika Kadaj. A është këtu? S’është! Rexhep Selimi, s’është! Adem Mikullovc, s’është! Shqipe Pantina është. Shqipja, atëherë.

KORAB SEJDIU: Qytetarë të dashur,

Meqë është hera e parë që po dal në këtë foltore, fillimisht ju falënderoj për mbështetjen dhe mundësinë që ma keni dhënë për të qenë zëri juaj në këtë foltore.

Çështja e dytë besoj që duhet të përmendet është një ngushëllim i sinqertë për miqtë tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe popullin amerikan, për një tragjedi të jashtëzakonshme që ka ndodhur mbrëmë, më duket në Las Vegas. Kështu që besoj se edhe ju më bashkëngjiteni në ngushëllimet më të sinqerta.

Është edhe një rast tjetër për ngushëllime, për vdekjen e albanologut dhe mikut shumë të madh të popullit shqiptar, Robert Elsie.

T'i kthehem asaj për çfarë kemi ardhur këtu. Dita e sotme u fillua, si të themi, me një kërkesë që opozita të jetë konstruktive dhe të them të drejtën, nuk e di si mund të kërkohej konstruktivitet prej opozitës, kur vetë kryeministri erdhi këtu dhe në mënyrë shumë dekonstruktive e tregoi një arrogancë të pashoqe, kur vendosi që ta tërheqë tërë Kabinetin qeveritar nga institucioni, që ai e ka obligim kushtetues për t'i dhënë llogari.

Ndoshta arroganca i ka kryer punë në qarqet në të cilat ka vepruar deri më tani, por në këtë institucion nuk besoj që arroganca ka vend dhe veçanërisht për një Qeveri që është në këmbë të xhamit, dhe që është shumë e ndjeshme sa i përket qëndrueshmërisë. Roli i kryeministrit dhe i Qeverisë duhet të jetë i tillë që duhet të sigurojë mbështetje, e veçanërisht përkrahje ndër grupet politike që ekzistojnë këtu. Pra, shumë më shumë suksese do të sigurojë Qeveria, edhe mbështetje, sikur ata ta marrin rrugën e miqësisë, e jo rrugën e krijimit të armiqësisë politike.

Ne ju ftuam sot këtu, edhe e shikova rendin e ditës, ka të bëjë me diskutimin e parimeve qeveritare, por fatkeqësisht janë gjashtë rreshta për atë që Qeveria synon ta ketë njëherë nga shtyllat kryesore, që është sundimi i së drejtës, ose sundimi i ligjit, siç po i themi. Gjashtë rreshta, e për të qenë fer, janë edhe dy fjalë që dalin në rreshtin e shtatë dhe, fatkeqësisht, me përjashtim të nja shtatë fjalëve, të tjerat janë vetëm slogane elektorale, po nuk kanë kurrfarë substance. Do të thotë, janë nja shtatë fjalë krejt.

Kështu që, me keqardhje, kërkoj lejen për të dalë jashtë asaj dhe me për të kërkuar substancë në programin qeverisës, që e di se ndoshta është jashtë rendit të ditës, por... urdhëro! Po, pasi veç i dëgjova të gjithë duke folur, edhe për fushatë elektorale, edhe unë po e diskutoj çështjen e parimeve, duke nxjerrë kuptim në programin që na e keni dorëzuar.

Qeveria? Po, mbasi s'i kam këtu t'u drejtohem, por shpresoj që nëpërmes foltores e përçojmë informatën.

(Ndërrhyrje, polemikë)

Çështja dhe roli i Qeverisë në sistemin e drejtësisë në Kosovë është jashtëzakonisht e rëndësishme. Qeveria e ushtron rolin në sistemin e drejtësisë nëpërmjet tri mjeteve: buxhetit; legjislationit dhe mbikëqyrjes të disa nga sektorët që e përbëjnë sistemin e drejtësisë, siç është sistemi korrektues dhe disa nga profesionet e pavarura.

Sikur të ishte Qeveria sot këtu, do t'i kisha pasur disa pyetje: Ku është qasja gjithëpërfshirëse për një reformë të thellë të drejtësisë? Sa po planifikoni të keni buxhet të ndarë për sektorët e ndryshëm që e përbëjnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, përfshirë edhe Gjyqësorin, përfshirë edhe Prokurorinë, e kështu me radhë...

A do ta lini anash me një përqindje të vogël, diku 1% të buxhetit, apo vërtet do të tregoni se jeni të përkushtuar për një drejtësi funksionale duke vendosur dhe duke alokuar mjete buxhetore të mjaftueshme? Ku janë specifikat?

Nëse flet për lëndë që janë grumbulluar nëpër gjykata, ku janë specifikat se si do t'i eliminoni këto pritje disavjeçare për një lëndë të vetme, të thjeshtë, për t'u zgjidhur? Ku është mbikëqyrja dhe llogaridhënia? I kemi të gjitha këto elemente të drejtësisë, të cilat në fakt operojnë të pavarura, por nuk kanë mbikëqyrje. Edhe atë mbikëqyrje institucionale që e kanë, nuk e kanë të funksionalizuar.

Për përfundim, po kthehem te ajo që e thashë në fillim. Ta keni parasysh, edhe Qeveria, edhe pozita në këtë rast, që të vetëm, edhe pse ndoshta numrat i keni deri diku, e ndoshta edhe s'i keni, të vetëm e keni të pamundur t'i shtyni gjërat përpara. Nuk mund të flitni as për shëndetësi, as për arsim, as për ekonomi të zhvilluar, përderisa problemin kyç, problemin bazë të këtij vendi nuk e adresoni në mënyrën e duhur.

Sa unë e pashë, për ju drejtësia nuk është primare, sepse në 12 faqe i keni shkruar gjashtë rreshta e dy fjalë për këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sala Berisha-Shala e ka fjalën. Më fal, me radhë, se këta janë paraqitur, e unë kam harruar që i kam në letër. Pas Teutës e ke, sipas radhës.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara medie,

Qytetarë të Kosovës,

Po dal, meqenëse m'u thirr emri, po vërtet unë konsideroj që kjo ditë e sotme dhe ky debat është kot. Është kot, sepse është jashtë aktuales të vazhdohet me një debat parlamentar të lënë në gjysmë më herët, që vetë ka kërkuar opozita për ta ndërprerë dhe tani sot e patëm rastin të dëgjojmë lloj-lloj diskutimesh, “dikush për lisa, e dikush për fshesa”.

Unë do të përpiqem të mos e zgjas fjalën time duke ua rikujtuar, të nderuar kolegë deputetë, se secili që jemi këtu në grupet tona parlamentare, po edhe si individë, kemi bukur shumë votues prapa që me padurim presin punën, funksionalizimin e punës në Kuvend. Jam shumë e bindur që edhe ju e dini se qytetarët e Kosovës kanë pritur që fillimi i punës së Kuvendit të Kosovës të jetë më ndryshe sesa u pa sot.

Unë besoj që në këtë sallë, në të gjitha grupet parlamentare, ka deputetë me integritet, të cilët do t'i thërrasin mendjes, arsyes dhe do të jenë në harmoni me besimin që e kanë marrë nga qytetarët, që ta fillojmë punën sa më parë dhe janë të vetëdijshëm se qytetarët e Kosovës kërkojnë mbi të gjitha një sundim të ligjit, një zhvillim ekonomik, që domethënë hapje të vendeve të punës. Qytetarët e Kosovës, mbi të gjitha, kanë nevojë për lëvizje të lirë, për liberalizim të vizave. Të gjitha këto punë ne mund t'i bëjmë vetëm në qoftë se jemi bashkë të gjithë, pavarësisht pozitë dhe opozitë.

Më lejoni ta citoj një grua malësore, që iu drejtua Parlamentit të Kuvendit të Shqipërisë dhe e përktheu kështu përbërjen parlamentare. “Qytetarët janë të djathtë, se punojnë me dorën e djathtë”, këtu kemi përcaktime të djathta. “Qytetarët janë edhe të majtë”, siç është zemra. “Qytetarët janë edhe të qendrës”, që mendojnë me kokë. Prandaj, përfaqësimi i qytetarëve në Kuvend është i tillë, të majtë, të djathtë dhe të qendrës.

Rezultati i zgjedhjeve të 11 qershorit veç e ka dëshmuar këtë që po e them tash, sepse pothuajse të tri grupet parlamentare dolën me pothuajse të njëjtin rezultat që e dhanë qytetarët e Kosovës.

Unë sot nuk jam ndier mirë në këtë debat që u dëgjua sot këtu, me akuza reciproke krejtësisht të panevojshme, që foltorja e Kuvendit u shndërrua edhe në gjykatore. Ne i kemi tri shtyllat kryesore, s'po dua të hyj më tutje, se të gjithë e dini. Unë pres të jemi bashkë në çështje të cilat janë për interesin e Kosovës dhe kemi shumë çështje të tilla para nesh. Nuk kemi kohë për të humbur!

Sot ky debat u shndërrua në ring, në arenë gladiatorësh. Sot ky debat u shndërrua edhe në “Show Meseletion”, që dëshiroj të jetë i pari dhe i fundit i kësaj legjislature.

Unë jam në Legjislaturën e Pestë në Kuvendin e Kosovës dhe më besoni, asnjëherë nuk jam ndjerë më keq se sa tani, që po e shoh se kah do të shkojë kjo legjislaturë. Uroj që të mos dalin parashikimet e mia të parat! Ju ftoj të gjithëve, kolegë deputetë, të punojmë bashkërisht për të mirën e qytetarëve të Kosovës! Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

Kryesuesi: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën ia jap deputetes Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kështu vjen radha, nganjëherë pozita, nganjëherë opozita në ulësen e kryetarit të Kuvendit. Po kështu i vjen radha nganjëherë edhe opozitës për të qenë në pozitë. E tani, kësaj radhe duhet vërtet të mësoheni, kolegë të nderuar deputetë, për të qenë edhe në opozitë. Bile-bile, unë ju lakmoj, se shumë herë keni hapësirë më të madhe. Edhe ju do të duhej të jeni vërtet ata kujdestarët e Qeverisë.

Por, jua jap fjalën këtu para të gjithë qytetarëve se do të jemi opozitë për secilin dikaster që nuk do të punohet në rregull. Asnjëherë nuk do të pajtohemi me atë, thjesht, nëse tentohet të devijohet. Por, jam shumë e sigurt që do të mbahet në mend, jo vetëm për punë, por për punë efektive, jo për fjalë dhe fjalë pa kuptim dhe pa përmbajtje.

Vitin e kaluar, Kuvendin e Kosovës e vizituan nxënësit e shkollës “Kelmend Rizvanolli” nga Gjakova. Për ata që nuk e dinë, është një shkollë që është ndërtuar me kontributet e familjes Kelmendi, pra Rizvanolli, kontribut i familjes, të cilët nuk ishin trashëgimtarë, por që në atë shkollë është një kolektiv më shumë se 25 mësuese të nderuara dhe udhëhiqen nga një drejtoreshë shumë e suksesshme. Mbi 100 fëmijë ishin këtu ulur në ulëset ku jemi sot ne, por sinqerisht po ju them, ka pasur edhe nga stafi i Kuvendit që e kanë përcjellë atë takim, sikur të kishit qenë edhe ju të pranishëm e ta kishit dëgjuar interesimin e tyre për çështjet që sot në këtë seancë nuk u diskutuan. Klasa e pestë e shkollës fillore!

Interesimi i tyre ishte larg-larg se sot i deputetëve të Parlamentit të Kosovës dhe unë uroj që ata fëmijë të mos e kenë parë sot këtë seancë. Kjo seancë “e jashtëzakonshme”, maratonike, “hajt pak”, me pikën jashtë rendit të ditës, në seancat e rregullta e kemi pikën “hajt pak” që i ka 30 minuta, kurse sot kjo ishte seancë “hajt pak”.

Hyrja në këtë seancë ishte fyerje, sharje, fjalë banale, që më vjen turp t’i dëgjojnë, t’i dëgjojnë familjet tona, e çka jo tjetër, muskuj, kush më i fortë e kush më i dobët. I keni arenat, kush do të qërojë hesape qëroni në vendet ku nuk ju shohin qytetarët, qëroni atje ku edhe keni filluar.

Cila ishte tema që u shtjellua sot? E gjithë tema, 90% të diskutimeve sot në Parlamentin e Kosovës, në këtë foltore, me përjashtim sinqerisht, zoti Rugova, diskutimi juaj ishte për lakmi. Me përjashtim të disa diskutimeve, 90%, po ta shohim transkriptin, se është transkripti, mund ta marrin edhe qytetarët, gjithë tema ishte “bashkësi boshe”. Bashkësi boshe, gjithë tema e diskutimit. Dhe fundi, herë në program, e herë në parime.

Të nderuar deputetë, rezultati i 11 qershorit ishte ai që ishte. Nuk kishte fitues, të mos harrojmë... Nuk kishte fitues, askush nuk ishte fitues. Fitues është Edi Rama në Shqipëri, këtu s'ka fitues. Për ta bërë Qeverinë do të duhej sikur ka ndodhur edhe në qeveritë e kaluara.

Mandatin e kaluar e kishim një qeveri me numra sa të doni, por pa rezultate dhe atë, rezultatet që ishin u pa, sepse nuk shkoi deri në fund, por ishim një opozitë që i ndalëm shumë çështje, të cilat ju them edhe sot këtu: asnjëherë, asnjëherë nuk do ta ndërroj mendimin për asnjë gjë që e kam thënë dhe asnjëherë nuk do ta ndërroj mendimin tim që e them publikisht. Prandaj, nuk është me rëndësi ku je, me rëndësi është të kesh dinjitet, të kesh parime njerëzore, e sa janë parimet njerëzore le t'i vlerësojnë qytetarët.

U fol herë për gjashtë reshta, e herë për dhjetë faqe, herë për 120 faqe, herë për 130 faqe. Sinqerisht, spektakël. Për çka po flasim, jo ke qeveria, jo s'ke qeveria, erdhi qeveria, megjithatë për ata që nuk e kanë përcjellë mbledhjet e Qeverisë. I është thënë që të gjithë ministrat të jenë prezentë në seancat e Kuvendit dhe, mbi të gjitha, Qeveria do të duhej të na raportojë neve si Kuvend, ne jemi ata që e monitorojmë Qeverinë, por sot nuk e deshëm Qeverinë këtu, sepse për ta dëgjuar kështu, thashë nuk kisha dashur as ata fëmijët e Kelmend Rizvanollit të na dëgjojnë, e le më dikush tjetër sot.

Flasim për program, për program, nesër apo pasnesër është një rend tjetër i ditës, ku janë pikat me radhë, pra, e që për deputetë që janë të rinj e nuk është turp të mos dish, ju them që të gjitha pyetjet që hoqët keq e i thatë këtu, bëni pyetje me shkrim, drejtohuni kryeministrit, ministrave, të gjithëve, e keni të drejtën tuaj, është krejt normale, është krejt legjitime dhe kështu i mbajmë të përgjegjshëm edhe ata që tentojnë të mos jenë të përgjegjshëm.

Dhe, tani ka filluar edhe fushata, fushatë dhe sinqerisht kryetari i Kuvendit shkoi, nënkryetari një kohë të gjatë e la, si të mos ishte fare këtu, ama fare si të mos ishte, jashtë temës, jashtë rendit të ditës dhe në bazë të Rregullores u dashkej ta ndërprejmë fjalën kur jemi jashtë rendit të ditës. Nuk ishte një shprehi e mirë, nuk do të duhej të dalim, sepse e kemi Rregulloren e Kuvendit, kur është jashtë rendit të ditës do të duhej të ndërpritet fjala.

Sot kam përshtypjen që as deputetët nuk e ditën për çka po flasim. E sa për t'u takuar me ato 40 nënshkrime, ne kemi ardhur sot nëse ju ka marrë malli të takohemi si deputetë, por nëse bëjmë fushatë, atëherë flasim për komuna veç e veç, ku doni dhe ju them shumë sinqerisht që nuk do t'i keni as edhe një komunë, as edhe një komunë që do të udhëhiqet nga "Vetëvendosja". Jua them këtu, nuk do ta keni as edhe një komunë të vetme, do të jemi dëshmitarë më 22.

Dhe, për të tjerat, normalisht që janë qytetarët që do të vlerësojnë, por me të gjitha fyerjet, sharjet e të gjitha ato, më populli nuk pranon.

Mund të flasim, por të flasësh nën moshën 18 vjet llogaritesh që je fëmijë, mbi 18 vjet përgjegjësia është edhe ligjore. Sinqerisht fjala publike për mua ka peshë dhe mashtrimet nuk do të duhej të ndodhin, e aq më pak në foltoren e Kuvendit.

Se ku do të shkojmë, sinqerisht sot kjo seancë ka treguar që Kuvendi nuk është në rrugën e drejtë.

Një opozitë e respektuar, e respektuar në numër dhe jam shumë e sigurt që vërtet ka deputetë brenda opozitës që janë të respektuar dhe që kanë dinjitet dhe që kanë parime njerëzore, por mënyra dhe sjellja e disave është sinqerisht një shembull jo i mirë dhe ndonjëherë vetëm duhet vërejtur se si hyjnë prej derës e deri në ulëse. Edhe veshja, të nderuar deputetë, edhe fjala, edhe veprimet e një deputeti do të duhej të jenë shembull edhe për ata që nesër pretendojnë të jenë në ulëset tona, që të na zëvendësojnë neve, sepse të përjetshëm nuk jemi.

Prandaj, edhe një herë sot, krejt në fund, do të thosha, si thotë një fjalë e urtë: "Qysh me dal prej kësaj situate". Qysh të dilet, si është fundi i këtij debati, çka? Ky hymë e ku po dalim? Cilat janë përfundimet? Jemi në fushatë, e pranoj, jemi në fushatë dhe secili prej nesh jemi duke dalë në terren, por të mos e keqpërdorim këtë foltore.

Dhe për programin e Qeverisë, të gjithë jemi dëshmitarë, nuk mund të thuhet diçka çka s'e kemi pasur në dorë. Mandatin e kaluar e di mirë kur ka ardhur programi qeverisës i qeverisë Mustafa. Sa ishte e dështuar ajo, e kemi parë. Kur ka ardhur me afat kohor, për atë janë shënimet, nuk mund të themi diçka çka nuk ka ardhur.

Ky program, megjithatë, ai që është, ka ardhur në afat rekord, se çka ka brenda, ne duhet ta diskutojmë, ne duhet të japim sugjerimet dhe, në fund të fundit, për këtë kemi ardhur këtu në Parlamentin e Kosovës.

Prandaj, ju kisha lutur që diskutimet tona sinqerisht të jenë me përmbajtje. Fyerjet, sharjet, të gjitha të tjerat le të mbesin në ndërgjegjen e secilit veç e veç. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zonja deputete, ke qenë dy mandate në opozitë dhe e di çka ke diskutuar. Unë nuk jam redaktor i fjalimeve këtu, po jam ta mbaj rendin dhe vetëm nëse ka fyerje të rënda, unë ia ndërpres dikujt fjalën. Interpretimet sipas mënyrës qysh diskutojnë deputetët nuk janë çështje imja.

Zonja Pantina, e ke fjalën.

SHQIPE PANTINA: Mirë pasditja të gjithëve, se dita tashmë shkoi.

Unë kam planifikuar të flas, në fakt, për temë që është në rend të ditës sot, që është parimet, dokumenti, i cili quhej “Parimet e qeverisjes”, po askush deri më tash nuk foli për këtë temë, kështu që nuk e di nëse unë flas për këtë temë, ai i bije që nuk po e di si bëhet muhabeti në Kuvend, apo po tentoj që të kthehet tema dhe të flasim për atë çka jemi thirrur.

Secili deputet që doli këtu na shiti neve tjerëve që ishim ulur mend e moral se për çka duhet të flasim, cila është tema, qysh nuk duhet të fyejmë e të shajmë, po në fakt, secili nga pak e ka bërë edhe vetë.

E kjo mendoj që është edhe për faktin se tema, e cila do të duhej të diskutohet sot, e që është “Parimet qeverisëse”, u shkel fillimisht, se po të ishte kryeministri dhe Qeveria këtu jam e sigurt se shumica e deputetëve, nëse jo të gjithë, do të flisnin për atë dokument, por kur iku ai, natyrisht se mandej filluam të flasim me njëri-tjetrin edhe duke devijuar nga temat.

Ishte vetë edhe kryeministri i tashëm Haradinaj, atëherë deputet, i cili e kritikonte Qeverinë Mustafa, për mungesë të llogaridhënies ndaj Kuvendit, sepse të gjithë e dimë se problemin më të madh që e kemi pasur si deputetë ka qenë mospranim e Qeverisë për të dhënë llogari para këtij Kuvendi.

Thuhet: “Dita e mirë shihet në mëngjes”, e kryeministri Haradinaj qysh në ditën e tij të parë e shkeli parimin bazë, e që është dhënia llogari Kuvendit nga Qeveria. Prandaj, nuk di se çka më tutje mund të flasim për llogaridhënie.

Po ashtu, nuk na u prezantua programi qeverisës, për të cilin zakonisht kryeministri dhe Qeveria e kërkon votëbesimin e deputetëve.

Kryeministri erdhi atë ditë, prezantoi një dokument 12-faqesh, të cilin e quajti “Parime” dhe prezantoi emrat e ministrave që do t’i udhëheqin ato dikastere dhe tha se do t’i duhet kohë për të identifikuar problemet dhe për ta hartuar programin qeverisës.

Në fakt, të gjithë që janë në politikë e dinë se programet e qeverisë hartohen para fushatës zgjedhore. Në fushatë zgjedhore partitë garojnë me program qeverisës dhe për këtë e kërkojnë edhe votën e qytetarëve.

Zoti Demalijaj po thotë se koalicioni. Nëse nuk keni pasur kohë që ta hartoni programin qeverisës para se ta bëni koalicionin, sepse kjo është tema zakonisht për të cilat diskutojnë partitë politike kur ulen për ta ndërtuar një koalicion. Ju i kishit edhe 10 ditë fushatë, as ato nuk i shfrytëzuat për të hartuar dhe për të prezantuar dhe për të kërkuar votën e qytetarëve me atë program. I patët 100 ditë, për të cilat ju keni mundur t’i shfrytëzoni pastaj për ta hartuar atë program qeverisës, pasi tashmë dihej rezultati zgjedhor, as atë nuk e shfrytëzuat.

E si t’u besohet tash që ju në 100 ditët e ardhshme të qeverisë do të prezantoni program, e pastaj do të mund ta zbatoni atë, kur fillimisht nuk ishit në gjendje për 100 ditë ta hartoni atë.

Kjo Qeveri përbëhet afërsisht prej 30 partive politike, përveç “Nismës për Kosovën”, e cila është deklaruar parti e qendrës së majtë, partit e tjera janë deklaruar verbalisht se janë parti të qendrës së djathtë, zakonisht partitë e qendrës së djathtë njihen, ndër të tjera, edhe për qeveri të vogla në numër.

Kjo Qeveri le që nuk e zvogëloi numrin e ministrave, e Qeverinë e kaluar e pati kritikuar thellë, rëndë, duke e quajtur herë Qeveri megalomane e herë kineze, por në fakt, e bëri të kundërtën: e rriti edhe më tutje numrin e ministrive.

I kemi katër apo pesë zëvendëskryeministra. Tash nëse me këtë logjikë pesë, Ganimete, faleminderit për korrigjimin, sepse thënë të drejtën, ende nuk po i njohim, nuk po i dimë, se nuk i kemi parë, nuk na kanë ardhur të prezantohen.

Pra, një kryeministër me pesë zëvendëskryeministra, nëse ndiqet e njëjta formulë, se në Qeverinë e kaluar kemi pasur një kryeministër me dy zëvendëskryeministra, edhe tre me atë të minoriteteve dhe pastaj për secilën ministri kemi pasur edhe nga tre zëvendësministra.

Nëse ndiqet e njëjta logjikë, pra për secilën ministri ju i emëroni edhe nga pesë zëvendësministra, atëherë kjo Qeveri do t’i ketë të paktën 105 zëvendësministra. Po të

ishte kryeministri këtu, unë do t'i bëja një pyetje, e nuk e di a ka kohë ta përcjellë seancën edhe nëpërmjet ekranit, se me siguri ka shkuar në fushat, të mbledhë vota për zgjedhjet komunale, do ta pyesja se ku do t'i bënte ato shkurtime buxhetore për t'i paguar pagat e zëvendësministrave, këshilltarë politikë, shoferët e asistentët për të gjithë këta ministra e zëvendësministra, të cilët ai do t'i emërojë në bazë të formulës që e ka ndërtuar Qeverinë.

Korabi përmendi që për drejtësinë, tha që në parimet qeverisëse janë shkruar dy reshta edhe dy fjali shtesë.

Unë do të ndalem te një pjesë që e njoh pak më mirë, e që është administrata publike dhe qeverisja lokale.

Korab, të paktën për drejtësinë i kanë shkruar dy rreshta, për administratën publike zero reshta, asnjë fjalë të vetme, asnjë, zero. Shtylla kryesore për çdo shtet për të funksionuar është administrata. Administrata e Republikës së Kosovës është jashtëzakonisht me shumë probleme.

Kosova nuk i ka adresuar rekomandimet e Komisionit Evropian në fushën e përgjegjësisë. Rekrutimi i pabazuar në merita vazhdon të ndikojë negativisht në efektivitetin, efikasitetin dhe pavarësinë e administratës publike. Ky është një nga konkluzionet në Raportin e fundit të Progresit të BE-së për Kosovës. Shih faqen 10 deri në faqen 13. Pra janë tri faqe te Raporti i Progresit që flasin për administratën publike.

E, në parimet e kësaj qeverisje, pra, nuk është thënë as edhe një fjalë e vetme se si kjo Qeveri parasheh ta rregullojë çështjen e administratës publike.

Për më tepër, kryeministri, këtë ministri Qeveria ia ka lënë në dorë një partie minoritare.

Nuk kam asgjë kundër nga ky fakt, por në fakt, në ministri është emëruar ta drejtojë ministri Yagcilar, i njëjti ministër, i cili e ka drejtuar atë edhe në dy mandate më herët. Tash asgjë kundër, asgjë personale kundër ministrit Yagcilar, bile, t'ju them të drejtën, është ndër ministrat që ka ardhur për të raportuar sa herë që është ftuar në Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media. Por, për katër vjet radhazi, për dy mandate sa ministri Yagcilar ka qenë në krye të kësaj ministrie, për çdo vit rresht në Raportin e Progresit janë përmendur të njëjtat probleme me administratën publike. Pra, nëse ai nuk arriti për dy mandate radhazi të rregullojë problemet që janë në administratën publike, atëherë si po mundka t'i rregullojë tash, kur kryeministri nuk i ka afruar atij një plan të ri, një drejtim të ri, objektiva të reja se si duhet ta bëjë atë.

Të njëjtat probleme që i ka thënë Raporti i Progresit, po ashtu i thotë edhe raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, e besa edhe raportet e organizatave joqeveritare, vendore, që merren apo e monitorojnë punën e administratës, siç është për shembull raporti i GAP-it.

Pra, kemi një ministër, i cili për dy mandate ka dështuar ta drejtojë Qeverinë, administratën drejt reformimit dhe po ashtu kemi një Qeveri pa program.

E hiç më mirë nuk është gjendja as në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Edhe për këtë ministri, e cila sërish i është lënë në dorë një partie minoritare ta drejtojë dhe sërish asgjë kundër nga kjo, por prapë është e njëjta parti që e drejton, me të njëjtat probleme në qeverisjen aktuale, të cilat po ashtu ngjashëm përsëriten në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Pra, asgjë të re se si të rregullohet, si të reformohet shtylla e shtetit, e që është Administrata Publike, qoftë ajo e nivelit qendror, qoftë ajo e nivelit lokal.

Në fakt, në shumicën e shteteve në Evropë, por edhe këtu në vendet fqinje, e më së miri është shembulli i Shqipërisë, Edi Rama, një ndër reformat më të mëdha si kryeministër që e ka bërë, e që po rezulton të jetë e suksesshme, është ajo e reformimit të pushtetit lokal, pothuajse e ka përgjysmuar numrin e komunave.

Ne kemi komuna të cilat 82, e besa edhe 90% e buxhetit të tyre shkon thjesht për paga dhe mëditje, dhe janë natyrisht barë e buxhetit, i cili ndahet si grant qeveritar dhe Qeveria jonë nuk ka asnjë qasje, nuk ka asnjë plan se si do ta reformojë pushtetin lokal dhe administratën, e cila...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Anton Quni, Ilir Deda, replikë Shkumbini.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse m'u përmend emri, se nuk kisha diçka, se duke mos e njohur kolegen, me gjithë respektin që kam bile për koleget femra që janë në Kuvend, nuk e di çfarë profesioni ka. Duke e ditur se çfarë profesioni kam, kam dëshirë të di a jemi të barabartë për të biseduar për këto çështje, e respektoj nëse është e profesionit tjetër dhe nuk ndërhyr në këtë. Po flitet shumë, shkoi kryeministri, erdhi kryeministri. Kryeministrin e keni në çdo seancë të rregullt tani e tutje. Kjo seancë që po vazhdoni, e thashë është gabim, me 'acquis communautaire' nuk ka restitucion, nuk ka rikthim mbrapa, asnjë ligj nuk vepron në mënyrë atraktive dhe sidomos Rregullorja e Kuvendit.

Jemi thirrur, kemi ardhur t'jua bëjmë qejfin, jemi kthyer për një muaj mbrapa për të biseduar për diçka çka keni kërkuar. Krejt tjetër gjë është platforma e parimeve, tjetër gjë është programi qeverisës. Nuk është nami i madh për t'ju treguar se shteti nuk ka filluar as me ardhjen e “Vetëvendosjes” në Kuvend, po as timen në këtë rast këtu. Ka projekte afatshkurtra, afatmesme, afatgjata që ka marrë shteti përpara obligime edhe ndërkombëtare, ka fonde të ndryshme ndërkombëtare që i kem dhënë zotimet para atyre se si duhet të lëvizim, po në këtë rast shpresojmë se edhe ato objektiva që i ka pasur Qeveria Mustafa e më të hershme, e që nuk kanë përfunduar, edhe shteti i ka marrë zotimet, duhet t'i përfundojë dikush, po edhe ato që janë tonat do të vijë strategjia legjislative në Kuvend, do ta shqyrtojmë edhe atë, edhe krejt çka është e nevojshme, edhe plotësim-ndryshimet. Po ju them, po afrohemi, bashkëbisedojmë, i çojmë proceset përpara. Po flitet komandantët, ushtria e këta, gjithkund ku ka diçka të jashtëzakonshme në botë ndodh që ushtria e merr pushtetin derisa të rregullohen gjërat.

Mos t'ju vijë mërzë, është UÇK-ja, ushtria, komandantët, jemi të kësaj moshe bukur gjatë, prej të gjitha grupeve parlamentare do të shihen njerëzit, po fatmirësisht, kur kemi ditur të bëjmë diçka më herët të mirë, edhe mund të vazhdojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në rregull. Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit, kryesues!

Deputetë, kolegë të nderuar,

Neve na duhet urgjentisht finalizimi i përpilimit të Rregullores së re të Kuvendit, e cila duhet të përmbajë në vete edhe një kod më rigoroz të mirësjelljes.

Përndryshe, do të mbesim me inercion të tillë, jo vetëm edhe në këtë legjislaturë, por edhe në ato të ardhshmet, e kjo ka të bëjë me diskursin joargumentativ, e sa më shumë përgjithësues, me çka e legjitimojmë varfërinë intelektuale, faktikisht, edhe qytetarëve tonë u themi s'keni nevojë specifikisht të merreni me asnjë çështje, por vetëm me të përgjithshmen, e kjo duhet të përfundojë, duhet të përfundojë këtu. Të paktën, në këtë sallë t'i përmbahemi kësaj.

M'u kujtua prej këtyre diskutimeve, Xhavit, po më duket vetëm t'i ke qenë apo je ndër të paktit që jeni këtu prej vitit 2001. Në fund të vitit 2001-2002, në këtë Kuvend nuk kishte shumicë të zgjidhej kryetari i Kosovës. Edhe PDK-ja me AAK-në, atëherë ishin një bllok, dilnin prej Kuvendit dhe thoshin: “Ne nuk duam të votojmë një tradhtar”. Thoshin: “Le të shkojë LDK-ja me listën e Serbisë”, që atëherë ka qenë koalicioni “Povratak”. Çka është kjo sot. Faktikisht ne jemi qe 16 vjet duke u sjellë në një kornizë të njëjtë politike, Atëherë “Povratak”, tash Lista serbe, 16 vjet, zonja e zotërinj. 16 vjet po ndërrohen fytyrat, po diskursi po mbetet i njëjtë dhe po bie. E për këtë do të flas pak më vonë.

Ndërsa sa u përket parimeve qeverisë, të cilat janë dorëzuar, ato janë gjysmë parime, gjysmë synime dhe nuk mund të diskutohet për to në këtë mënyrë.

Megjithatë, prej parimeve të qeverisë se çka kemi parë del një strukturë qeverisëse. Domethënë, ato parime proklamojnë një qeveri, e cila i ka 24 pozicione politike dhe natyrisht që kryeministri duhet të jetë këtu të na sqarojë pse 24 pozicione politike? Pse? Pse ka mbërritur kjo Qeveri t'i ketë 24, ajo e kaluar i ka pasur 21, e kemi kritikuar atëherë si opozitë e bashkuar, pse 21 ministra e gjithë ata zëvendësministra, tash kemi mbërritur te 24-shi.

Mandej, të na sqarojë prej atyre parimeve qeverisëse, ku është logjika t'i kemi këto tri ministri: Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, dëgjoni këtë dhe, tjetra, Ministria e Zhvillimit Rajonal. Domethënë prej atyre parimeve qeverisëse ne kemi dalë te tri ministri, të cilat nuk e dimë pse i kemi. Strukturën e Qeverisë nuk mund ta diskutojmë në program, gjatë debatit për programin qeverisës, po dua tash, dhe për fund.

Gjithë ne e kemi dhënë këtu një betim dhe ai betim, të cilin e kemi dhënë, na thërret: a po bëhet që ta mbrojmë kushtetutshmërinë e Kosovës, integritetin institucional dhe këtu vjen deri te një problem, të cilin ma merr mendja, të gjithë e ndajmë. E ky problem ka të bëjë me diskursin publik politik të një partneri të koalicioni qeverisës.

Domethënë, çka na intereson neve është si mund të sqarohet pozicioni i deputetëve që i përkasin subjektit politik Lista serbe, të cilët e japin betimin në Kuvendin e Republikës së Kosovës, se do t'i përmbahen dhe do ta respektojnë Kushtetutën e Kosovës dhe, mandej kryetari i këtij subjekti politik, i cili është kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut, del jashtë edhe lobon kundër Kosovës. Kjo është ajo çka duhet të na interesojë. Ata natyrisht nuk janë këtu, e në çdo seancë duhet t'i pyesim: si e mbron ju një pozicion të pambrojtshëm politik? Edhe Republikë e Kosovës, edhe kundër Republikës së Kosovës, ta sqarojnë këtë çështje, është brengë legjitime. Ajo vjen për shkak të provokimeve të njëpasnjëshme që një partner, një parti politike, e cila është pjesë e Qeverisë së tanishme, e bën. Nuk është çështje e patriotizmit, është çështje e kundërthënies, domethënë e një skizofrenie politike në Qeverinë e Kosovës dhe nuk është hera e parë që ekziston, ka qenë edhe në të kaluarën e njëjta. Edhe në të kaluarën e kemi pasur brengë, e tash e kemi prapë.

Herën e kaluar i kemi thënë 'Qeveria e Rashkës', tash po i themi 'Qeveria e Vuçiqit'. Domethënë, ne po vazhdojmë me të njëjtën. Po dua ta sqarojmë këtë brengë, edhe ju e keni brengën e njëjtë, edhe të gjithë ne këtu së bashku.

Dhe, për fund, dobësia e programit 134 faqesh, i cili na është dorëzuar si deputetë. Edhe aty pak do të ketë hapësirë për diskutim konkret, sepse në atë program, i cili është proklamuar dhe është trumbetues si diçka, e cila do të jetë shumë konkrete që do të përmbajë veprimet në 100-ditshin e parë qeverisës, e gjëra të tjera, nuk gjendet asgjë konkrete, as buxhet konkret për reforma, as program i reformave. Edhe ajo është më shumë një lloj 134-faqëshi i synimeve, të cilat dëshiron t'i ketë Qeveria e sotme.

Më falni, po të paktën çka duhet bërë është t'u sqarohet anëtarëve të Qeverisë. Programi është totalisht ndryshe dhe nuk ka asgjë të përbashkët vetëm me synime. Kjo është ajo. Dhe, i gëzohem debatit të ardhshëm. Kur do ta kemi këtu shpresoj kryeministrin Haradinaj dhe të gjithë ministrat e diskutojmë për atë çka ne mendojmë që është program, çka duhet të jetë program dhe synimet të cilat ata i kanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Donika nuk është, Shqipja foli, Ali Lajçi, nuk është. Besa Baftiu, fjalën e ka Besa.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Për mua është mandati i dytë, për të cilën i falënderoj qytetarët që ma dhanë besimin që t'i përfaqësoj ata. Mirëpo arsyeja pse po e përmend është se më habit fakti se ka kolegë deputetë, veçanërisht kolegja ime, Teuta Haxhia, me të cilën kemi qenë në opozitë. Unë e di se tani Teuta e ka ndryshuar rolin, është në pozitë, por më habit fakti se i ka ndryshuar parimet e veta, të cilat i ka pasur kur kemi qenë në opozitë. E di se së bashku me të gjithë kolegët që kemi qenë në opozitë, kemi qenë zë kritik ndaj qeverisë, sidomos në mospjesëmarrjen në seanca dhe të njëjtën gjë e ka bërë edhe Teuta, e tani Teuta, siç thashë ka ndërruar rolin, e mbron qeverisjen. Nëse keni qenë kritike atëherë, duhet të jeni edhe tash.

Unë e di se duhet t'i përmbahemi faktikisht temës së seancës, unë u jam përmbajtur, mirëpo nuk kam mundur faktikisht të mos e përmend se si ka ardhur deri te kjo qeverisje, apo si ka ardhur shëndetësia në këtë gjendje prej pasluftës e deri më tash.

Kjo Qeveri nuk ka vizion dhe program, më së miri e tregon ky dokument i ashtuquajtur "Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës", që për sektorin shumë të rëndësishëm, siç është shëndetësia, janë shkruar vetëm gjashtë fjali të vetme, fjali të cilat janë të pakuptimta, të pakoordinuara dhe pa një sqarim të qartë.

Po e përmend një rën prej këtyre fjalive, po citoj: "Do të ketë përkujdesje shëndetësore për çdo individ që do t'u mundësohet nga një sistem i ri shëndetësor". Po nuk dimë se në

çfarë sistemi të ri shëndetësor kanë aluduar, a do të hiqet dorë nga sistemi i tanishëm, apo si? Në asnjë fjali nuk flitet për fuqizimin e shëndetësisë publike.

Me qeverisjen Haradinaj, duke parë se ky sektor shumë i rëndësishëm u lihet të udhëhiqet atyre që e kanë sjellë në këtë gjendje shëndetësinë si dhe në krye të këtij dikasteri emërohet një ministër që më së paku ka të bëjë me shëndetësinë, kjo le të kuptosh se do të vazhdojë gjendja e njëjtë në këtë sektor.

E një gjendje e tillë e rëndë në shëndetësi është tash e 18 vjet, sepse çdo herë ky dikaster është udhëhequr nga ministra që ose nuk kanë pasur fuqi politike, ose nga ministra që kanë punuar për interesin personal dhe partiak.

Menjëherë pas lufte Ministria e Shëndetësisë është udhëhequr nga Numan Baliq, e që de fakto, ishte Sekretar permanent i Ministrisë së Shëndetësisë, njeriu më i fuqishëm brenda kësaj ministrie.

Kjo periudhë e udhëheqjes dihet vetëm me afëra korruptive që janë bërë dhe luftën që bënë mes veti ministri me sekretarin, e ky i fundit i arriti të shkarkojë të parin.

Më pas në krye të Ministrisë së Shëndetësisë vjen Resmije Mumxhiu dhe më pas Sadik Idriz, të cilët nuk kishin fuqi politike, sepse ishte Sekretari permanent, i cili kishte shtrirë pushtetin qysh prej Qeverisë së Përkohshme të Hashim Thaçit.

Shëndetësia nuk e pati trajtimin e duhur as edhe kur u udhëheq nga profesionistë shëndetësorë, siç ishte profesor Alush Gashi. Në këtë periudhë, më shumë është marrë me vetveten sesa me çështjen e problemeve të shëndetësisë. Kjo periudhë njihet me skandalin e spitalit “Medikus”, spital, të cilit i është dhënë licenca po nga ky ministër. Në vitin 2011, kur shteti po udhëhiqej nga Qeveria Thaçi, ky dikaster iu besua Ferid Aganit, që dorën në zemër, pritjet nga qytetarët, por edhe punëtorët shëndetësorë ishin të mëdha dhe me bindjen se ishte njeriu i duhur në vendin e duhur. Mirëpo, në realitet ndodhi krejt e kundërta, sepse vetë ministri Agani, siç e dini, u përfshi në aferën “stenda” që tërë opinioni është i njohur.

Në qeverisjen e fundit LDK-PDK e udhëhequr nga ish-kryeministri Mustafa, në programin qeverisës të saj shëndetësia ishte prioriteti i pestë dhe aty e emërtuar si “Shëndetësi moderne”, por prapë asgjë nuk lëvizi në përmirësim të gjendjes në këtë sektor. Në krye të këtij dikasteri u emërua një ministër pa përvojë në menaxhim, ministrin Rrahmani qytetarët do ta kujtojnë vetëm me premtime boshe dhe deklarime për data se kur do të fillojnë sigurimet shëndetësore dhe kur do të funksionalizohet kardiologjia invazive. E, dihet se sigurimet shëndetësore nuk i kemi, e as kardiologjia invazive nuk

është në funksion, ashtu siç është thënë 24 orë. Bile Ministria e Shëndetësisë i paguan ‘penallti’ Qeverisë së Austrisë në vlerë prej 50 mijë eurosh në muaj që 8 muaj, sepse Ministria e Shëndetësisë nuk ishte në gjendje të rregullojë ambientin ku duhej të vendosej koronografi, ashtu siç ishte marrëveshja me “Uni Credit Bank Austria”.

Po ashtu, në këtë periudhë të qeverisjes përgjegjësi shumë e madhe bie edhe mbi Ministrinë e Shëndetësisë për mosafrimin në kohë të ndihmës mjekësore në Qendrën Korrektuese të Prizrenit, aktivistit tanimë të ndjerë, Astrit Dehari. Dihet se Qendrat Korrektuese tanimë janë nën menaxhimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Edhe, tash me të marrë mandatin qeverisës qysh në ditën e parë në Qendrën Klinike Universitare ndodh ajo që nuk duhej të ndodhte, sepse si pasojë e papërgjegjësisë brenda instancave të shërbimit spitalor kliniko-universitar ndodhi vdekja e tre pacientëve nga gazi i ashtuquajtur “oksidul” dhe sot e kësaj dite ende nuk ka marrë askush përgjegjësinë, bile është tentuar të heshtet, sepse tre pacientëve që dyshohet se mund të kenë vdekur si pasojë e këtij gazi nuk u është bërë në fillim obduksioni dhe nuk është filluar të hulumtohet derisa ka dalë lajmi në media.

Vonesa dhe neglizhenca për zbardhjen e këtyre rasteve tregon joseriozitetin e kësaj qeverie dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Unë besoj se kjo qeveri nuk e ka jetën e gjatë dhe shumë shpejt qytetarëve do t’u jepet mundësia që të votojnë edhe në përqindje më të madhe Lëvizjen “Vetëvendosje” dhe të bëjmë shërbimet shëndetësore në SHSUK ashtu siç Lëvizja “Vetëvendosje” i ka bërë në Komunën e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Quni, e dëshironi fjalën? Jo! Replikë, Teuta.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, Besë, që ma dhe mundësinë, jam unë Teuta Haxhiu, jo Haxhija, jam dhe do të mbes vetvetja. Nuk tjetërsohem sot këtu, e nesër të dal e t’i ndërroj parimet bile prej komunës në komunë, por mbi të gjitha, me gjithë atë grupin e analistëve të “Klikut”, me gjithë respektin që e keni pasur, dhe analizave të mirëfillta tuaja. Ju them që gjashtë muaj para zgjedhjeve zoti Haradinaj me dokument të shkruar që, me sa e di unë, edhe është publik, ju ka lutur të jeni bashkë, bile jua kishte ofruar edhe kryeministrin.

Nuk deshët! Nuk jemi të njëjtë, është dokument i shkruar. Sot nuk do të thotë që vetëm kur ishte në Hagë duhet të solidarizohemi me të, është po ai Ramushi, është shoku i deputetit të nderuar këtu, Selimi, është ai që ka qenë në luftë me të, është ai që është vetë. Unë shumë pak, të mos them kurrë nuk flas për Ramushin, se flet historia, flet ai vetë. Por, në fakt, nuk do të thotë që vetëm në fatkeqësi të solidarizoheni me të, është kryeministër i vendit. Duhet të mësoheni si opozitë e të silleni si opozitë, dhe atë si opozitë konstruktive, se vetëm ashtu mund të merrni edhe besimin e qytetarëve,

singerisht ju them. Ka përfunduar koha e frymës, e fatkeqësive: “Për inati të sime re, vdektë im bir”. Ka përfunduar. 22 tetori do ta tregojë më së miri këtë. Mirë, është që edhe shumë analistë, e të mos flas, se s’është gjuha imja tjetër, të jenë pjesë e të jenë deputetët këtu, që ka shumë, e që po marrin frymë, po të mos zbehen, të mos e humbin çehren kur e marrë fjalën, se gjithherë kur e ke mizën nën kapuç...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zonja Baftiu.

BESA BAFTIU: Teuta, faktikisht e barti temën krejt në një diçka tjetër, e unë thashë diçka tjetër, por megjithatë dola t’i them Teutës, se e përmendi që dy herë, më 22 tetor, të jesh e bindur, se Lëvizja “Vetëvendosje” do t’i fitojë 15 komuna. Unë po e them publikisht këtu, 5-6 komuna do t’i fitojmë pa balotazh, të tjerat me rëndësi do t’i fitojmë. Vetëm këtë dola t’i them.

KRYESUESI: Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar pak deputetë që keni mbetur këtu,

Është e vërtetë, për hir të qytetarëve duhet t’i përsëritim disa gjëra që u përsëritën shumë herë, dikush me qëllimin opozitar, dikush me qëllimin mazhoritar, por një gjë duhet të jetë e qartë për qytetarët e Republikës së Kosovës se kjo është një seancë me rend të ditës, vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme dhe, natyrisht seancë të jashtëzakonshme ka pasur me arsyen se nuk është lejuar debat atë ditë që është zgjedhur kryeministri.

Këtu u mundua ta shpjegojë pozitë e opozitë pse nuk është mbajtur debat, edhe këtu nuk ka koment as arsyetim, asnjëherë dhe ju kisha lutur sidomos juve që jeni në mazhorancë, nuk ka arsyetim të asnjë lloji që duhet të zgjidhet, sepse është një rend i ri në Kosovën e re me demokraci të brishtë, sado të brishtë që e kemi pasur, nuk njohim Qeveri që është zgjedhur pa debat, një.

E dyta, nuk njohim qeveri që na ka ardhur tre-katër muaj jashtë marrëveshjeve që ka pasur të bëjë me koalicionin dhe pastaj pas koalicionit nuk ka mundur të bëjë një program dhe na ka ardhur me një dokument çfarë është ky, për të cilin na sot me shkas po diskutojmë, e që për mua kjo s’ka peshë as nuk do të lidhem në të hiq. Njëkohësisht, për hir të qytetarëve të Republikës së Kosovës, prapë dikush këtu edhe nga opozita do të manipulojë në mënyrën e vet, që gjykon se nuk ka mundur të bëhet krijimi i koalicionit LAA-VV, ju lutem, nuk është e vërtetë, të mos mendojë askush, se ne vërtet jemi në fushatë zgjedhore, edhe ne këtu kemi ardhur në bazë të fushatës, duke bërë fushatë kemi

ardhur, edhe sot që po debatojmë, po debatojmë për fushatë, prandaj jeni këtu cili keni më shumë argumente për t'i thënë tjetrit që ju jeni këta. Prandaj e kemi kërkuar debatin, sepse kemi të drejtë. S'po mund t'ju kuptoj juve kolegëve nga mazhoranca që duhet të dilni të thoni: "Mos debatoni, se ky debat është i kotë". Nuk është ashtu, edhe pikërisht unë tash po them, pasi është fushatë, ne po u tregojmë qytetarëve të Republikës së Kosovës që nuk duhet t'ju votojnë juve më.

Njëkohësisht, për atë që thashë nga opozita, se është e vërtetë që Lidhja Demokratike e Kosovës, ose Koalicioni LAA dhe VV nuk kanë mundur të bëjnë koalicion pa e harxhuar të drejtën kushtetuese koalicioni fitues, e të mos manipulojmë me elektoratin se është fushatë. E tash, qysh erdh deri tek kjo qeveri, normal që ne e kemi pasur atë ditë ndërmend të diskutojmë, e tash po e vazhdojmë atë diskutim.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, edhe ju kolegë deputetë, edhe pas 19 vjetëve të një lufte të tmerrshme në Kosovë, ku mbi këtë popull është ushtruar edhe gjenocid, kur sot kemi më shumë se 9 vjet të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ne jemi në një moment të absurdit politik, etik, historik e gjeografik. Sot në Legjislaturën VI, pas luftës kur vendit duhet t'i japim një qeveri të avancuar për t'u përballur me probleme të shumta dhe specifike të Republikës së Kosovës, ne jemi para këtij populli trim, të durueshëm e të ditur, me një qeveri që fyen dinjitetin, durimin, dijen, rezistencën.

Askush nga populli shqiptar nuk ka mundur të imagjinojë se edhe pas 19 vjetëve luftë, 9 vjet pavarësisë, sprovave të shumta politike të Republikës së Kosovës, shpurat politike të Kosovës mund të jenë kaq të pakurriz, pa etikë dhe kaq të rrezikshme për vendin e tyre. Të ashtuquajturit "liderë politikë" në Kosovë, të cilët u fuqizuan mbi fatkeqësinë, vuajtjen, durimin, varfërinë e rezistencën e këtij populli, shkuan aq larg sa t'i lejojnë vetes që manitë e tyre nga mosdija t'i bëjnë realitet, duke kaluar edhe mbi të vdekur, nëse dikush u bëhet pengesë.

Absurdi, të nderuar kolegë, arrin deri aty që gratë e burrat e caktuar të këtij vendi shohin ëndërr se u bënë presidentë, kryeministër, kryetar Kuvendi, ministër, deputetë, e ia mësynë kësaj rruge pa e pyetur asnjëherë veten se a kanë kapacitete për këto vende apo poste? Fundi i fundit, kur kanë hedhur fall, sigurisht u kanë thënë se në Kosovë edhe kjo është e mundur, dhe vërtet ashtu u ka dalë. Ju të ashtuquajtur "liderë" që na ofruat një qeveri me kryeministër de fakto Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Ramush Haradinajn, Fatmir Limajn, Behgjet Pacollin, të cilët i aprovoi Aleksandër Vuçiqi, ju që qëllimin e vetëm e patët që secili nga ju të lartpërmendurit të keni sa më shumë ministri në posedimin tuaj, pa e qarë kokën, pra, asnjëherë për program qeveritar.

Ju sot duhet t'i tregoni votuesve tuaj që do të varen normalisht nga Vuçiqi për të bërë ushtrinë e Kosovës, për të fituar liberalizimin e vizave, për të integruar Kosovën në institucionet ndërkombëtare, për të zhvilluar ekonominë e vendit, të gjitha këto do të varen nga miku juaj tashmë Vuçiq. Por, po ju drejtohem juve, qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, se ju nuk duhet të jeni të pashpresë, të dëshpëruar, të trishtuar, sepse ky vend ka ende gra e burra që i dalin zot vendit.

Lidhja Demokratike e Kosovës ju garanton sot se kjo qeveri monstrum e llojit të vet do t'i ketë ditët e numëruara dhe së bashku me ju ne do t'ia kthejmë qeverisjen e mirë që e kishte vendi dhe do t'ia kthejmë, natyrisht, dinjitetin, zhvillimin e integrimin. Do të jemi të barabartë me popujt e tjerë të lirë e të civilizuar, Kosovën, siç e tha edhe kolegu im, zoti Haliti, asnjëherë nuk do ta qeverisë Serbia, por ne do të luftojmë që as ju vazalët e atyre, të Serbisë atje, nuk do ta keni të gjatë, se Serbia jo se jo të vijë këtu.

Ju të ashtuquajtur "liderë" që bëtë pazar me shpresën dhe me të ardhmen e rinisë së këtij vendi numëroni ditët e juaja të fundit në pushtet, mbi kurrizin e këtij populli të lodhur dhe të dëshpëruar nga ju. Ju që manipuluat me kartën e vetme të kauzave patriotike e të shpifura, për të fituar pushtet, për ta kapur çdo institucion të vendit, i erdhi fundi, sepse tanimë karta e fundit juaja është fatkeqësisht Vuçiqi, e ky mashtrim dhe kjo fyerje, jam e sigurt që nuk do të kalojë mbi shoqërinë e Kosovës, natyrisht në fushatë, ata do ta shohin këtë. Dhe, për fund, nuk ka shembull më të mirë që ne e kemi kërkuar këtë debat të vazhdojë këtu dhe qytetarët e vendit e shohin që kryeministri i zgjedhur, i pesti, a i dyti, a i treti, i sati është me radhë, nuk ka kohë të merret me Kuvendin.

E shohim edhe kryetarin e Kuvendit që është lideri i PDK-së, që del këtu i bën njëfarë sulmi dikujt, kujt t'i teket, dhe shkon e nuk pret as t'i jepet përgjigje, e unë do t'i përgjigjem. Ai e potencoi veten që është shumë transparent në dokumentet e Kuvendit, në buxhetin e Kuvendit, e disa gjëra të tjera që kur të është këtu, do t'ia them, veç unë po i them është i vetmi kryetar, i cili ka krijuar precedent, ka krijuar fond të veçantë për Kuvendin, subvencione për kryetarin e Kuvendit. Asnjë kryetar i Kuvendit nuk ka pasur subvencione, ndërsa zoti Veseli i ka pasur dhe nuk ka si të keqmenaxhohet ndryshe para publikë, se kur bëhen edhe zyrtarisht pa pasur bazë juridike, dy qeveri, një në Kuvend, e një siç është kryeministri, e të mos presim tashmë kësaj radhe që i kemi pesë, e nuk e dimë cili do të ketë, normal bash në mandatin e kaluar, se ky ka qenë kryetar i Kuvendit.

Mandatin e kaluar është bërë precedenti t'i ndahen kryetarit të Kuvendit subvencione, se s'kemi pasur kurrë, edhe unë e kam mandatin e pestë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, po besoj se këta që i kam përpara teje në radhë nuk janë këtu.

ISMAJL KURTESHI: Përshëndetje për deputetët prezentë dhe për qytetarët që kanë pasur durimin të dëgjojnë gjëra që shumë pak prej tyre u interesojnë.

Këtë seancë të sotme, sipas meje, e karakterizojnë këto çështje: pothuajse asnjë deputet nuk iu ka përmbajtur rendit të ditës, sepse ai edhe ashtu ka qenë shumë i thatë dhe vërtet s'ka pasur shumë të flitet, sepse edhe në programin, edhe në parime ka vetëm konstatime të përgjithësuara, për të cilat vërtet s'ka shumë çka të thuhet, përveçse ato duhet të plotësohen me ide, me studime të ndryshme se si do të duhej të veprohej në fusha të caktuara për ta ndryshuar gjendjen.

Kjo seancë do të mbahet mend edhe për fyerjet dhe akuzat që bënë deputetët për njëri-tjetrin dhe për grupet e ndryshme parlamentare, e që më së pakti janë të dëshirueshme për qytetarët, sepse ata nuk presin prej nesh ta dëgjojnë këtë lloj ligjërimi, që është tepër i ulët, por presin prej nesh që të propozojmë zgjidhje për ta nxjerrë vendin nga kjo situatë e rëndë, të cilën e kemi sjellë ne përfaqësuesit politikë, sidomos ata që kanë qenë nëpër qeveri që 17 vjet me radhë.

Po ashtu, kjo seancë do të mbahet mend për ligjërata moralizuese që në popull thuhet: "Me i shit mend njëri-tjetrit". Çka duhet bërë e çka s'duhet, por vërtet edhe kjo nuk është misioni ynë dhe po ashtu do të mbahet mend edhe për parashikimin e shumë deputetëve se çka do të ndodhë me qeverinë, çka do të ndodhë më 22 tetorin, e kështu me radhë, njëfarë mënyre prapë e kemi huq. Ajo që më ka brengosur mua sot shumë është injorimi i qeverisë që ia ka bërë këtij Kuvendi. Qeveria, të cilën e ka zgjedhur ky Kuvend, edhe pse të vetëdijshëm se nuk është në dorën e saj të vendosë kur duhet të rrijë në Kuvend dhe kur duhet të dalë prej Kuvendit, ka dalë në një mënyrë shumë të papërgjegjshme, duke konsideruar se ata duhet ta përcaktojnë se kur duhet të rrinë e kur duhet të dalin, cila është tema që Kuvendi duhet të diskutojë. Kjo është republikë parlamentare, andaj Qeveria duhet t'i nënshtrohet Kuvendit çfarëdo Kuvendi që është ky, sepse këta janë përfaqësues të popullit, e qeveria është produkt i këtij Kuvendi.

Brengosja ime tjetër, nëse është e vërtetë ajo thënia e popullit se "Dita e mirë shihet në mëngjes", mëngjesi edhe i këtij Kuvendi, edhe e kësaj Qeverie disi nuk po më duket se janë fort të mira. Është prirje e kësaj qeverie që e ka dëshmuar menjëherë me themelimin e saj që të shpenzojë sa më shumë me numrin e ministrive, me numrin e zëvendëskryeministrave, me numrin e krejt atyre burokratëve që vetëm sa do të shpenzojnë nga buxheti i shtetit, po flas për ata për të cilët nuk ka nevojë kjo qeveri,

sepse jam shumë i sigurt se po t'i heqim 10 nga këto 22 ministri, asgjë nuk do të mungojë në kryerjen e punëve.

Njërën nga vendimet e para që ka marrë Kryesia e Kuvendit është që ta rrisë numrin e anëtarëve në komisionet parlamentare, edhe atë me një arsyetim krejt të pavend. Duhet ta rrisim numrin e anëtarëve në komisione, sepse Partia Demokratike e Kosovës ka më shumë deputetë, po i teprojnë, s'po shkojnë të gjithë nëpër komisione dhe tash duhet t'i rrisim shpenzimet më shumë për t'ua bërë qefin ose për ta dërguar secilin deputet nëpër komisione, jo për arsye se komisionet kanë nevojë për këtë numër kaq të madh të deputetëve.

Shqetësimi im i radhës është ndikimi i Qeverisë së Serbisë në vendimet e Qeverisë së Kosovës nëpërmjet Listës serbe. Përkundër këtyre shqetësimeve, unë shpresoj se ata që janë angazhuar për ta marrë pushtetin me çdo kusht, nuk do të këmbëngulin që pushtetin ta mbajnë me çdo çmim, sepse çmimi mund të jetë shumë i madh për këtë vend. Për shkak të asaj që thashë, se vërtet s'kam çka të them as për parimet, as për programin, sepse vetëm mund ta them që me to duhet të merremi seriozisht të gjithë, e sidomos Qeveria, dhe për shkak të acarimit tej mase të gjendjes në këtë Kuvend, sidomos në këto mbledhjet e para, besoj që në të tjerat do ta ndërrojmë këtë praktikë të akuzave të rënda, fyerjeve e sharjeve, që asnjëherë më parë nuk janë dëgjuar në këtë Kuvend, janë arsye të mjaftueshme që të interesuarit për normalizimin e situatës të kontribuojnë t'i lëmë akuzat reciproke, t'i kthehemi punës, por kjo mund të ndodhë vetëm pasi t'i sqarojmë disa nga çështjet, të cilat natyrisht që duhet të sqarohen.

Shumë deputetë të pozitës këto ditë i kanë acaruar marrëdhëniet me kolegët e tyre nga opozita për shkak të interesimit të tyre dhe brengës së tyre në lidhje me përbërjen e Qeverisë aktuale. Brengosja dhe konstatimet e disa deputetëve të opozitës në lidhje me koalicionin qeverisës kuptohen si akuza mbi të kaluarën personale të disa deputetëve të pozitës.

Kolegë të nderuar, brengosja e deputetëve të opozitës dhe qytetarëve të Kosovës se çka do t'i sjellë vendit ky koalicion i panatyrshëm është legjitime dhe askush nuk mund ta mohojë të drejtën e tyre që t'i paraqesin shqetësimet e veta. Është fakt se një numër i konsiderueshëm i deputetëve të Koalicionit PAN kanë luftuar okupatorin e Kosovës të quajtur Serbi me dekada. Personalisht jam i bindur se një pjesë e deputetëve të koalicionit qeverisës kurrë nuk kanë qenë bashkëpunëtorë të Serbisë, por fakti që ky koalicion që përbëhet nga 61 vota, që i kanë siguruar për ta votuar qeverinë, i ka vetëm 52 deputetë që e njohin pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe kjo duhet të jetë shqetësuese për secilin prej nesh. Është po ashtu shqetësues fakti se Lista serbe, e cila dirigjohet nga Beogradi zyrtar, hapur po punon për rrënimin e shtetit, të Republikës së Kosovës dhe është partnere

e koalicionit, pa të cilën Qeveria nuk do të ishte formuar dhe as nuk do të mund të mbetet në pushtet.

Faktet e lartpërmendura janë dëshmi e rritjes së ndikimit të Serbisë në Kosovë si kurrë ndonjëherë më parë dhe janë të pamohueshme. Prandaj, është e kuptueshme se të gjithë ata që kanë kontribuar në bërjen e këtij koalicioni, Qeveria e të cilës varet nga Lista serbe, me vetëdije ose pa vetëdije e kanë bërë një argat për rritjen e ndikimit të Serbisë në Kosovë dhe se ata e dinë që Serbia nuk do të hynte dhe as nuk do të qëndronte në këtë koalicion pa përfitime të natyrës hegjemoniste. Ky fakt nuk mund të mos i ngarkojë me përgjegjësi të gjithë ata që e kanë votuar këtë koalicion. Këto fakte duhet t'i pranojmë të gjithë dhe mendoj që po ashtu duhet të kërkohet rrugëdalje nga kjo situatë, e cila mund të jetë e dëmshme për vendin, e ky vend është i rëndësishëm njësoj për secilin deputet dhe për secilin qytetar të këtij vendi.

Dhe, në fund, kolegë të nderuar deputetë, ju të pozitës mos pritni nga opozita që ta luajë rolin tuaj. Opozita do ta luajë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi s'është, Valentina Bunjaku s'është, Fidan Rekalii ose Haxhi Avdyli është i pari.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ne sot po diskutojmë parimet programore të një qeverie të udhëhequr nga PAN-i, i cili as para zgjedhjeve, as pas zgjedhjeve nuk ka pasur një alternativë qeverisje të mirëfilltë, por më shumë jemi marrë se kush dhe cili zyrtar do të rehatohet nëpër poste.

Prandaj, ne tani po flasim për një qeveri as parimore, as programore, por qeveri të interesave klanore, politike, të një pakice elektorale shqiptare. Verdikti i qytetarëve të Kosovës ishte ndryshimi, sepse sot kemi vetëm 41 deputetë nga 100, nga shumica shqiptare që përkrahin këtë qeveri, por falë anomalive ligjore dhe kushtetuese, shumica shqiptare nuk udhëheq me Kosovën, prandaj kjo situatë nuk është e mirë për demokracinë përfaqësuese që e kemi ne dhe demokracitë parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Kjo situatë anakronike duhet të ndryshohet, këtë ndryshim mund ta bëjmë ne si parti, si deputetë, duke nisur sa më shpejt reformat zgjedhore dhe kushtetuese në funksion të pushtetit të shumicës. Alternativat e tjera do të jenë recidivat e krizave dhe bllokadat e

panevojshme institucionale dhe bllokadat shtetërore. Demokracia fillon nga partitë politike, vazhdohet me zgjedhje fer dhe përfundon me krijimin e qeverisë funksionale, e bazuar në parimin e krijimit të shumicës parlamentare. Prandaj, ky vend ka nevojë urgjente për reforma demokratike kushtetuese, ridizajnim të sistemit zgjedhor, pse jo edhe futjen e votimit elektronik. Kemi nevojë edhe për Ligjin për partitë politike, reformimin e Ligjit zgjedhor dhe Ligj për qeverinë, të gjitha të bazuara në vlerat e demokracisë evropiane. Fatkeqësisht për partitë në pushtet këto tema s'janë të rëndësishme, se sa tema e pazareve për poste. Këtë e vërteton edhe përbërja aspak profesionale dhe kredibile e kësaj qeverie, ku disa nga ministrat ishin edhe protagonistë të aferës "Pronto".

Ka ministra mjekë në infrastrukturë e ambient, e shëndetësia i besohet njeriut që në spital ka qenë ndoshta vetëm për ndonjë vizitë të ndonjë të afërmi. E kemi një ministër anonim që nuk mund t'i njohë problemet, nuk mund ta njohë organizimin e sistemit goxha të komplikuar shëndetësor. Ky ministër ka rrezik të shndërrohet edhe në sëmundje të re të këtij sistemi. Se sa e rëndësishme shëndetësia për këtë qeveri, nuk ka rol vetëm emri i këtij ministri, por kanë rol edhe parimet programore, të cilat i ka bërë kjo qeveri apo ia kanë bërë, i cili është shumë i mangët dhe nuk janë as synime apo plane për avancimin e sistemit.

Aty shkruan se qeveria do të shikojë rrjetën e institucioneve shëndetësore, të rishikojë. Pse? Akoma nuk është planifikuar, akoma nuk është shikuar kjo? A do të thotë kjo se tani do të fillojë studimi i gjendjes së sistemit shëndetësor?

I nderuar ministër, i cili edhe këtu nuk është, qeveria nuk është shkollë fillore, ku do të fillohet të rishikohen gjërat. Këto gjëra është dashur t'i dini, t'i keni të shikuara, të rishikuara dhe tani vetëm t'i implementoni ato të cilat i keni planifikuar. Kështu me një ministër pa dije bazike për shëndetësinë dhe rishikimet e tij, sistemi ynë shëndetësor do të vonohet në reformat e planifikuara. Këtij ministri i duhet kohë edhe vetëm t'i shqiptojë emrat e disa klinikave, e lëre më të dijë nevojat e Klinikës Maksillofaciale, Klinikës Neurokirurgjie, Klinikës Otorinolaringologjike. Këta pretendojnë Spitalin e Prizrenit që ta ngrenë në qendër terciare, dhe e harrojnë që qendra terciare janë ato qendra ku bëhet edhe edukimi i profesionistëve shëndetësorë. Nuk krijohen qendrat terciare me një fjalë goje, por duhet të krijohet Fakulteti i Mjekësisë atje. Nuk bëhet fjalë për fakultet, ndërsa thuhet se do të bëjmë qendër terciare vetëm për efekte elektorale.

Në program thuhet se do të bëjmë QKUK-në qendrën, e cila do t'i bëjë karshillëk edhe Evropës, dhe do të jetë njëri ndër spitalet më të mira në regjion. Ju lutem, për sa dekada do ta bëni këtë? A e kuptoni se shteti ynë për shëndetësinë ndan më së paku para në rajon. Vetëm për hir të opinionit dhe për hir të kolegëve duhet t'ia shpreh, të tregoj disa të

dhëna sa shtetet e rajonit ndajnë për shëndetësinë: Maqedonia shpenzon 650 euro për kokë banori, Mali i Zi shpenzon 800 euro për kokë banori, Serbia afro 1 000 euro për kokë banori, ne shpenzojmë 134 euro. Së paku të premtohet se do ta dyfishojmë këtë buxhet, e jo do ta bëjmë spitalin, i cili do të na ketë lakmi edhe Evropa, këto janë klishe apo pamflete politike elektorale dhe aspak plane apo synime qeveritare serioze.

Prandaj, në fund shpresojmë që ministri i ri i kësaj qeverie do të mësojë më shumë për shëndetësinë, sepse premtoi që ilaçin do t'ia gjejë kësaj shëndetësie. Por, si një profesionist shëndetësor duhet t'i them se ai së pari duhet ta bëjë diagnostikimin e sëmundjeve shëndetësore, Kamish, mund ta marrësh fjalën. Duhet ta bëjë diagnostikimin e sëmundjeve, të cilat lëngon shëndetësia, e pastaj të ordinohet ilaçi. Qytetari e di që aty jeni për ta gjetur ilaçin e shëndetësisë, por kam frikë që ky ministër është aty vetëm për tenderë, sepse ilaçi i gabuar, në dozën e gabuar dhe në duar të gabuara mund të jetë vdekjeprurëse dhe unë kam frikë, këtë po e shpreh si dyshim, shpresoj të më demantojë ky ministër që shëndetësisë nuk do t'i shtohen problemet që i ka pasur për këto vjet si pasojë e mosfinancimit të duhur, të cilin e ka merituar shëndetësia. Kur po them këtu, për të gjitha qeveritë po them, për të gjitha qeveritë nuk e kanë pasur prioritet që ta rrisin buxhetin për shëndetësinë dhe tani e kemi gojën plot që do ta bëjmë QKU-në, do ta bëjmë SHKSK-në spitale që do t'i bëjë karshillëk dhe do të jetë qendra më e mirë në Evropë. Këto janë dokrra nëse ne nuk ia rritim buxhetin shëndetësisë dhe nuk e dyfishojmë buxhetin për shëndetësinë, dhe më pak të merremi ndoshta me shtrirje të asfalteve, e më shumë me shëndetin, i cili po shkakton halle shumë të mëdha dhe po e dëmton edhe buxhetin familjar të qytetarëve tanë.

Unë shpresoj që vizitat megalomane nëpër spitale sa për efekte elektorale do të zvogëlohen, por do të punohet seriozisht në zgjidhjen e problemeve, të cilat i ka kjo shëndetësi që janë grumbulluar në vite, e ky është faktori numër një, faktori që nuk ka qenë prioritet qeveritar, shpresoj se kjo gjendje do të ndryshojë dhe do t'i kthehet dinjiteti, së pari qytetarëve tanë të sëmurë, mjekëve e të gjithë aktorëve që janë të involvuar në sistemin shëndetësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia ka përmendur emrin, ky ka të drejtë në replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Po njihemi, të gjithë njihemi edhe me pseudonime, që unë e mbaj me mburrje atë pseudonim. E kemi bërë me gjak, me mund e me sakrificë. Respekt!

Jo për të bërë replikë më shumë, po është plotësim. Për programin e shëndetësisë shpresoj që bashkë të gjithë kolegët këtu që jemi nga fusha e mjekësisë të punojmë bashkë për ta

bërë një program të mirë. Prandaj i lexova njëmbëdhjetë pika që i kemi bërë bashkë me ekspertë të fushës së shëndetësisë dhe mendoj që do t'i bëjmë bashkë.

Ne kemi pasur ministra që emrin e klinikave e kanë shqiptuar mirë, por ato klinika i kanë bërë si mos më keq. Edhe gjendjen në shëndetësi e kanë sjellë, pa dallim kush e ka udhëhequr Ministrinë e Shëndetësisë, në këtë gjendje që është. Po, ne mund ta bëjmë bashkë të gjithë, mund ta bëjmë një program të mirë, ta ndihmojmë, edhe buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë do të ndahet në këtë Kuvend dhe ne mund ta bëjmë bashkë. Besoj, se nëse punojmë bashkë, do të jemi në shërbim të qytetarëve për ta përmirësuar gjendjen atje dhe ta korrigjojmë.

Pajtohem dhe reagoj për ata pse the “spital diagnostikimi”. Së pari duhet ekzaminimin, diagnostikimin, ilaçet. Të zgjidhet një problem duhet ta njohësh, së pari duhet ta njohësh atë problem, pajtohem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Duke qenë se sot është hera e parë që edhe unë drejtohem nga kjo foltore, fillimisht u shpreh falënderimet e mia më të sinqerta të gjithë atyre që mundësuan ndryshimin më 11 qershor dhe më dhanë mua besimin që t'i përfaqësoj në këtë Parlament.

Por, situata në të cilën ndodhemi sot nuk është aspak e natyrshme, pasi gati katër muaj pas zgjedhjeve ky koalicion, me një numër rekord të partive të përfshira në qeverisje, premtoi se do të mundësojë diskutimin për parimet programore, të cilat zoti Haradinaj i paraqiti në seancën kur u votua Qeveria dhe pastaj edhe për programin qeverisës dhe për programin legjislativ, që tashmë na e kanë përcjellë në këtë Kuvend.

Mirëpo, siç u përmend nga të gjithë, e tashmë është parë, shihet se po vazhdon një arë e ulët, në radhë të parë Qeveria, duke iu shmangur një diskutimi dhe duke u larguar nga ky Parlament, e nga ana tjetër, me diskutime të deputetëve këtu, të cilët u morën me gjëra krejtësisht personale dhe jo të rëndësishme për interesin e qytetarëve.

Unë kam lexuar me vëmendje dokumentin “Parimet Programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës”, që na u paraqit fillimisht në këtë Kuvend dhe pashë se ai shpërfaqte papërgjegjësinë dhe joseriozitetin e propozuesve, se kishte lëshime të mëdha konceptuale dhe logjike. Por, fillimisht u tha se ky është dokumenti i parë dhe se do të punohet më tutje në elaborimin dhe prezantimin e programit qeverisës, andaj kisha pak

shpresë se do të punohej së paku më me seriozitet, se do të angazhoheshin profesionistë e njerëz vullnetmirë, të cilët nuk janë të paktë në këtë vend dhe do të prezantohej një dokument serioz e konciz. Fatkeqësisht kjo nuk ndodhi. U prezantua një dokument shumë i thjeshtë, i cili më shumë se një program, është një përmbledhje e aktiviteteve, një dokument ku vazhdojnë premtimet e pamatura sikurse në fushatë zgjedhore, pa asnjë plan apo angazhim për realizim në praktikë të premtimeve të dhëna tashmë me vite.

Ky dokument i prezantuar duhet të na shqetësojë seriozisht të gjithë neve dhe duhet të jetë një thirrje për reflektim të qytetarëve, pasi tregon jo vetëm mungesën e seriozitetit në punë, por edhe mungesën e vullnetit dhe të përkushtimit që në fillim të kësaj Qeverie. Është tashmë e ditur se edhe kësaj radhe beteja e vetme ishte themelimi i Qeverisë, pikërisht për ndarje të posteve dhe përmbushjeve të egrove e interesave personale të grupeve të vogla dhe asnjë moment të vetëm përmirësimi i jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Do të ndalem sot tek pjesa e arsimit, dija, shkenca dhe teknologjia. Në këtë kohë kur tashmë të gjithë jemi të vetëdijshëm për seriozitetin e situatës në këtë sferë kaq të rëndësishme, duke pasur parasysh situatën e vështirë në të cilën gjendet sistemi i arsimit në Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet e tij, kur të gjithë jemi të tronditur me rezultatet e fëmijëve tanë në testin PISA, qytetarët me të drejtë mund të presin, ashtu sikurse prita edhe unë, që të paktën është punuar me seriozitet te pjesa e arsimit. Por, ajo që ishte prezantuar, në fakt, në dokumentin “Parimet Programore”, ishte vetëm një gjysmë faqe tekst sa i përket arsimit, konkretisht shtatë fjali. Pra, vetëm shtatë fjali sa i përket arsimit dhe që ato nuk adresonin madje as çështjet që ishin të parapara në dokumentet bazike ekzistuese në Ligjin e arsimit parauniversitar, në Strategjinë për sigurimin e cilësisë në Ligjin për arsimin e lartë dhe të ngjashme.

Si parim programor të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017/2021 parashihej, citoj: “Përgatitja profesionale që nga niveli i mesëm i lartë deri te ai akademik do të jetë në funksion të plotësimit të kërkesave të ekonomisë, shoqërisë dhe realizimit të aspiratave kombëtare”. Dua të rikujtoj këtu, se sipas statistikave në Kosovë 19 700 persona me fakultet të përfunduar janë sot të papunë, prej tyre 10 300 janë gra dhe vajza. Pra, ne nuk kemi një mungesë të kadrove, por anasjelltas.

Në këtë program është thënë se Qeveria do të ndërmarrë reforma të thella në të gjitha nivelet, në mënyrë që të rritet cilësia në arsim. Sado që kanë qenë pjesë e qeverisjes që nga paslufta të gjitha këto parti, që po pretendojnë të udhëheqin me vendin, kanë injoruar faktin në këtë program se në Kosovë janë bërë reforma të vazhdueshme që nga viti 2001, kur u hartua një kornizë e re kurikulare, e cila përcaktonte një koncept të ri filozofik dhe

në raport me të kaluarën synonte që nxënësin ta vente në qendër të vëmendjes dhe të pajiste atë me shkathtësitë e shekullit 21, shkathtësi si kjo që i mat testi PISA.

U vazhdua me reforma, ndër të tjera edhe në vitin 2011, kur u hartua kutikula e re, e cila promovonte një qasje të bazuar në kompetenca dhe jo të bazuar në përmbajtje. Korniza e kurikulës së re filloi sivjet të zbatohet në të gjitha shkollat. Praktikrat nga terreni po tregojnë për sfidat serioze me të cilat po ballafaqohen mësimdhënësit në shkolla dhe tashmë është e qartë se gjendja nuk po përmirësohet. Megjithatë, edhe kjo Qeveri duket se do të vazhdojë të improvizojë duke u thirrur në reforma të ndryshme.

Është thënë po ashtu se sistemi arsimor do të garantojë aftësimin e njerëzve për të marrë mbi vete barrën e zhvillimit ekonomik, shoqëror e individual.

Të nderuar,

Këto parime programore janë shkruar thuajse nuk e dinë se në çfarë gjendje është arsimi në Republikën e Kosovës. Do të duhej ta kishin treguar së paku pak më shumë seriozitet në paraqitjen e tyre të parë për këtë temë, pasi që sukcesi, jo vetëm në arsim, varet jo vetëm nga dashuria për punën që e bën, por edhe nga guximi, vendosmëria, nga vullneti për të realizuar çështje të rëndësishme, të drejta e parimore, gjithsesi edhe nga ekipi që do të punojë në këtë drejtim.

E kjo Qeveri, këto parime qeverisëse dhe ky program qeveritar nuk paraqesin asnjë shpresë në këtë drejtim. Edhe draft-programi për arsimin ka mangësi thelbësore. Ai mungon në thelbin e problemeve të arsimit në vend. Përkundër që është shumë i shkurtër, ka shpërputhje logjike të objektivave të parashtruara. Përveç kësaj, objektivat janë shumë sipërfaqësore, nuk janë aspak specifike dhe të matshme, e ata që sado pak merren, madje edhe ata që kanë njohuritë bazike për përcaktimin e objektivave, e dinë që këto janë ndër kërkesat e para dhe thelbësore për përcaktimin e objektivave dhe në bazë të përcaktimit të tyre do të mund të vlerësohej pastaj edhe performanca e kësaj Qeverie. Reformat e parashtruara nuk paraqesin asnjë risi kundrejt situatës në terren. Arsimi universitar dhe objektivat e parashtruara, po ashtu janë josignifikante për seriozitetin e problemit të këtij komponenti.

Arsimi fillor në Kosovë tashmë e ka një pasqyrë reale për gjendjen në të cilën është nga rezultatet e PISA-s dhe ndonëse më vjen keq ta them, është vështirë të besohet se do të ketë përmirësim të rezultateve në formatin aktual dhe në atë që pritet të ndodhë në qeverisjen e tanishme.

Sado që gjithandej ka mësimdhënës të përgjegjshëm e shumë të përkushtuar, që kryejnë me profesionalizëm punën e tyre, asnjëherë nuk është gjetur ndonjë mënyrë a formë që të

motivohen këta mësimdhënës, e aq më pak, një sistem i cili do të duhej të siguronte që profesionalizmi të jetë jo dëshirë, por domosdoshmëri. E në rastin tonë, pra në rastin e kësaj Qeverie, nëse jo një degradim i qëllimshëm dhe një joprofesionalizëm, është plotësisht një mungesë totale e llogaridhënies në të gjitha nivelet dhe vullnetit politik për të bërë gjërat në mënyrën e duhur.

Fatkeqësisht, po shihet se kjo do të vazhdojë sikurse edhe me qeverisjet e kaluara. Sigurisht, se dështimi në arsim nënkupton edhe dështimin në të gjitha fushat e tjera, si në ekonomi, në shëndetësi, politike, në media dhe gjithandej në shoqëri.

Të nderuar qytetarë,

Shpresoj që së paku tani të vetëdijesohemi e të bindemi që edhe heshtja është krim dhe atë hiq më pak se vrasje e së ardhmes së fëmijëve tanë. Andaj, ju ftoj të reflektoni. Ndryshimi në arsim dhe në përgjithësi në shoqëri është i mundshëm në Kosovë, por ai kërkon vetëdije, vizion, vullnet dhe guxim të politikëbërësve. E kjo Qeveri nuk e ka asnjërën nga këto.

Ministri i ri i Arsimit nuk ka asnjë ditë pune në arsim. Parimet qeverisëse, programi i propozuar qeveritar, janë të pashpresë. Andaj, aktualisht unë shpresoj në vullnetin e mirë dhe përkushtimin e mësimdhënësve dhe stafit tjetër akademik, të cilët janë të përgatitur profesionalisht, që do të bartin barrën e edukimit të fëmijëve, të rinjve dhe jo vetëm të tyre dhe do të sjellin ndryshimet aq të nevojshme në këtë shoqëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Nagavci! Fjalën e ka zoti Rekalju.

FIDAN REKALJU: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë jam deputet i ri dhe kjo është fjala ime e parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Natyrisht, do të doja që diskutimi im të ishte tërësisht në një frymë tjetër nga ajo që kemi sot.

Paraprakisht, dua të them se vij në këtë përbërje të kësaj legjislature, e gjashta me radhë, e tempullit tonë të demokracisë me besimin, vullnetin dhe përkushtimin e plotë që nëpërmjet mandatit tim të vë në shërbim të të rinjve të vendit tonë karrigen e deputetit në funksionim të përpjekjes për të avancuar pozitën e tyre në vend. Fryma në të cilën do të doja të zhvilloheshin diskutimet është ajo e debatit mbi përfaqeset programore të kreut të Qeverisë në katër vjetët e ardhshme, me theks të veçantë përcaktimet programore dhe zotimet konkrete në fushat që prekin të drejtat dhe interesat legjitime të rinisë sonë.

Vërtet është për keqardhje, deri diku edhe dëshpëruese, për të rinjtë e Kosovës që një mundësi e tillë sot është praktikisht e pamundshme dhe kjo për dy arsye. Ata që kanë marrë përsipër përgjegjësinë për qeverisjen, pra për t'u dhënë përgjigje kërkesave dhe interesave legjitime të qytetarëve të Republikës, nuk ofruan asgjë konkrete përtej frazave të zakonshme të thata dhe pa asnjë përmbajtje të përcaktimit programor mbi këtë kategori, pra rininë. Është e vështirë të japësh inute në këtë debat, s'ke as çfarë të thuash, sepse në të thjesht nuk ka asgjë përmbajtjesore. Kjo na shpërfaq edhe një herë faktin se ky koalicion i ndërtuar në këtë mënyrë, që në fillimin e tij nuk është ndërtuar si koalicion që akcepton pushtetin si mjet për t'i shërbyer avancimit të mirëqenies së interesave të qytetarëve dhe të shtetit nëpërmjet mirëqeverisjes, por e akcepton atë në vetvete për t'u shërbyer egove personale të liderëve të grupeve të interesit, që gravitojnë te këto parti.

Arsyeja e dytë është, se diskutimi shterpë me popullizëm, patetizëm dhe folklorizëm, që karakterizojnë debatin politik dhe atë parlamentar, po i zënë vendin debateve të dobishme mbi politikën programore e sektoriale. Kjo mënyrë e të bërit debat u hyn në punë dy palëve të caktuara: folkloristëve që mendojnë të faktorizojnë veten me provokim emocionesh të grupeve të qytetarëve të pakënaqur, në njërën anë, si dhe Koalicionit PAN dhe të tjerëve, të cilët duke shmangur diskutimet mbi programin u mundësojnë të fshehin varfërinë e ideve për qeverisjen dhe zotimet, që një qeveri serioze e këtij vendi do të duhej t'i parashtronte sot.

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Lidhja Demokratike e Kosovës, si subjekt politik serioz dhe mjaft i qartë, qoftë në përcaktimet politike dhe po ashtu me mjetet politike që përdor, do të jetë opozitë e vendosur për t'u treguar e dëshmuar qytetarëve keqqeverisjen dhe abuzimin e kohës dhe resurseve të vendit nga ky koalicion pa ide dhe plan qeverisës, për t'ju qasur nxitjes së zhvillimit të vendit. Në këtë mision do të përpiqem që të jem njëri nga ata që kërkesat dhe nevojat e të rinjve të Kosovës të përfaqësohen dhe artikulojnë drejt. Këtë nuk do ta bëjmë duke provokuar manipulimet fetare apo nacionaliste, siç jo rrallëherë ka ndodhur edhe në këtë Kuvend. Natyrisht, këtë nuk do ta bëjmë as duke i përdorur armiqtë e vuajtjet e kaluara të popullit tonë me shtetet fqinje, në shërbim të ngritjes së emocioneve për t'i siguruar vetes vëmendje e përfitim politik, siç ndodh në Ballkan me këto tema. Kjo s'është tradita dhe kultura politike e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila në aspektin sasior dhe cilësor përfaqëson rininë kosovare me botëkuptime politike e kulturë perëndimore dhe euroatlantike. Me ata ne do të punojmë ta ndërtojmë Evropën këtu, duke filluar nga heqja e regjimit të vizave, Evropën e lirive, ideve, të demokracive funksionale të shtetit të së drejtës, që fatkeqësisht nuk përkon as për së afërmi me vlerat politike dhe

kulturore që na u prezantuan sot në këtë debat apo edhe debateve të ditëve të kaluara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Thënë të vërtetën, nuk e kisha në plan të diskutoj, por kisha durimin ta përcjell prej fillimit këtë seancë. Prita që do të diskutohen parimet e Qeverisë apo programit qeveritar, nuk ndodhi asnjëra.

Krejt çfarë dëgjova në këtë seancë ishte një fushatë zgjedhore, përkatësisht një retorikë tashmë bajate, retorikë që e kam dëgjuar tash e pesë vjet. Mendoj se janë disa vjersha që po përsëriten nga disa kolegë deputetë. Unë kam pasur fatin të shkruaj poezi në burg. Besoni, kur kam qenë në disa emisione mysafir, kur më kanë thënë a e di ndonjë vjershë përmendësh, më besoni nuk i kam ditur, edhe pse i kam shkruar vetë. Kështu që ju përgëzoj që keni mbamendje kaq të madhe për t'i mbajtur mend të njëjtat fjalë, me të njëjtën retorikë.

Kolegia Besa Gaxherri tha: “Qeveri vazale e Vuçiqit...” Me gjithë respektin që kam Ramush Haradinaj që e drejton Qeverinë e Republikës së Kosovës, nuk ka shqiptar i gjallë që është njeri më meritohar që e ka luftuar Serbinë atje ku ka qenë vendi. Prandaj, të quhet “Qeveri vazale e Vuçiqit” Ramush Haradinaj, i cili është i dëshmuar në këtë temë, mendoj se nuk është në rregull.

Prisni, Qeveria është në nisje, e ka fillimin e mirë. A do të ketë dështime apo suksese, t’ia lëmë kohës, por të adresohemi me etiketime të tilla për vasalitet me Vuçiqin e me Serbinë, mendoj se janë të pakuptimta. Prisni, ka kohë, është normale funksionimi i demokracisë, dikush është pozitiv, dikush opozitiv, por mbi të gjitha ne jemi këtu deputetë, jemi kolegë dhe jemi të thirrur për të punuar në interes të qytetarit dhe vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Pacolli. Besa, dëshiron edhe një herë fjalën?

BESA GAXHERRI: Zoti koleg deputet,
Vlerësimin e zotit Haradinaj, punën e tij, sidomos gjatë kohës së luftës askush, unë së paku, nuk e kam kontestuar asnjëherë dhe as nuk po e kontestoj. Ajo çështje dhe ajo kohë është e mbyllur, i nderuar. Ne jemi në një realitet tjetër. Dhe, as ti dhe as njëri nga ne këtu, nuk mund ta mohojë se përbërja e Qeverisë suaj është e shëmtuar. Kush ka qenë dje

Ramush Haradinaj e dimë të gjithë, ia heqim kapelën. Kush është sot, po e shohim të gjithë. Dhe, unë uroj dhe do të jem këtu, pa marrë parasysh që jemi pozitivë a opozitivë, nëse ju vërtet keni nevojë për kontributin dhe për ta shpëtuar vendin, prapë do të jem këtu.

Por, Qeveria juaj është e varur prej Listës serbe, tash s'kemi çka e diskutojmë këtë. Jo, jo, të lutem, ajo është kategori kushtetuese, por ne i kemi pasur 87 vota, s'kemi pasur varësi fare prej tyre, tash janë...

KRYESUESI: Zoti Selmanaj, kundër-replikë.

RASIM SELMANAJ: Nuk e di pse po shqetësoheni për çështjen e Listës serbe, është një praktikë edhe e qeverive të mëhershme. U tha nga shumë kolegë deputetë, në momentin kur Lista serbe do ta shantazhojë ose do të ketë situata në disfavor të vendit tonë, atëherë edhe ne do ta themi fjalën tonë. Por, ju mos u shqetësoni për këtë temë. Ne e kemi Qeverinë, i kemi numrat, do të punojmë në interes të vendit dhe të qytetarëve, por prisni. Qeveria është në nismë, prandaj të shohim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli, urdhëro!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë të pranishëm,
Në ditën kur e kërkuam debatin për programin qeverisës, ky debat u bojkotua nga kryeministri dhe nga deputetët e pozitës.

Jo, në ditën kur e kërkuam. E kemi kërkuar më herët...

KRYESUESI: Ju lutem, mos e ndërprisni deputeten. Vazhdoni, zonja Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Po, veç pak. Kryeministri dhe ju deputetë të pozitës nuk pranuat për shkak se s'kishit program. Ju sollët te ne një dokument me parime, që në fakt, nuk ishin as parime. Pra, ato ishin disa fjalë të shkruara mjaft keq, pa koncept dhe të kopjuara e të përkthyer fjalë për fjalë. Edhe nëse dëshiroje të gjeje diçka nga ato parime, me të vërtetë nuk mund të nxirrje asnjë rend, asnjë fjali të vetme që kishte kuptim.

Pastaj, na sollët dokumentin me pikat programore, të cilat i quajtët programe, mirëpo ky program që e sollti Qeveria, nuk ishte program politik, i cili përmbante politika të caktuara, por ishin premtime dhe, si të them, politika të përsëritura edhe nga qeveritë e tjera, të cilat vështirë se do të realizohen.

Pra, kjo Qeveri, e formuar jo për shkak të votave të qytetarëve, por për shkak të pazareve politike, politika në Kosovë nuk ka ndryshuar, por fatkeqësisht është rrënuar edhe më

tepër. Programi politik i kësaj Qeverie thuhet se bazohet në katër shtylla, e një ndër to është edhe shtylla e politikës së jashtme dhe e integritimeve evropiane.

Pra, në këtë program politik pritet që Kosova të bëhet BE. Paramendoni, thotë: “Kosova do të bëhet BE”. Si mund të bëhet Kosova BE? Shumë e çuditshme! Kosova mund të anëtarësohet në BE, por nuk mund të bëhet BE. Kryeministri ka premtuar edhe përshpejtimin e marrjes së statusit të kandidatit, ndonëse e di shumë mirë se sa ka gjasa që ky proces të përshpejtohet. Ai ka dhënë dy afate të ndryshme. Në pjesën e parë të programit thotë se synon marrjen e statusit në vitin 2021, ndërsa në objektivat që paraqiten te Ministria e Integritimit e përmend vitin 2020. Pra, cili është i sigurt, 2021 apo 2020? Dhe, unë nuk habitem me këtë vit të cilin e ka vendosur, për shkak se ju e dini se kjo Qeveri nuk do të zgjasë shumë, do të përfundojë më 2018, më së largu dhe 2020/2021 do të ketë një qeveri të mirë, e cila do të jetë qeveri e “Vetëvendosjes” dhe do t’i shtyjë tutje parimet tona programore.

Sipas procedurave, hapi i radhës është që shtetet, të gjitha shtetet të cilat ndjekin, pra dëshirojnë ose nënshkruajnë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, pastaj vjen edhe aplikimi për statusin e kandidatit. Me të vërtetë kryeministri e ka qëlluar mirë, që thotë po fillojmë “me aplikimin e statusit”, mirëpo sa është e arritshme kjo, është fare pak e bindshme. Së pari, kjo Qeveri nuk do të ketë stabilitet, jetëgjatësia e saj do të jetë tepër e shkurtër. E formuar për pazare politike partiake, mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit të kabinetit qeveritar do të jetë e pashmangshme. Sikurse edhe në qeverinë e kaluar, ministrat do të synojnë mbrojtjen e interesave partiake dhe private para atyre shtetërore. Si rrjedhojë, kryerja e detyrave dhe obligimeve që ka Kosova karshi BE-së do të bëhet e pamundur.

E dyta, duke qenë se kjo Qeveri varet plotësisht nga Beogradi nuk mund të ecë përpara asnjë proces, pa bekimin e tij. Beogradi ende nuk e njeh shtetin e Kosovës dhe vazhdimisht lobon kundër çdo procesi që fillon Kosova. Pra, duke marrë parasysh edhe kërcënimet direkte dhe indirekte që do t’ia bëjë Beogradi kësaj Qeverie, atëherë çdo proces pozitiv që do të fillojë nga kjo Qeveri, nëse fillon, do të bllokohet dhe do të mbetet në mëshirën e Serbisë.

Një qeveri të aftë, të pastër dhe të gatshme të realizojë reforma të thella është dashur ta ketë Kosova sivjet, mirëpo fatkeqësisht nuk e kemi dhe ne do të vazhdojmë të përballemi me qeveri të dobëta, të formuara për pazare politike, të cilat do të dëmtojnë tutje edhe procesin e integritimit, edhe politikën e jashtme dhe liberalizimin. Kjo Qeveri e cila nuk dallon asgjë nga qeveritë e kaluara, me ministra nën hetime, nuk është e gatshme të bëjë asnjë reformë thelbësore që kërkohet. Nëse kryeministri thotë se do ta marrim statusin e kandidatit në vitin 2020 apo 2021, të kthehemi pak mbrapa, ta rikujtojmë Shqipërinë.

Shqipërisë iu nevojitën mbi pesë vjet dhe reformë e thellë për të marrë statusin e kandidatit. Paramendojeni sa vjet do t'i duhen Kosovës me këtë Qeveri.

Ndërsa, sa i përket liberalizimit të vizave, për ta realizuar këtë, siç kryeministri e quan “objektivë strategjike”, Qeveria është e përkushtuar të punojë në dy drejtime: ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit, si dhe arritjen e rezultateve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Përfshirja e çështjes së ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, si kusht për liberalizimin e vizave, u konsiderua e padrejtë. Asnjë shtet tjetër nuk ishte kushtëzuar me përmbylljen e demarkimit të kufijve, edhe pse kishin demarkime të pambyllura me shtetet fqinje.

Lëvizja “Vetëvendosje” ishte kundër këtij kushti dhe kundër marrëveshjes, nëpërmjet së cilës synohej të përmbyllej demarkimi, e cila ishte në kundërshtim me atë që dëshmohet ne harta, në dokumente zyrtare, nga profesionistë ekspertë e me peticion masiv qytetar. Ishte kundër dhe vazhdon të jetë kundër kësaj marrëveshjeje të padrejtë, që ia heq Kosovës 8 200 hektarë.

Kundërshtimi të kësaj marrëveshjeje iu bashkua edhe AAK edhe “Nisma”. Ishin zyrtarët e AAK-së dhe të “Nismës” ata të cilët thanë se ky kusht është i padrejtë dhe mbi të gjitha, demarkacioni ishte kërkuar të vihet si kusht nga ish-qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Thaçi. Ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi qenka pranuar si kusht për liberalizim nga po ai person, i cili e kundërshtonte qysh në fillim. Pra, sot e kemi kusht për liberalizimin e vizave.

Çfarë ndodhi tash që Ramush Haradinaj kushtin e padrejtë e vendosi në programin e tij qeveritar? Ndoshta ju e dini, se jeni duke folur anash, e besoj që e dini. Problemi mbetet te kushti kryesor, pra luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar. Edhe Qeveria e kaluar ka vendosur si kusht demarkacionin për të mbuluar kushtin kryesor, sepse e ka të vështirë që të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Të njëjtën vështirësi do ta ketë edhe qeverisja e Ramush Haradinajt, sepse po ta luftoni korrupsionin, i bie që kryeministri ta luftojë veten dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë dhe të partisë së vet, si dhe partive të tjera, me të cilat ka bërë koalicion.

Prandaj, për ta mbuluar këtë që nuk kanë mundur ta përfundojnë qeveritë e mëparshme, po edhe kjo qeveri, vendosin kushte të tjera, të cilat i mbulojnë kushtet që nuk mund t'i realizojnë. Pra, jo rastësisht deri më tani nuk ka ndodhur asnjë dënim i figurave të

rëndësishme politike të anëtarëve të qeverive të kaluara apo të partive të koalicionit. Prandaj, për të vënë nën hije kushtin kryesor, vendosen kushte të tjera.

Kjo qeveri u bë për pazare, mbetet e pazareve dhe, si rrjedhojë, politika e integritit evropian, liberalizimi i vizave, politika e jashtme e Kosovës do të zhvillohen mbi parimet e pazareve dhe jo nga parimet e politikës së drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Teutë, edhe një herë po dëshiron replikë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Respekt për ish-zëdhënësen e Komunës së Prishtinës. Ndoshta i ka mbetur fjalimi prej asaj kohe. Normalisht që tash është fundi, edhe në fushatë jemi, është mirë të dilet, sepse e keni humbur Prishtinën. I keni humbur edhe komunat e tjera. Edhe fjalimi u pa, i përkthyer, ashtu qysh të ka mbetur ty, qysh e ke lexuar atëherë kur i keni dërguar dosjet, e nuk bëtë asgjë me ato dosjet e Isa Mustafës, se edhe ne pritëm.

Sinqerisht, kemi pritur shumë. 70 dosje, në fillim thosha, mos po do Zoti diçka bile po del. Është mirë gjithçka çka të keni, të ecni, jo fjalë. 70 dosje, katër vjet s'bëtë kurrëgjë. Respekt, por tani je në Kuvend, je deputete. Çfarëdo që të kesh, shko në institucionet e vendit atje, për çfarëdo qoftë.

Korrupsion, krim, gjithçka do të luftohet në këtë Qeveri dhe nuk do të marrë frymë askush. Për të tjerat, nëse ti nuk ke parë deri tash, për ditët dhe vendimet që ka marrë kjo Qeveri, të cilat janë vendime që nesër, kur të diskutohet programi ke për çka të flasësh, flasim për të gjithë sektorët dhe nuk do t'i mbrojmë. Për fjalën e thënë zoti Haradinaj është më i përgjegjshmi dhe më i ndërgjegjshmi që ka pasur Republika e Kosovës deri më sot. Do të jemi dëshmitarë këtu, jemi unë e ti bashkë.

KRYESUESI: Zonja Pacolli, kundër-replikë!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Jo, unë s'përmend emrat. Ju po bëni replikë, se keni qejf të dilni.

Po e korrigjoj Teutën, nuk isha zëdhënëse, isha shefe e Kabinetit të kryetarit. Kam bërë punën e zëdhënëses, përderisa nevojitej që të kishim një zëdhënëse.

Çfarë ka bërë komuna, nuk ju takon të flisni, për shkak se komuna ka bërë shumë. 70 dosje, të cilat i kemi dërguar në prokurori, nuk është faji i Komunës së Prishtinës, është faji i qeverisjes së kaluar dhe sistemit të drejtësisë, të cilin kjo qeveri e ka kapur dhe këtë po vazhdoni ta bëni edhe ju. Pra, Komuna e Prishtinës e ka reformuar tërë sistemin e administratës, ka hapur çerdhe të reja, ka përmirësuar arsimin, ka përmirësuar të gjitha

qendrat e shëndetësisë dhe nëse mund të shkoni vetëm t'i vizitoni qendrat e shëndetësisë, atëherë do të bindeni se çfarë ka bërë Komuna e Prishtinës. E sa për ta humbur komunë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Është shterur debati i ftuar nga 50 deputetë. Ju që keni qëndruar vërtet meritoni respekt nga qytetarët, nga ata që ju kanë votuar. Unë besoj që kemi diskutuar për interes të vendit, edhe për fushatë elektorale. Kështu që, në rregull është.

Mirupafshim në seancën tjetër, nesër në orën 10:00!

Debati i thirrur ka përfunduar, më nuk ka debat për këtë çështje. Kush dëshiron të bëjë kërkesë të re, mund ta bëjë.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*